

# Ligj për arsim të lartë

Ligj për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 35/2008; 103/2008; 26/2009; 83/2009; 99/2009; 115/2010; 17/2011; 51/2011; 123/2012; 15/2013; 24/2013; 41/2014; 116/2014 dhe 130/2014).

## Kreu i parë

### DISPOZITA KRYESORE

#### *Lënda e rregullimit*

##### Neni 1

Me këtë ligj rregullohen autonomia e universitetit dhe liria akademike, kushtet dhe procedura për themelimin dhe ndërprerjen e funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë, sistemi i sigurimit dhe vlerësimi i cilësisë së arsimit të lartë, bazat e organizimit, menaxhimit, zhvillimit dhe financimit të veprimtarisë së arsimit të lartë.

#### *Domethënia e nocioneve*

##### Neni 2

Disa shprehje të përdorura në këtë ligj kanë këtë domethënie si në vijim:

1. “ **Autonomia e universitetit** ” përfshin lirinë akademike, marrjen e vendimeve dhe menaxhimin e pavarur si dhe moscenim të hapësirës universitare;
2. “ **Agjencia për evalvim** ” është trup i cili bën vlerësimin e jashtëm të cilësisë së institucionit të arsimit të lartë dhe të realizimit të veprimtarisë së tij;
3. “ **Akreditimi i projektit për themelimin e institucionit të arsimit të lartë** ” është marrja e vendimit nga ana e Këshillit të akreditimit me të cilin pranohet, përkatësisht jepet mendim për projektin në të cilin përmbahen dhe shpjegohen kushtet për themelimin e institucionit të arsimit të lartë;
4. “ **Arsim i lartë** ” është arsim që ka të bëjë me programet studimore që realizohen nëpër universitete dhe institucione të pavarura të arsimit të lartë;
5. “ **Kualifikim i arsimit të lartë** ” është emërtim profesional përkatësisht shkencor për program studimor të mbaruar në ciklin e parë, të dytë ose të tretë të arsimit të lartë, të kryer në institucion për arsim të lartë në Republikën e Maqedonisë ose në ndonjë shtet tjetër, që është i akredituar dhe ka leje për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë;
6. “ **Dokument për program studimor të mbaruar pjesërisht** ” është një certifikatë ose ndonjë dokument tjetër për kredi studimore të fituara, për vite të mbaruara, semestra, provime, module,

pjesë nga programi studimor përkatësisht për detyrime të kryera sipas programit studimor për përfundimin e arsimit të lartë, që e lëshon institucioni i arsimit të lartë sipas rregullave të shtetit përkatës;

7. " **Diploma** " është një dokument publik i lëshuar nga institucioni për arsim të lartë e me të cilën vërtetohet kryerja e arsimit të lartë të ciklit të parë, të dytë ose të tretë, e nevojshme për vazhdimin e shkollimit ose për fillimin e ushtrimit të profesionit përkatës;

8. " **Shtesë e diplomës (Diploma Supplement)** " është pjesë përbërëse e diplomës e cila përmban të dhëna për mbartësin e diplomës, informacione që më nga afër përcaktojnë kualifikimin, nivelin e kualifikimit, (titullin profesional, përkatësisht shkencor) sistemin dhe përmbajtjen e studimeve dhe rezultatet e arritura, si dhe të dhëna për mundësitë akademike e profesionale që ofron kualifikimi për studime të mëtejshme dhe statusin profesional, informacione plotësuese sipas natyrës së programit studimor dhe burimit të tij, datën dhe firmën dhe informacione lidhur me sistemin kombëtar të arsimit të lartë;

9. " **Mësim i përjetshëm (Lifelong Learning)** " është një formë e mësimit të vazhdueshëm gjatë gjithë jetës për të perfeksionuar, plotësuar, përthelluar dhe ripërtërirë njohurit;

10. " **Evalvim (Quality Assurance)** " është vlerësim i cilësisë së arsimit të lartë që përfshin procedura të shumta eksplicite për vlerësim të cilësisë në institucionet për arsim të lartë, të kuadrove akademike dhe të programeve të tyre studimore sipas procedurave dhe standardeve të pranuar dhe udhëzuesit (drejtimet) për evalvim të aprovuar nga institucionet evropiane për evalvim të arsimit të lartë dhe nga organizata e asociacione të tjera të cilët kanë rolin e vendosjes dhe zbatimit të standardeve evropiane dhe dhënien e udhëzimeve për evalvim në vendet evropiane lidhur me arsimin e lartë;

11. " **Njësi e universitetit** " është fakultet, akademi artesh dhe shkollë e lartë profesionale si institucione të arsimit të lartë në kuadër të universitetit, me të drejta e detyrime të caktuara nga ky ligj dhe nga statuti i universitetit. Njësi të universitetit janë edhe institucione shkencore me të drejta e detyrime të caktuara nga Ligji për veprimtari kërkimore-shkencore, nga ky ligj dhe nga statuti i universitetit;

12. " **Diplomë e përbashkët (Joint Degrees)** " është diplomë e cila merret pas përfundimit të programit studimor të cilën së bashku e pranojnë dhe realizojnë dy ose më shumë universitete në vend ose universitet nga vendi i institucionit të akredituar për arsim të lartë jashtë shtetit, përkatësisht njësi e tij e akredituar dhe e regjistruar në Republikën e Maqedonisë, në bazë të kushteve të caktuara me këtë ligj;

13. " **Bashkëfinancim i studimeve** " do të thotë një shumë parash për mbulimin e shpenzimeve të studimit, që studenti shkollimi i të cilit nuk financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, ka për detyrë t'ia paguajë institucionit shtetëror për arsim të lartë;

14. " **Sistem i transferimit të kredive** " është procedurë e përbashkët që realizohet sipas sistemit të transferimit të kredive (ECTS – European Credit Transfer System), i cili mundëson: përshkrim të detyrimeve (mbingarkesa) të studentit ose të vëllimit të detyrimeve për mbarimin e studimeve;

valorizim të vëllimit përfundimtar të studimeve dhe matje dhe krahasim të arritjeve në mësim dhe transmetimi i tyre nga një institucion i arsimit të lartë në tjetrin, ku kredia shpreh kuantitetin e punës që kërkon programi studimor në raport me kuantitetin e përgjithshëm të punës që kërkohet për të përfunduar vitin akademik të studimeve;

15. “ **Kredi** ” është njësi matëse për vlerësimin e punës që studenti kryen mesatarisht, përkatësisht mbingarkesa e studentit ku llogariten leksionet, seminarët, ushtrimet dhe format e tjera të punës studimore të organizuar. Kredia i jepet studentit dhe regjistrohet në dosjen e tij kur do të përmbushë detyrimin e tij studimor;

16. “ **Mësimi joformal** ” janë kurse, universitete verore e dimërore, programe për aftësim dhe forma të tjera mësimi, që nuk janë pjesë e programeve studimore për përfundimin e arsimit të lartë dhe për të cilat nuk lëshohet diplomë;

17. “ **Njësi organizative në kuadër të universitetit** ” është formë e brendshme organizative e universitetit e organizuar në bazë të statutit të universitetit ose me vendim, përkatësisht me akt të përgjithshëm të sjellë mbi bazën e statutit të universitetit për detyrimet e të cilit në mënyrë të pakufizuar përgjigjet universiteti që e ka organizuar;

18. “ **Participim** ” është shumë parash që përcaktohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, që paguhet nga ana e studentëve të regjistruar në institucionin shtetëror për arsim të lartë, shkollimi i të cilëve financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë;

19. “ **Anëtare shoqëruese e universitetit** ” është institucion veprimtaria kryesore e të cilit është e lidhur funksionalisht me veprimtarinë e arsimit të lartë;

20. “ **Veprimtari aplikative** ” është aplikimi i rezultateve shkencore, njohurive shkencore dhe ushtrimi i punëve të tjera të larta profesionale të mësuesve, punonjësve dhe bashkëpunëtorëve shkencorë të sferës shkencore e profesionale për të cilën është i akredituar institucioni i arsimit të lartë;

21. “ **Korniza e kualifikimit** ” janë qëllimet dhe bazat fillestare për formimin e programeve studimore dhe pritet nga ana e studentit, kuptimi, përkatësisht mundësia për të kuptuar gjatë kohës së mësimit të çdo cikli në arsimin e lartë (Learning Outcomes), struktura e miratuar kombëtare e kualifikimeve të arsimit të lartë (Framework for Qualifications), përfshirë edhe njohjen e mësimit formal e joformal të kryer gjatë gjithë jetës (Lifelong Learning);

22. “ **Institucion i pavarur i arsimit të lartë** ” është institucion i arsimit të lartë i cili nuk është në kuadër të universitetit, i themeluar si akademi artesh ose si shkollë e lartë profesionale, institucion për arsim të lartë i bashkësisë fetare ose institucion tjetër për arsim të lartë i themeluar me ligjin për ushtrim të një lloji të veçantë të arsimit të lartë;

23. “ **Program studimor** ” është një shumë e lëndëve të mësimit të lidhura në mënyrë relative ose njësi të tjera të mësimit (module e përmbajtje të tjera mësimore) nga një fushë studimi nga të cilat studentit arrin të kualifikohet dhe me këtë kualifikim ka mundësi të ushtrojë ndonjë aktivitet profesional ose të vazhdojë studimet;

24. “ **Fushë studimi** ” është një nga 22 fushat, të përcaktuara në klasifikimin ISCED të fushave të studimit të UNESCO-s;

25. “ **Cikle të arsimit të lartë** ” janë tre nivelet e njëpasnjëshme të arsimit të lartë të identifikuar në procesin e Bolonjës (cikli i parë, i dytë e i tretë) ku janë renditur të gjitha kualifikimet e arsimit të lartë në hapësirën e vetme evropiane të arsimit të lartë dhe

26. " **Institucion privat-publik jofitimprurës i arsimit të lartë** " është institucion i arsimit të lartë i themeluar nga fondacioni jofitimprurës me mjete publike prej burimesh të huaja dhe të vendit, i cili krijon dhe gjeneron të mira meritore publike dhe sendërton interes publik. Mjetet e fituara në këtë institut shfrytëzohen vetëm dhe ekskluzivisht për zhvillimin e veprimtarisë të arsimit të lartë, meqë ky institucion nuk krijon dhe nuk sistemon profit.

Neni 2-a

Ky ligj zbatohet në mënyrë përkatëse dhe për akademi ushtarake, nëse me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

### *Roli dhe detyrat e institucioneve të arsimit të lartë*

Neni 3

Roli dhe detyrat e institucioneve të arsimit të lartë janë krijimi, mbrojtja dhe transmetimi i njohurive për të siguruar përparim dhe mirëqenie sociale e ekonomike në shoqëri, përgatitja e studentëve për profesione për të cilat nevojiten zbulime shkencore e njohuri profesionale, shumëllojshmëri kulturore e gjuhësore, nxitja e zhvillimit teknologjik, zhvillimi i arteve, kultura teknike e sporti.

Rolin dhe detyrat nga paragrafi 1 i këtij neni, institucionet e arsimit të lartë i realizojnë me:

- organizimin e studimeve sipas programeve studimore të ciklit të parë, të dytë e të tretë të studimeve,
- realizimin e kërkimeve fundamentale, zhvillimore e të aplikuara dhe realizimin e veprimtarive aplikative,
- transmetim të njohurive e aftësive shkencore, profesionale e artistike,
- sigurimin e shkencëtarëve, profesionistëve dhe artistëve të rinj,
- dhënie mundësi gjithkujt nën kushte të barabarta për arsim të lartë dhe për mësim gjatë gjithë jetës,
- sigurimin e sistemit për mësim të përgjeshëm,
- bashkëpunim me institucione shkencore të arsimit të lartë të huaja e të vendit dhe me realizimin e formave të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar,
- organizimin e formave dhe llojeve të tjera të ngritjes së nivelit të arsimit dhe nxitjes së garave konstruktive ndërmjet ideve dhe qasjeve të ndryshme dhe
- sigurimin e pjesëmarrjes të studentëve në drejtimin, sidomos në lidhje me çështjet që janë të rëndësishme për cilësinë e mësimin dhe standardit të studentëve.

### *Karakteristi i veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë*

Neni 4

Veprimtaria e institucioneve të arsimit të lartë është veprimtari me interes publik.

### *Mbrojtja e emërimit të institucionit të arsimit të lartë*

Neni 5

Nën emërtimin universitet, fakultet, akademi artesh ose shkollë e lartë profesionale, mund të funksionojnë vetëm institucione të arsimit të lartë që janë themeluar në bazë të këtij ligji.

### *Bashkësi akademike*

Neni 6

Bashkësinë akademike e përbëjnë personat e zgjedhur në titujt arsimorë-shkencorë, shkencorë, arsimorë, të titujve profesionalë dhe studentët. Profesorët ordinarë mbeten anëtarë të bashkësisë akademike edhe pas pensionimit të tyre.

### *Qasja në arsimin e lartë*

Neni 7

Nënshtetasit e Republikës së Maqedonisë kanë nën kushte të barabarta të drejtë shkollimi në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë.

Shtetasit e huaj kanë mundësi, me zbatimin e parimit të përbashkësisë, të shkollohen në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë nën kushte të barabarta si edhe nënshtetasit e Republikës së Maqedonisë.

Shtetasit e huaj, pa zbatimin e parimit të përbashkësisë, kanë mundësi të shkollohen në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë, nën kushte që më nga afër i përcakton institucioni i arsimit të lartë.

Të drejtë për arsim të lartë kanë edhe personat pa nënshtetësi nën kushte të caktuara me ligj dhe me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare.

### *Cilësia e personit juridik*

Neni 8

Universiteti dhe institucioni i pavarur i arsimit të lartë kanë cilësinë e personit juridik.

Njësitë e universitetit kanë të drejta dhe detyrime, të caktuara nga ky ligj, nga akti i themelimit të universitetit dhe statuti i universitetit.

Njësiti e universitetit publik në trafikun juridik funksionojnë sipas autorizimeve të përcaktuara në statutin e universitetit.

Njësiti organizative në kuadër të universitetit mund të kenë disa të drejta të caktuara në trafikun juridik edhe nga pikëpamja e administrimit dhe menaxhimit, në vëllim dhe kushte të caktuara nga themeluesi. Për detyrimet e njësive organizative në mënyrë të pakufizuar përgjigjet universiteti që i ka themeluar.

### *Statuti dhe akte të tjera*

#### Neni 9

Akti bazë i universitetit, përkatësisht i institucionit të pavarur të arsimit të lartë, është statuti.

Me statut më nga afër rregullohet organizimi i brendshëm, mënyra e ushtrimit të veprimtarisë së arsimit të lartë, autorizimet dhe mënyra e punës dhe e marrjes së vendimeve dhe çështje të tjera domethënëse për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë.

Njësia e universitetit ka rregullore me të cilën në bazë të statutit të universitetit rregullohen marrëdhëniet e brendshme dhe funksionimi i njësisë (në vijim të tekstit: rregullore e njësisë).

Për statutin e universitetit publik dhe të institucionit të pavarur të arsimit të lartë publik, pajtim jep Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, kurse institucionit të lartë arsimor privat, me mendim paraprak të ministrit kompetent për çështjet e arsimit të lartë.

### *Vula, shenja dhe shënime të tjera*

#### Neni 10

Universiteti, përkatësisht institucioni i pavarur i arsimit të lartë kanë vulë.

Vula përmban emrin dhe selinë e universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

Vula e njësisë së universitetit, përveç emrit të saj, detyrimisht përmban edhe emrin e universitetit në kuadër të të cilit gjendet.

Vula e çdo institucioni të pavarur të arsimit të lartë përmban emrin e Republikës së Maqedonisë dhe emërtimin e institucionit të arsimit të lartë.

Në mesin e vulës së institucioneve të arsimit të lartë është edhe emblema e Republikës së Maqedonisë.

Forma dhe përmbajtja e vulës, si dhe pamja e shenjave dhe shënimeve të tjera dhe mënyra e përdorimit të tyre, caktohen nga statuti i universitetit dhe rregullorja e njësive të universitetit, përkatësisht nga statuti i institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

#### Neni 10-a [2](#)

Në institucionet e arsimit të lartë vendet e punës së të punësuarve ndahen në:

- vende të punës të nëpunësve administrativë,
- vende të punës të dhënësve të shërbimeve publike në institucionet e arsimit të lartë dhe
- vende të punës të personave ndihmës-teknikë.

#### Neni 10-b [3](#)

Të punësuarit në institucionet e arsimit të lartë që kryejnë punë nga natyra administrative për shkak të realizimit të veprimtarisë arsimi i lartë kanë status të nëpunësve administrativë.

Për të punësuarit nga paragrafi 1 i këtij neni kategoritë, nivelet dhe titujt përcaktohen në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë, me ç'rast sekretari i përgjithshëm i institucionit të lartë të arsimit sistemohet në kategorinë A në nivelin A1, kurse sekretari i fakultetit /institutit sistemohet në kategorinë A në nivelin A2.

#### Neni 10-v [4](#)

Të punësuarit në institucionit e arsimit të lartë që kryejnë punë nga sfera e arsimit dhe shkencës, kanë status të dhënësve të shërbimeve publike në institucionet e arsimit të lartë dhe për to zbatohen dispozitat nga ky ligj, dispozitat nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

Për të punësuarit nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:

- Kategoria A tituj edukativ-arsimorë në arsimin e lartë
- niveli A1 profesor i rregullt/këshilltar shkencor,
- niveli A2 profesor me korrespondencë/bashkëpunëtor i lartë shkencor dhe
- niveli A3 docent / bashkëpunëtor shkencor,
- Kategoria B tituj arsimorë në arsimin e lartë
- niveli B1 profesor në shkollën e lartë profesionale,
- niveli B2 ligjërues i lartë,
- niveli B3 lektor i lartë dhe
- niveli B4 ligjërues asistent me dr.,
- Kategoria V tituj bashkëpunëtorë në arsimin e lartë
- niveli V1 asistent, bashkëpunëtor artistik, hulumtues, lektor dhe
- niveli V2 asistent i ri, lektor i ri, bashkëpunëtor i ri artistik, hulumtues i ri dhe
- Kategoria G kuadër tjetër bashkëpunëtor në arsimin e lartë
- niveli G1 korepetitor,
- niveli G2 producent aplikativ dhe
- niveli G3 laborant i lartë.

## Neni 10-g [5](#)

Të punësuarit në institucionet e arsimit të lartë që kryejnë punë ndihmëse teknike, kanë status të personave teknik ndihmës dhe për to zbatohen dispozitat nga ky ligj, Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

Për të punësuarit nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:

- nëngrupi 1 kategoria A niveli A1 mirëmbajtës i higjienës, mirëmbajtës/menaxhues për ndezje, punëtor i përgjithshëm dhe të tjerë,
- nëngrupi 2 kategoria A niveli A1 rojtar dhe të tjerë,
- nëngrupi 3 kategoria A niveli A1 shofer dhe të tjerë,
- nëngrupi 4 kategoria A niveli A1 shërbyese-enëlarëse, kuzhinier dhe të tjerë dhe
- nëngrupi 5 kategoria A niveli A1 ekonom-shtëpiar, hauz-mjeshtër, korrier (furnizues) dhe të tjerë.

## Neni 10-d [6](#)

Rektori, me mendim paraprak të Ministrisë për shoqëri informatike dhe administratë dhe si pas pëlqimit paraprak nga Ministria për arsim dhe shkencë miraton plan vjetor për punësim të nëpunësve administrativë, dhënësve të shërbimeve publike dhe personave ndihmës-teknikë për vitin e ardhshëm në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

## Kreu i dytë

### **AUTONOMIA E UNIVERSITETIT**

#### *Përmbajtja dhe ruajtja e autonomisë*

## Neni 11

Universitetet dhe njësitë në kuadrin e tyre dhe institucionet e pavarura të arsimit të lartë ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbi principin e autonomisë akademike.

Me autonominë akademike garantohet liria intelektuale e anëtarëve të bashkësisë akademike dhe natyra krijuese e procesit kërkimor e arsimor, si vlera dhe aftësi kulmore.

Autonomia e universitetit përfshin lirinë akademike, autonominë e menaxhimit dhe paprekshmërinë e autonomisë.

Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të ngrenë proces në gjykatën kompetente për ruajtjen e autonomisë së universitetit.



## *Liria akademike*

### Neni 12

Liria akademike përfshin:

- lirinë e punës kërkimore e shkencore, krijimtarisë artistike, aplikimin dhe ndërmjetësimin e njohurive,
- rregullim të pavarur të organizimit të brendshëm dhe punës me statutin në bazë të ligjit,
- liri të realizimit të mësimin, të realizimit të kërkimeve shkencore, veprimtarisë artistike, përkatësisht krijimtarisë dhe veprimtarisë aplikative, përfshirë edhe lirinë e publikimit dhe prezantimit publik të rezultateve shkencore dhe arritjeve artistike,
- lirinë e studimit, të caktimit të rregullave të studimit, format dhe llojet e veprimtarive pedagogjike-arsimore dhe të verifikimit të njohurive të studentëve,
- lirinë e zgjedhjes së programeve mësimore dhe përmbajtjes së lëndëve të veçanta, si dhe përgatitja e librave shkollorë dhe mjeteve të tjera ndihmëse shkollorë,
- lirinë e zgjedhjes së metodës dhe interpretimit të përmbajtjeve mësimore e artistike,
- përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të studimit të ciklit të parë, të dytë e të tretë si dhe të llojeve të tjera të shkollimit,
- përgatitja, miratimi dhe realizimi i programeve kërkimore e shkencore dhe veprimtarisë aplikative,
- ndarja e titujve profesionalë, akademikë e shkencorë në përputhje me ligjin, si dhe ndarja e titujve akademikë të nderit,
- përcaktimin e kushteve, kriterëve dhe procedurave për zgjedhje në titujt mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë dhe
- zgjedhje në titujt mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë.

## *Autonomia e menaxhimit*

### Neni 13

Autonomia në menaxhimin e universiteteve dhe institucioneve të pavarura të arsimit të lartë shprehet në:

- planifikimin, realizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së arsimit të lartë,
- vendosjen dhe rregullimin e organizimit të brendshëm,
- miratimin e statutit, përkatësisht rregullores së njësisë,
- zgjedhjen, emërimin dhe tërheqjen e organeve në përputhje me statutin,
- disponimin me mjetet financiare të aprovuara, si dhe me të ardhurat e veta,
- formimin e fondeve dhe themelimin e organizatave të tjera nga të ardhurat e veta, nga donacione dhe burime të tjera për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore e shkencore, botuese dhe veprimtarisë aplikative të arsimit të lartë,
- menaxhimin dhe shfrytëzimin e pronës në përputhje me qëllimin për të cilin është marrë,
- marrjen e vendimeve lidhur me format e bashkëpunimit me organizata të tjera,
- bashkimin dhe asocimin me organizata e forume përkatëse në vend dhe jashtë tij,
- realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, nënshkrimin e marrëveshjeve dhe pjesëmarrjen në organizata e asociacione ndërkombëtare dhe
- marrjen e vendimeve lidhur me të drejta të tjera të caktuara nga statuti, përkatësisht rregullorja e njësisë.

## *Moscenimi i hapësirës universitare*

Neni 14

Hapësira e universitetit dhe e institucioneve të pavarura të arsimit të lartë është e pacenueshme. Policia dhe organet e tjera të sigurimit nuk kanë mundësi pa pajtimin e rektorit, përkatësisht drejtorit ose të personit të autorizuar nga ata, të hyjnë në këtë hapësirë, me përjashtim të rasteve për ndalimin e realizimit të një vepre penale të drejtpërdrejtë që do të bëhet ose ka filluar të bëhet, për ndalimin e kryerësit veprës penale, si dhe në raste të fatkeqësive të ndryshme e atyre të natyrës (zjarr, përmbytje, etj).

Në universitete dhe në institucionet e pavarura të arsimit të lartë ndalohet organizimi dhe veprimi politik e fetar, si dhe spikatja e shenjave partiake e fetare.

## *Zgjidhje paqësore e konflikteve*

Neni 15

Kontestet që ndodhin ndërmjet anëtarëve të bashkësisë akademike, si dhe kontestet ndërmjet institucioneve të pavarura të arsimit të lartë dhe njësisë të tyre zgjidhen me marrëveshje, në organe të përbashkëta, në mënyrë arbitrore dhe në mënyra të tjera mirëkuptimi.

Gjatë zgjidhjes së kontesteve nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk mund të pengohet funksionimi i rregullt i veprimtarisë së caktuar nga statuti.

## **Kreu i tretë**

## **INSTITUCIONE TË ARSIMIT TË LARTË DHE VEPRIMTARIA E TYRE**

### *Llojet e institucioneve të arsimit të lartë*

Neni 16

Institucione të arsimit të lartë janë universiteti dhe shkollat e lartë profesionale.

Institucione në kuadër të universitetit janë: fakulteti, akademja e arteve dhe shkolla e lartë profesionale (në vijim të tekstit: njësi të universitetit).

Në kuadër të universitetit gjenden edhe institutet shkencore, si njësi të universitetit.

Shkolla e lartë profesionale mund të themelohet si shkollë e lartë e pavarur profesionale ose në kuadër të universitetit.

Institucionet e arsimit të lartë mund të jenë institucione publike, institucione private-publike jofitimprurëse dhe institucione private (fitimprurëse ose jofitimprurëse).

## *Universiteti*

### Neni 17

Universiteti është institucioni shkencor përkatësisht artistik më i lartë i pavarur i arsimit të lartë, i cili siguron barazi në ushtrimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë, shkencës, artit dhe profesionalizmit dhe drejtpërsëdrejti edhe nëpërmjet njësive të tij nga fusha të ndryshme studimi, transmeton njohuri nga mjaft fusha dhe disiplina shkencore, përkatësisht artistike.

Në kuadër të universitetit mund të ketë edhe anëtarë shoqërues. Kushtet për pjesëmarrje dhe të drejtat e detyrimet e anëtarëve shoqërues, rregullohen me statutin e universitetit.

## *Veprimtaria e universitetit*

### Neni 18

Në kuadër të veprimtarisë së tij universiteti merr pjesë në përcaktimin e Programit për realizim dhe zhvillim të veprimtarisë së arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë (në vijim të tekstit: Programi për veprimtarinë e arsimit të lartë).

Universiteti i integron funksionet e njësive të tij (integrim funksional), dhe me organeve të tij siguron funksionimin e tyre të harmonizuar, nëpërmjet: zhvillimit strategjik, sjelljen e standardeve, normave e rregullave për organizimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë dhe asaj kërkimore-shkencore; ECTS; veprimtarisë zbatuese, aplikative e të profesionit të lartë; funksionim i harmonizuar në sektorin financiar, në investimet dhe planet e zhvillimit; profilimit të kërkimeve shkencore; kritereve për zgjedhje dhe avancim në titujt mësimorë-shkencorë dhe shkencorë, mësimorë; bashkëpunimit me universitet e vendit e ato jashtë tij; politikave të mobilitetit të studentëve, mësuesve dhe kuadrove administrativë; rregullave për shfrytëzim racional të burimeve njerëzore e materiale; zhvillimit dhe organizimit të studimeve; sistemit të sigurimit dhe kontrollit të cilësisë; standardeve të mësimdhënies; sistemit të informimit; sistemit bibliotekar; veprimtarisë botuese; lëshimit të diplomave; organizimit të simpoziumeve dhe seminareve; transferimit të mjeteve njësive të universitetit dhe organizatave universitare për aktivitete kulturore e sportive; lëshimit të formularëve dhe dokumenteve të tjera për nevojat e studentëve; shërbimeve profesionale, përkatësisht tekniko-administrative; dokumentacionit universitar; kujdesit për mbrojtjen dhe përparimin e standardeve të studentëve e të të punësuarve; programit për shkëmbim të shërbimeve të produkteve shkencore e profesionale me persona fizikë e juridikë në vend dhe jashtë tij; sigurimi i pronës së universitetit dhe të njësive të tij; dhe nëpërmjet realizimit të veprimtarive e punëve të tjera të caktuara nga ky ligj dhe nga statuti i universitetit.

## *Fakulteti, akademia e arteve dhe shkolla e lartë profesionale*

### Neni 19

Fakultet është institucion i arsimit të lartë i cili ushtron veprimtari shkencore e kërkimore të arsimit të lartë dhe veprimtari të profesionalizmit të lartë në fushën studimore e atë shkencore e kërkimore, në përputhje me programin studimor të një ose disa fushave shkencore e kërkimore,

përkatësisht profesionale ose artistike të ngjashme e të lidhura ndërmjet tyre nga cikli i parë, i dytë dhe i tretë i studimeve.

Akademia e arteve si fakultet është institucion i arsimit të lartë i cili ushtron veprimtari artistike e të arsimit të lartë dhe punë kërkimore-shkencore në një ose disa fusha mësimore e artistike të ngjashme, përkatësisht të lidhura ndërmjet tyre dhe kujdeset për zhvillimin e tyre. Nëse akademja e arteve mban emërtimin “fakultet”, atëherë zbatohen dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me fakultetin;

Akademia e arteve si shkollë e lartë profesionale realizon studime profesionale nga fusha e një ose disa sferave shkencore e artistike të ngjashme, përkatësisht të lidhura ndërmjet tyre dhe kujdeset për zhvillimin e tyre.

Shkolla e lartë profesionale është institucion i arsimit të lartë i cili realizon veprimtari të arsimit të lartë ose veprimtari artistike si studime të diplomës profesionale, studime të specializimit profesional dhe veprimtari aplikative nga fusha e një ose disa profesioneve (sfera profesionale) të ngjashme, përkatësisht të lidhura ndërmjet tyre.

Shkolla e lartë profesionale ka mundësi, nën kushte të caktuara me ligj, të realizojë edhe punë kërkimore e shkencore përkatësisht artistike, nëse kjo është e përcaktuar në statutin e universitetit si njësi e universitetit, përkatësisht me aktin e tij të themelimit, nëse është themeluar si institucion i pavarur i arsimit të lartë.

### *Veprimtaria e njësisve të universitetit*

Neni 20

Njësia e universitetit në kuadrin e veprimtarisë së tij:

- planifikon realizimin dhe zhvillimin e veprimtarive për të cilat është themeluar në kuadër të mjeteve financiare të buxhetit, aktiviteteve vetëfinanciare, donacioneve etj.,
- ushtron veprimtari të arsimit të lartë, shkencore e kërkimore, aplikative, përkatësisht artistike në një ose disa disiplina shkencore e profesionale të ngjashme përkatësisht të lidhura ndërmjet tyre, në një ose disa sfera të ngjashme artistike dhe kujdeset për zhvillimin e tyre,
- realizon bashkëpunim ndërkombëtar me institucione shkencore e të arsimit të lartë në përputhje me statutin e universitetit,
- organizon takime shkencore e artistike, simpoziume, seminare, këshillime dhe lloje të tjera takimesh,
- në kuadër të sistemit të vetëm bibliotekar-informativ të caktuar nga universiteti organizon punën e bibliotekës dhe organizon veprimtari bibliotekare-informative dhe dokumentuese,
- lëshon vërtetime dhe dokumente të tjera për mbarimin e studimeve dhe llojeve të tjera të shkollimit, sipas kushteve të përcaktuara me statutin e universitetit,
- propozon dhe ndërmerr masa për përparimin dhe mbrojtjen e standardit të studentëve dhe të të punësuarve,
- realizon studime të ndryshme për përplotësimin, për thellimin ose zgjerimin e njohurive dhe shkollimit të vazhdueshëm,
- shkëmben shërbime e produkte shkencore e profesionale me persona fizikë e juridikë të vendit

e jashtë tij dhe

- ushtron edhe funksione të tjera të caktuara nga ky ligj dhe nga statuti i universitetit.

Fakulteti mund të ushtrojë edhe veprimtari të arsimit të lartë për studime shkencore, që në bazë të këtij ligji i ushtron shkolla e lartë profesionale, në përputhje me statutin e universitetit.

### *Veprimtaria e institucionit të pavarur të arsimit të lartë*

Neni 21

Institucioni i pavarur i arsimit të lartë mund të ushtrojë veprimtari të arsimit të lartë nga cikli i parë i shkollimit me kohëzgjatje të paktën tre vite të studimeve si shkollë e lartë profesionale ose akademi artistike, arsim nga cikli i dytë shkollim profesional me kohëzgjatje të paktën një vit, përkatësisht dy vjet, nga fusha për të cilën është akredituar programi studimor.

Në institucionin e pavarur të arsimit të lartë nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me universitetin, përkatësisht me njësitë e tij. Instituti shkencor si ushtrues i veprimtarisë së arsimit të lartë

Neni 22

Instituti shkencor mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë për studime të ciklit të dytë dhe të tretë vetëm në suazat e sferës së shkencës për të cilën është themeluar në përbërje të universitetit si njësi e tij, pas pesë vitesh nga themelimi, nëse me sukses është kryer evolimi i punës hulumtuese shkencore, nëse është i akredituar për kryerjen e këtij lloji studimesh dhe ka aktvendim për fillim të punës, në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me statutin e universitetit. [7](#)

Instituti shkencor në kuadër të universitetit si njësi e tij mund të ushtrojë veprimtari të arsimit të lartë për studime nga cikli i dytë e i tretë në kuadër të sferës shkencore për të cilën është themeluar, nëse i përmbush kushtet për ushtrim të veprimtarisë së arsimit të lartë, nëse është i akredituar për të realizuar këto lloj studimesh dhe ka aktvendim për fillim me punë.

Instituti shkencor në përbërje të universitetit si njësi e tij mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë në cikël të dytë dhe të tretë, në bashkëpunim me njësinë e cila realizon programe studimore të sferës së njëjtë ose të ngjashme.

### *Institucioni i arsimit të lartë të bashkësisë fetare*

Neni 23

Fakultete ose akademi që janë themeluar nga bashkësitë fetare mund të gëzojnë të drejtat dhe detyrimet e institucionit të arsimit të lartë të caktuara me këtë ligj, nëse i përmbushin kushtet e këtij ligji për themelimin e një institucioni për arsim të lartë dhe për ushtrim të veprimtarisë së arsimit të lartë (në vijim të tekstit: Institucion i arsimit të lartë të bashkësisë fetare).

Institucioni i arsimit të lartë të bashkësisë fetare mund të gjendet në kuadër të universitetit si anëtare shoqëruese. Pozicioni i institucionit të arsimit të lartë të bashkësisë fetare në kuadër të universitetit përcaktohet dhe rregullohet me marrëveshje të nënshkruar me shkrim ndërmjet universitetit dhe themeluesit të institucionit të arsimit të lartë të bashkësisë fetare.

Kushtet e inkuadrimin të institucionit të arsimit të lartë të bashkësisë fetare në universitet, si dhe të drejtat e detyrimet e tij, rregullohen me statutin e universitetit.

### *Institucion i huaj i arsimit të lartë*

Neni 24

Institucioni i huaj i arsimit të lartë, të cilit i njihet e drejta e ushtrimit të veprimtarisë së arsimit të lartë, përkatësisht i akredituar për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë në vendin në të cilin gjendet selia e tij, mbi bazën e një miratimi nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, pas një mendimi paraprak nga Këshilli i akreditimit, ka mundësi në ndonjë nga gjuhët botërore të ushtrojë veprimtari të arsimit të lartë në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Institucioni i huaj i arsimit të lartë mund të ushtrojë veprimtari të arsimit të lartë edhe nën kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe me marrëveshje ndërshtetërore, nënshkruar ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe vendit ku i njihet e drejta e ushtrimit të veprimtarisë së arsimit të lartë. Për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë në territorin e Republikës së Maqedonisë nga ana e institucionit të huaj të arsimit të lartë themeluesi duhet të ofrojë edhe garanci kualitative financiare.

Institucioni i huaj i arsimit të lartë i cili ka miratim për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë në bazë të paragrafit 1 e 2 të këtij neni për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë dhe akreditimit për ushtrim të veprimtarisë së arsimit të lartë në vendin në të cilin gjendet selia, regjistrohet në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë si institucion dhe në regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë në bazë të nenit 36 të këtij Ligji.

### **Kreu i katërt**

## **THEMELIMI DHE PUSHIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË**

### *Subjekte të cilat mund të themelojnë institucione publike të arsimit të lartë*

Neni 25

Institucion publik të arsimit të lartë si universitet dhe si njësi të universitetit ose si institucion i pavarur i arsimit të lartë themelon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me ligj.

## *Subjekte të cilat mund të themelojnë institucion privat-publik jofitimprurës dhe institucion privat (fitimprurës ose jofitimprurës) të arsimit të lartë*

Neni 26

Institucion privat-publik jofitimprurës të arsimit të lartë mund të themelojë fondacioni jofitimprurës i themeluar nga personi i huaj juridik ose fizik me mjete publike të siguruar prej burimesh të huaja dhe të vendit sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj, në bazë të lejes së Qeverisë të Republikës së Maqedonisë.

Institucion privat (fitimprurës ose jofitimprurës) të arsimit të lartë mund të themelojë personi juridik dhe fizik i vendit dhe i huaj, sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj. Personi fizik dhe juridik i huaj mund të themelojë institucion privat (fitimprurës ose jofitimprurës) të arsimit të lartë, sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj, në bazë të miratimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Kusht për fillimin e procedurës për themelimin e institucionit të lartë arsimor nga personi vendas dhe/ose i huaj, juridik dhe/ose fizik, është pëlqimi i marrë paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Me person vendas sipas paragrafit 3 të këtij neni nënkuptohet personi i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, i cili plotëson kushtet për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë dhe shkencorë në pajtim me dispozitat ligjore të kësaj sfere.

### *Kushte për themelimin e institucionit të arsimit të lartë*

Neni 27

Institucioni i arsimit të lartë mund të themelohet nëse:

- është përcaktuar fusha studimore dhe kërkimore-shkencore, përkatësisht disiplina artistike për të cilat institucioni i arsimit të lartë themelohet, dhe ku gjatë përcaktimit të fushës studimore, përkatësisht disiplinës artistike përdoret klasifikimi internacional ISCED dhe korniza kombëtare e kualifikimit, ndërsa gjatë përcaktimit të fushës kërkimore-shkencore përdoret klasifikimi internacional Frascati,
- sigurohen ambiente dhe pajisje të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, veprimtarisë kërkimore-shkencore e artistike, përkatësisht profesionale,
- me anë të një plani financiar sigurohet niveli konstant i financimit të paktën për një cikël studimesh,
- sigurohet numri i duhur i personave që plotësojnë kushtet e caktuara për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë dhe në titujt, të cilët kanë deklaruar se do të paraqiten në konkurs dhe se do të hyjnë në marrëdhënie pune, nëse fitojnë në konkurs dhe
- nëse plotësohen edhe kushtet e tjera të caktuara me norma dhe standarde lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë.

Kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni si norma dhe standarde për themelimin e një institucioni të arsimit të lartë dhe ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, më nga afër përcaktohen me Dispozitën për norma e standarde për themelimin e veprimtarisë së arsimit të lartë dhe ushtrimin

e veprimtarisë së arsimit të lartë (në vijim të tekstit: Dispozita për norma e standarde), të cilën me propozim të ministrisë kompetente për arsimin e lartë dhe me mendim paraparak të Konferencës Ndëruniversitare e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

### ***Kushte për themelim të universitetit***

Neni 28

Universitet mund të themelohet nëse në përputhje me kushtet e caktuara në nenin 27 të këtij ligji, në kuadrin e tij ka pesë njësi të akredituara, nga të cilat të paktën tre janë fakultete.

Për të themeluar një universitet duhet të përmbushen kushtet për realizimin e programeve studimore të paktën të ciklit të parë e të dytë të arsimit të lartë, ndërsa për institucion të pavarur të arsimit të lartë të paktën të ciklit të parë të arsimit të lartë.

Për përmbushjen e kushteve për realizimin e programeve studimore të ciklit të tretë vendoset pas marrjes së vendimit për akreditim të universitetit, vendimit për fillimin e punës dhe pas mbarimit të paktën të një gjenerate studentësh, të ciklit të parë e të dytë të studimeve.

### ***Kushte të veçanta për themelimin e institucionit privat të arsimit të lartë***

Neni 29

Përveç kushteve të caktuara në nenet 27 e 28 të këtij ligji, për themelimin e një institucioni privat të arsimit të lartë themeluesi duhet të prezantojë garanci financiare cilësore se do të jetë në gjendje t'i kthejë mjetet financiare që studentët i kanë paguar institucionit të arsimit të lartë që ka pushuar me punë dhe shpenzimet e tjera që do të kenë studentët për shkak të transferimit të studimeve në një institucion të njëjtë ose të ngjashëm të arsimit të lartë në vend.

### ***Nisja e procedurës së themelimit***

Neni 30

Procedura për themelimin e një institucioni të arsimit të lartë nis me përgatitjen e projektit për themelim të institucionit të arsimit të lartë.

Projektin për themelimin e institucionit publik të arsimit të lartë e përgatit Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përkatësisht organi që ajo do ta autorizojë.

Projektin për themelimin e institucionit privat të arsimit të lartë e përgatit themeluesi.

### ***Projekt për themelimin e një institucioni të arsimit të lartë***

Neni 31

Projektin për themelimin e universitetit, njësisë së universitetit, përkatësisht institucionit të pavarur të arsimit të lartë përmban në mënyrë të veçantë: fusha studimore, me përshkrimin e tyre



si tërësi dhe grupet studimore, degët dhe drejtimet, kushtet e ambientit dhe pajisjet për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, veprimtarisë shkencore, përkatësisht artistike e profesionale në sferën përkatëse, burimin e mjeteve financiare për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, mundësinë e sigurimit të numrit të nevojshëm të personave që do të mund të zgjidhen në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë dhe në titujt e bashkëpunëtorëve dhe planin për mënyrën në të cilën do të përmbushen kushtet e tjera të caktuara me dispozitën për norma e standarde.

Projekti për themelimin e universitetit përmban të dhënat nga paragrafi 1 i këtij neni për të gjitha njësitë e universitetit.

Projektit për themelimin e institucionit të arsimit të lartë i bashkëngjiten edhe anekse të caktuara me rregullore nga neni 72 paragrafi 1 i këtij ligji.

Projektin për themelimin e institucionit publik të arsimit të lartë, përkatësisht institucionit privat të arsimit të lartë së bashku me anekset, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përkatësisht themeluesi ia dorëzon Këshillit të akreditimit.

Në bazë të shqyrtimit të projektit për themelimin e institucionit publik të arsimit të lartë, Këshilli i akreditimit jep mendim.

Në bazë të shqyrtimit të projektit për themelimin e institucionit privat të arsimit të lartë, Këshilli i akreditimit merr vendim për akreditim.

### *Vendim për akreditim*

Neni 32

Vendimin për akreditim të projektit për themelimin e institucionit privat për arsim të lartë, Këshilli i akreditimit e merr për çdo njësi të universitetit privat në veçanti dhe për universitetin si tërësi, përkatësisht për institucion të pavarur privat të arsimit të lartë, brenda 60 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës për akreditim të projektit. Nëse kërkojnë rrethanat, Këshilli i akreditimit mund ta zgjasë afatin e shumta edhe për 30 ditë të tjera, gjë për të cilën informon dorëzuesin e kërkesës së projektit. Vendimi i Këshillit të akreditimit është përfundimtar.

Kundër vendimit përfundimtar për akreditim të projektit për themelimin e një institucioni privat të arsimit të lartë, mund të ngrihet padi pranë Gjykatës Administrative.

Këshilli, në afat prej 60 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës për miratimin e aktvendimit për akreditim të projektit për themelimin e institucionit privat të arsimit të lartë, miraton aktvendim me të cilin vendos për kërkesën për miratimin e aktvendimit për akreditim të projektit për themelimin e institucionit privat të arsimit të lartë (në tekstin e mëtejshëm: aktvendim për akreditim).

Nëse Këshilli nuk miraton aktvendim për akreditim, përkatësisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që

në afat prej tri ditëve të punës të paraqesë kërkesë në sekretarinë e kryetarit të Këshillit dhe kryetari i Këshillit të miratojë aktvendim. [8](#)

Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi 3 i këtij neni, i përcakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

Me kërkesën për miratimin e aktvendimit për nostrifikim, përkatësisht ekuivalencë kërkuesi dorëzon edhe kopje të kërkesës nga paragrafi 3 i këtij neni.

Kryetari i Këshillit është i obliguar që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e paraqitjes së kërkesës nga paragrafi 4 i këtij neni në sekretarinë e kryetarit të Këshillit, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për akreditim pranohet apo refuzohet. Nëse kryetari i Këshillit nuk ka sekretari, kërkesa dorëzohet në sekretarinë e selisë së Këshillit.

Nëse kryetari i Këshillit nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi 7 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

Inspektori është i obliguar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi 8 i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje në Këshillin nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë qytetarin.

Inspektori pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin, miraton aktvendim me të cilin e ngarkon kryetarin e Këshillit që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e paraqitur, përkatësisht ta miratojë apo refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur.

Nëse kryetari i Këshillit nuk vendos në afatin nga paragrafi 10 i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin kryetari i Këshillit do të vendosë për kërkesën e paraqitur për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës.

Nëse kryetari i Këshillit nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi 11 i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat do ta informojë parashtruesin e kërkesës.

Nëse inspektori nuk vepron për njoftimin nga paragrafi 8 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditësh ka të drejtë të parashtrtojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi 13 i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar për njoftimin e parashtruesit të kërkesës nga paragrafi 8 i këtij neni dhe/ose nuk parashtron kallëzim në pajtim me paragrafin 12 të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ për inspektorin dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin kompetent nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi 14 i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit, dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Në rastin nga paragrafi 15 i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një dite pune do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

Në rastet nga paragrafi 16 i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin 14 të këtij neni, qytetari mund të parashtojë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

Nëse kryetari i Këshillit nuk vendos në afatin nga paragrafi 10 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngrite kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Akti nënligjor nga paragrafi 5 i këtij neni miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të këtij ligji.

Pas miratimit të aktit nënligjor, ai menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e ministrisë kompetente për punët e arsimit të lartë.

Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me akreditimin e projektit për themelimin e një institucioni privat të arsimit të lartë, zbatohen në mënyrë të përkatëse edhe në akreditimin për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë nga ana e institutit shkencor.

## *Akti i themelimit*

### Neni 33

Para dorëzimit të propozimit për themelimin e institucioneve publike të arsimit të lartë, propozuesi i propozimit për miratimin e ligjit, merr mendim nga Këshilli i akreditimit për projektin e themelimit të institucioneve publike të arsimit të lartë.

Pas vendimit për akreditim të projektit për themelimin e institucioneve private të arsimit të lartë, themeluesi miraton aktin e themelimit, mbi bazën e tekstit që i është bashkëngjitur projektit për themelimin e institucionit të arsimit të lartë.

## *Komisioni amë*

### Neni 34

Pas sjelljes së ligjit për themelimin të institucionit publik të arsimit të lartë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit kompetent për funksionimin e arsimit të lartë, emëron një komision amë.

Pas sjelljes së aktit të themelimit të institucionit privat të arsimit të lartë, themeluesi emëron një komision amë.

Komisioni amë për themelimin e universitetit përbëhet nga tre anëtarë për çdo njësi të universitetit me tituj mësuesorë-shkencorë dhe shkencorë në sferën shkencore, përkatësisht sferën artistike ose profesionin për të cilin themelohet, nga të cilët më shumë se gjysma janë nga radhët e profesorëve.

Komisioni amë për themelimin e institucionit të pavarur të arsimit të lartë përbëhet nga pesë anëtarë me tituj arsimorë-shkencorë dhe shkencorë në sferën shkencore, përkatësisht sferën artistike ose profesionin për të cilin themelohet.

Kur themeluesi i institucionit privat të arsimit të lartë është person fizik ose juridik i huaj, ose kur institucioni i arsimit të lartë themelohet me mjete financiare të siguruar nga themeluesi të huaj ose donatorë, themeluesi, nën kushte të caktuara në paragrafin 3 përkatësisht paragrafin 4 të këtij neni, për anëtarët e komisionit amë, mund të emërojë edhe persona që janë nënshtrës të huaj.

Komisioni amë realizon punët përgatitore me të cilat krijohen kushte për fillimin e punës së institucionit të akredituar të arsimit të lartë dhe në këtë kuadër:

- bën zgjedhjen e mësuesve për vitin e parë e të dytë të studimeve dhe të personave të tjerë të nevojshëm dhe
- realizon edhe punë të tjera që i ka besuar themeluesi, që kanë domethënie për fillimin e punës së institucionit të arsimit të lartë.

## *Vendim për fillimin e punës*

Neni 35

Pas kryerjes së përgatitjeve për fillimin e punës të institucionit të arsimit të lartë, themeluesi, përkatësisht organi i autorizuar nga ai, parashtron kërkesë te ministria kompetente për punët e arsimit të lartë, për realizimin e kontrollit për plotësimin e kushteve për fillim të punës të institucionit të arsimit të lartë.

Nëse konstatohet se për vitin studimor të parë dhe të dytë janë zgjedhur dhe punësuar, në pajtim me këtë ligj, së paku gjysma e numrit të përgjithshëm të mësimitdhënësve, për çdo program studimor veç e veç, në pajtim me standardet për ngarkimin e obligimeve arsimore të përcaktuara me dekretin për normativa dhe standarde dhe nëse janë plotësuar edhe kushtet tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktvendimin për akreditim, ministri kompetent për punët e arsimit të lartë në afat prej 60 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni, miraton aktvendim për fillim të punës të institucionit të arsimit të lartë (në tekstin e mëtejshëm: aktvendimi për fillimin e punës), i cili është përfundimtar.

Nëse konstatohet se nuk janë plotësuar kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni, ministri kompetent për punët e arsimit të lartë miraton aktvendim për refuzimin e fillimit të punës të institucionit të arsimit të lartë.

Nëse ministri kompetent për punët e arsimit të lartë nuk miraton aktvendim për fillimin e punës, përkatësisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditëve të punës të parashtrë kërkesë në sekretarinë e ministrit dhe ministri kompetent për punët e arsimit të lartë të miratojë aktvendim. Nëse ministri kompetent për punët e arsimit të lartë nuk ka sekretari, kërkesa parashtrëhet në sekretarinë e selisë së ministrisë kompetente për punët e arsimit të lartë.

Formën dhe përmbajtjen e formularit në kërkesës nga paragrafi 4 i këtij neni, e përcakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

Me kërkesën për miratimin e aktvendimit për fillimin e punës nga paragrafi 4 i këtij neni, kërkuesi dorëzon dhe kopje nga kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni.

Ministri kompetent për punët e arsimit të lartë është i obliguar që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi 4 i këtij neni në sekretarinë e ministrit kompetent për punët e arsimit të lartë, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për fillimin e punës pranohet apo refuzohet.

Nëse ministri kompetent për punët e arsimit të lartë nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi 7 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

Inspektori është i obliguar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi 8 i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje në ministrinë kompetente për punët e arsimit të lartë

nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer e informon parashtruesin e kërkesës.

Inspektori pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin miraton aktvendim me të cilin e ngarkon ministrin kompetent për punët e arsimit të lartë që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e paraqitur, përkatësisht të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për fillimin e punës pranohet apo refuzohet dhe ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur.

Nëse ministri kompetent për punët e arsimit të lartë nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi 7 i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin ministri kompetent për punët e arsimit të lartë do të vendosë për kërkesën e paraqitur për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës.

Nëse ministri kompetent për punët e arsimit të lartë nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi 11 i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat, do ta informojë parashtruesin e kërkesës.

Nëse inspektori nuk vepron për njoftimin nga paragrafi 8 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditësh ka të drejtë të parashtojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi 13 i këtij neni, dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar për njoftimin e parashtruesit të kërkesës nga paragrafi 8 i këtij neni dhe/ose nuk parashtron kallëzim në pajtim me paragrafin 12 të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ për inspektorin dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në ministrinë kompetente për punët e arsimit të lartë nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi 14 i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit, dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Në rastin nga paragrafi 15 i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një dite pune do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

Në rastet nga paragrafi 16 i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës, do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin 14 të këtij neni, qytetari mund të parashtrojë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

Nëse ministri kompetent për punët e arsimit të lartë nuk vendos në afatin nga paragrafi 10 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngrite kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Akti nënligjor nga paragrafi 5 i këtij neni, miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të këtij ligji.

Pas miratimit të aktit nënligjor ai menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e ministrisë kompetente për punët e arsimit të lartë.

Në marrëveshjen për punë të lidhur ndërmjet institucionit të arsimit të lartë dhe personave nga paragrafi 2 i këtij neni, përcaktohet se ato do të hyjnë në punë më së voni dy muaj para fillimit të vitit të parë, përkatësisht vitit të dytë shkollor.

Dispozitat e këtij neni në mënyrë përkatëse zbatohen edhe për realizimin e programeve studimore jashtë selisë së institucionit të arsimit të lartë.

### ***Regjistri i institucioneve të arsimit të lartë***

#### **Neni 36**

Pas vendimit të plotfuqishëm për fillimin e punës së institucionit të arsimit të lartë, themeluesi bën kërkesë për regjistrimin e institucionit të arsimit të lartë në regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë që mbahet nga Ministria kompetente për arsim të lartë.

Regjistri mbahet nën kushte të caktuara nga ky ligj dhe nga rregullorja për regjistrimin e institucioneve të arsimit të lartë, që e miraton ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë.

Me rregulloren nga paragrafi 2 i këtij neni rregullohet mënyra e regjistrimit, përmbajtja, forma e tërësisë së formularëve të regjistrimit, mënyra e publikimit të regjistrimeve, vërtetimet dhe provat që i bashkëngjiten kërkesës, mbajtja informatike e regjistrit, lidhja me Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë (në vijim të tekstit: Regjistri qendror) dhe çështje të tjera domethënëse për mbajtjen e rregullt të regjistrit.

### ***Konstituimi i organeve***

#### **Neni 37**

Pas regjistrimit të institucionit të arsimit të lartë në regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë, konstituohet senati dhe zgjidhet rektori, përkatësisht konstituohet këshilli arsimor-shkencor ose

këshilli pedagogjik dhe zgjidhet dekani, përkatësisht drejtori. Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë.

Në rast kur me ligj themelohet institucioni i arsimit të lartë, deri në zgjedhjen e dekanit përkatësisht drejtorit sipas paragrafit (1) të këtij neni, menjëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit me të cilin themelohet institucioni i arsimit të lartë, rektori emëron kryerës të detyrës dekan përkatësisht kryerës të detyrës drejtor i cili e kryen detyrën më së shumti gjashtë muaj nga dita e emërimit të tij.

#### Neni 38

Pas konstituimit dhe zgjedhjes së organeve të universitetit dhe njësive të tij, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë, bëhet regjistrimi i universitetit dhe institucionit të pavarur të arsimit të lartë në Regjistrin qendror, dhe kështu ato kanë veti të personit juridik.

Pas regjistrimit në Regjistrin qendror të universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë, institucioni i arsimit të lartë mund të fillojë me regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve.

#### *Ndryshime të statusit*

#### Neni 39

Universitetet, njësitë e universitetit, përkatësisht institucionet e pavarura të arsimit të lartë, mund të bashkohen, ndahen ose bashkëngjiten, nën kushte dhe mënyra të caktuara me këtë ligj dhe me statutin e universitetit dhe ndryshimin dhe plotësimin e aktit themelues.

Propozim për ndryshim statusor nga paragrafi 1 të këtij neni themeluesit, jep Ministria kompetente për arsim të lartë. Propozim për ndryshime statusore Ministrisë kompetente për arsim të lartë mund t'i jep edhe universiteti.

Gjatë ndryshimit të statusit nga paragrafi 1 i këtij neni, studenti ka të drejtë t'i mbarojë studimet sipas programeve studimore sipas të cilave i ka filluar studimet.

Gjatë ndryshimeve të statusit të institucioneve të larta arsimore, formohet komisioni amë për ndryshime të statusit. Për çështjet e emërimit dhe punës së komisionit amë për ndryshime të statusit zbatohen dispozitat e nenit 34 të Ligjit për arsim të lartë.

Ndryshimet e statusit regjistrohen në Regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë dhe në Regjistrin qendror.



### *Pushimi i institucionit publik të arsimit të lartë*

Neni 40

Atëherë kur Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të verifikojë se nuk ekziston më nevoja e funksionimit të ndonjë njësie të universitetit publik, përkatësisht të institucionit publik të pavarur të arsimit të lartë, njofton për shkaqet senatin e universitetit, përkatësisht organin drejtues të institucionit të pavarur të arsimit të lartë dhe i jep një afat të paktën prej 30 ditësh nga dita e njoftimit, të japë mendim lidhur me njoftimin e bërë.

Nëse Qeveria e Republikës së Maqedonisë edhe pas mendimit vlerëson se nuk ekziston nevoja për ushtrim të mëtejshëm të veprimtarisë së arsimit të lartë nga ndonjë institucion i caktuar i arsimit të lartë, i dorëzon Kuvendit propozim për miratimin e ligjit për pushimin e funksionimit të njësisë së universitetit publik përkatësisht institucionit publik të pavarur të arsimit të lartë. Në propozimin për miratimin e ligjit rregullohet mënyra se si studentët do të mund të vazhdojnë studimet.

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligjit nga paragrafi 2 i këtij neni, ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë merr vendim për fshirjen e institucionit nga regjistri i institucioneve të arsimit të lartë dhe për këtë bën kërkesë për fshirjen e institucionit të arsimit të lartë nga Regjistri qendror.

### *Pushimi i institucionit privat të arsimit të lartë*

Neni 41

Atëherë kur organi i themeluesit ka verifikuar se nuk ekziston më nevoja e ushtrimit të veprimtarisë së arsimit të lartë të një institucioni të caktuar privat të arsimit të lartë, ose nuk është në gjendje ta financojë veprimtarinë e tij kryesore, për këtë njofton për shkaqet organin drejtues të institucionit të arsimit të lartë dhe themeluesit ose pronarët e tjerë ose aksionarët nëse themelues është person juridik dhe u jep afat të paktën prej 30 ditësh për të vendosur nëse institucioni i arsimit të lartë do të vazhdojë të funksionojë duke siguruar burime të veta financiare, përkatësisht nëse financimin e institucionit të arsimit të lartë do ta marrë përsipër ndonjë nga themeluesit, nëse institucionin e arsimit të lartë e kanë themeluar dy ose më shumë themelues, ose ndonjë nga pronarët ose aksionarët, nëse themelues i institucionit të arsimit të lartë është person juridik. Nëse institucioni privat i arsimit të lartë është njësi e universitetit, për këtë vendim njoftohet edhe universiteti.

Nëse organi drejtues, përkatësisht themeluesi, pronari ose aksionari nga paragrafi 1 i këtij neni njofton themeluesin se nuk ekzistojnë kushte për ushtrim të mëtejshëm të veprimtarisë së arsimit të lartë nga burime të tij të financimit ose nga mjete financiare të një prej themeluesve, përkatësisht pronar ose aksionar, themeluesi merr vendim për pushimin e funksionimit të institucionit të arsimit të lartë. Në këtë vendim themeluesi është i obliguar ta përcaktojë mënyrën se si studentët do të vazhdojnë studimet.

Nëse mjetet financiare që themeluesi i ka siguruar për realizimin e garancive të dhëna nuk janë të mjaftueshme për realizimin e të drejtës së studentëve për vazhdimin e shkollimit, themeluesi për plotësimin e garancive të dhëna përgjigjet në mënyrë të pakufizuar me tërë pronën e tij.

Pas marrjes së vendimit për pushimin e funksionimit të institucionit të arsimit të lartë, ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë merr vendim për fshirjen e institucionit nga regjistri i institucioneve të arsimit të lartë dhe bën kërkesë për fshirjen e institucionit të arsimit të lartë nga Regjistri qendror.

Në rast të pushimit të funksionimit të institucionit privat të arsimit të lartë kur është përmbushur kushti nga paragrafi 2 i këtij neni, ose kur i është tërhequr akreditimi dhe është marrë vendim për heqjen e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë së arsimit të lartë në bazë të nenit 44 paragrafi 4 dhe 5 i këtij ligji, ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë, me propozim të Këshillit të akreditimit, do të marrë vendim me të cilin do të sigurojë përfundimin e studimeve të institucionit të arsimit të lartë që po likuidohet ose do të sigurojë transferimin e studentëve në një institucion tjetër të arsimit të lartë në vend që ka programe studimore të njëjta ose të ngjashme. Me vendim do të aktivohet edhe garancia financiare që ka dhënë themeluesi për tu kthyer mjetet financiare që studentët i kanë paguar institucionit të lartë që ka pushuar së funksionuari dhe për shpenzime të tjera që studentët do të kenë për përfundimin e studimeve.

### *Pushimi i universitetit*

Neni 42

Universiteti pushon së funksionuari nëse

- themeluesi verifikon se nuk ekziston më nevoja e funksionimit të universitetit;
- nëse ndërpret që ti plotësojë kushtet e themelimit të universitetit të caktuara në nenin 27 paragrafi 1 dhe neni 28 paragrafi 1 i këtij ligji,
- ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë ka marrë vendim për heqjen e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë së arsimit të lartë, në bazë të vendimit të Këshillit të akreditimit për tërheqjen e akreditimit në bazë të nenit 44 paragrafi 4 i këtij ligji dhe
- bën ndryshime të statusit.

Universiteti publik pushon së funksionuari me ligj, ndërsa universiteti privat me vendim të themeluesit.

Me aktin për pushimin e funksionimit të universitetit përcaktohet nëse disa njësi të universitetit do të vazhdojnë të funksionojnë dhe do t'i bashkëngjiten ndonjë universiteti tjetër ose do të vazhdojnë të funksionojnë si institucione të pavarura të arsimit të lartë.

### *Pushimi me falimentim*

Neni 43

Mbi një institucion publik të arsimit të lartë nuk realizohet falimentimi.

Institucioni privat i arsimit të lartë mund të pushojë së funksionuari me falimentim në përputhje me Ligjin për falimentim.

Garancia financiare që në bazë të këtij ligji e jep themeluesi i institucionit privat të arsimit të lartë nuk hyn në masën e falimentimit dhe përdoret vetëm për qëllimin për të cilin është dhënë në bazë të këtij ligji.

Nëse mjetet financiare të garancisë që në bazë të këtij ligji i ka dhënë themeluesi i institucionit privat të arsimit të lartë dhe mjetet financiare të masës së falimentimit nuk janë të mjaftueshme për dëmshpërblimin e studentëve që i kanë paguar institucionit të arsimit të lartë që ka pushuar së funksionuari dhe për shpenzimet e tjera që do të kenë studentët për shkak të transferimit të studimeve në një institucion tjetër të njëjtë ose të ngjashëm të arsimit të lartë në vend, themeluesi përgjigjet në mënyrë të pakufizuar me tërë pronën e tij në bazë të Ligjit për falimentim dhe Ligjit për institucione.

### *Heqja e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë së arsimit të lartë*

Neni 44

Ministria kompetente për funksionimin e arsimit të lartë, themeluesi, Këshilli i akreditimit dhe universiteti mund të ngrenë proces për heqjen e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë së arsimit të lartë.

Procedura nga paragrafi 1 i këtij neni mbahet para Këshillit të akreditimit.

Nëse Këshilli i akreditimit, në bazë të raportit të Agjencisë për evalvim, verifikon se institucioni i arsimit të lartë nuk përmbush kushtet e caktuara në nenin 27 paragrafi 1 alineja 4 dhe neni 28 paragrafi 1 nga ky ligj për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, me vërejtje me shkrim do ta obligojë institucionin e arsimit të lartë të mënjanojë mangësitë. Këshilli i akreditimit njofton universitetin nëse institucioni i arsimit të lartë është njësi e tij. [9](#)

Nëse brenda afatit të caktuara nga Këshilli i akreditimit, që nuk mund të jetë më i shkurtër se 60 ditë dhe jo më i gjatë se 120 ditë nga dita e pranimit të vërejtjes me shkrim nga paragrafi 3 i këtij neni, institucioni i arsimit të lartë nuk i mënjanon mangësitë për të cilat i është tërhequr vërejtja, Këshilli i akreditimit merr vendim për tërheqjen e akreditimit të dhënë dhe për këtë njofton ministrinë kompetente për funksionimin e arsimit të lartë.

Në bazë të vendimit për tërheqjen e akreditimit, ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë merr vendim për heqjen e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë së arsimit të lartë, vendim i cili është përfundimtar. Pas marrjes së vendimit, ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë e fshin institucionin e arsimit të lartë nga regjistri i institucioneve të arsimit të lartë dhe bën kërkesë për fshirjen e tij në Regjistrin qendror.

Kundër vendimit përfundimtar të ministrit kompetent për funksionimin e arsimit të lartë nga paragrafi 5 i këtij neni, mund të ngrihet padi pranë Gjykatës Administrative.

Institucioni i arsimit të lartë të cilit i është hequr e drejta e ushtrimit të veprimtarisë së arsimit të lartë, vazhdon me ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë deri në fund të vitit studimor në vijim.

## Kreu i pestë

# ORGANIZIMI I BRENDSHËM I UNIVERSITETIT DHE FORMAT E BASHKËPUNIMIT

### *Veprimtaria aplikative e institucioneve të arsimit të lartë*

Neni 45

Organizimi i brendshëm i universitetit rregullohet me ligj dhe me statutin e universitetit.

Njësia e universitetit për ushtrimin e veprimtarisë së saj, mund të organizojë institut, qendër, katedër, degë dhe njësi të tjera të brendshme organizative, nën kushte të përcaktuara nga statuti i universitetit.

Universiteti, nën kushte të caktuara me ligj dhe statut, përveç njësive në kuadrin e tij mund të ketë edhe njësi të tjera të brendshme organizative, me të cilat lidhet praktika, njohuritë, arti dhe arsimit të lartë dhe në funksionimin e të cilit mund të marrin pjesë studentët (zyrat inxhinierie, punëtori, qendra për konsulencë legale e biznesi, qendra të punës sociale dhe ndonjë lloj tjetër ndihme nga qytetarët, qendra të prodhimit provë, galeri, radio e stacione TV e të tjerë), parqe teknologjike.

Universiteti, nën kushtet e caktuara me ligj e me statut të universitetit për ushtrimin e veprimtarisë së tij, mundet të organizojë qendër klinike universitare, qendër, poliklinikë universitare, qendër sportive universitare, qendër klinike veterinare universitare, institute agrare universitare, qendra për kërkime dhe arsim të vazhdueshëm si mësimi i përjetshëm dhe forma të tjera nga veprimtaria e njësive.

Universiteti që në kuadrin e tij ka njësi nga fusha të ndryshme studimore mund t'i organizojë njësitë e universitetit në fusha, degë ose forma të tjera universitare.

Për arsye të ushtrimit të veprimtarisë së tij, universiteti mund të nënshkruajë marrëveshje e kontrata me klinika universitare dhe institucione të tjera kur kjo është e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë ose me shoqëri tregtare e institucione të tjera veprimtaria e të cilëve ka domethënie për ushtrimin e veprimtarisë së universitetit dhe ushtrimin e veprimtarisë aplikative parësore.

Universiteti themelon më së paku një qendër për karrierë. Qendra për karrierë mban evidencë të veçantë për studentët e mëparshëm (alumni) dhe organizon panairë për karrierë në çdo fakultet/universitet ku ka qendër për karriere.

Qendrat për karriere formohen për organizimin e mësimin praktik për studente për përgatitje të kuadrit profesional i cili do të aplikojë teknika dhe teknologji moderne inovative në arsim.

Qendrat për karrierë përbehen nga profili i këshilltarëve të cilët kanë njohuri nga fusha e arsimit. Qendrat për karrierë kanë për obligim të formojnë grupe të punës (nga përfaqësues të fakulteteve

teknike dhe odave ekonomike) dhe të organizojnë takime mujore me prezencë edhe të përfaqësuesve të Agjencisë për SDI për nevojat e kuadrit të tregut të punës dhe zvogëlimin e hendekut ndërmjet kërkesës dhe ofertës së krahut të punës.

Universiteti ose njësia në përbërje të tij, si edhe shkolla/institucioni i arsimit të lartë ka për obligim të lidhë së paku dy marrëveshje për bashkëpunim me universitetet prej 500 universiteteve të para të ranguara lartë sipas listës së Shangait, respektivisht 100 universitete më të mira të ranguara me programin MBA, si dhe institucion të lartë arsimor të akredituar në një nga 200 universitetet e para të ranguara më mire të sferës përkatëse shkencore, në pajtim me Universitetin Xhio Tong të Shangait, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement-World University Ranking.

Universiteti ose njësia në përbërje të tij, si edhe shkolla/ institucioni i arsimit të lartë ka për obligim të lidhë së paku dy marrëveshje për diplomë të dyfishtë (double degree) ose program të përbashkët studimor (joint degree) me Universitetet prej 500 universiteteve të para të ranguar lartë sipas listës së Shangait, respektivisht 100 universitete të ranguara më mire me programin MBA, si dhe institucion të lartë arsimor të akredituar të një nga 200 universitetet e para të ranguara më mire të sferës përkatëse shkencore, përkatësisht me Universitetin Xhio Tong të Shangait, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement- World University Ranking. [10](#)

### *Themelimi i një organizate tjetër*

Neni 46

Universitet, njësi të universitetit përkatësisht institucion i pavarur i arsimit të lartë, mundet nën kushte të caktuara me ligj dhe statut, për shitje të rezultateve të tyre shkencore, zbulime ose patenta, shërbime nga autorizime publike, njohuri eksperte, krijime artistike dhe realizime të tjera në ushtrimin e veprimtarisë aplikative, për ushtrimin e veprimtarisë botuese, për mbrojtjen e shëndetit të studentëve, për strehim dhe ushqim, për nevoja kulturore, sport e rekreacion të studentëve e të të punësuarve në institucionet e arsimit të lartë dhe për nevoja të tjera, në mënyrë të pavarur ose me ndonjë themelues tjetër të themelohë shoqëri tregtare ose institucion nën kushte të caktuara me ligj dhe statut. Këto nevoja, universiteti përkatësisht institucioni i arsimit të lartë, mundet ti realizojnë më me afat të gjatë në mënyrë kontraktuese me persona fizikë e juridikë.

Fitimi i shoqërisë tregtare, përkatësisht fitimi i institucionit i takon universitetit, njësisë së universitetit dhe institucionit të pavarur të arsimit të lartë dhe mund të shfrytëzohet për ecjen përpara të veprimtarisë së universitetit dhe njësive të universitetit që kanë marrë pjesë në krijimin e tij, përkatësisht, për veprimtarinë e institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

### *Shërbimi profesional dhe administrativ*

Neni 47

Për realizimin e punëve profesionale e administrative të universitetit, formohet shërbimi profesional e administrativ.

Organizimi i brendshëm i shërbimit profesional dhe administrative rregullohet me statutin e universitetit.

### *Format e bashkëpunimit të institucioneve të arsimit të lartë*

#### *Konferenca rektorale e universiteteve publike, respektivisht universiteteve private*

Neni 48

Për shkak të shqyrtimit dhe akordimit të çështjeve me interes të përbashkët dhe interesit për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, universitetet publike formojnë Konferencë rektorale të universiteteve publike që e përbëjnë rektorët e universiteteve publike të Republikës së Maqedonisë.

Për shkak të shqyrtimit të akordimit të çështjeve me rëndësi të përbashkët dhe interesit për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, universitetet private formojnë Konferencën rektorale të universiteteve private, që e përbëjnë rektorët e universiteteve private në Republikën e Maqedonisë.

Konferenca rektorale e universitare publike dhe Konferenca rektorale e universiteteve private paraqesin propozim Konferencës Ndëruniversitare për anëtarë të Këshillit për akreditim dhe të Agjencisë për evalvim.

Konferenca rektorale nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni, sjell rregullore me të cilën rregullohet mënyra e punës dhe vendosjes.

Neni 49

Për shkak të shqyrtimit dhe akordimit të çështjeve me interes të përbashkët, universitetet formojnë Konferencë Ndëruniversitare si organ juridik publik me të drejta dhe obligime të caktuara me këtë ligj dhe statutin e Konferencës Ndëruniversitare.

Konferenca Ndëruniversitare përbëhet prej rektorëve të universiteteve, kryetarët e parlamenteve studentore të universiteteve, 20 anëtarë nga radhët e punëtorëve mësimor-shkencor të zgjedhur nga senatet e universiteteve, me përqindje të përfaqësuar sipas pjesëmarrjeve të tyre në numrin e përgjithshëm të studentëve të rregullt për herë të parë të regjistruar në vitin studimor dhe një anëtar i zgjedhur nga radhët e drejtorëve të institucioneve të pavarur për arsim të lartë.

Në punën e Konferencës Ndëruniversitare merr pjesë ministri kompetent për arsim të lartë pa të drejtë vendosje.

Konferenca Ndëruniversitare nxjerr rregullore me të cilën përcaktohen mënyra e punës dhe vendimmarrja.

Për realizimin edhe të interesave tjera, universitetet respektivisht institucionet e pavarura për arsim të lartë mund me marrëveshje të organizojnë edhe forma tjera të bashkëpunimit të përbashkët dhe realizimin e punëve të veçanta.

## Kreu i gjashtë

# ORGANET DHE TRUPAT TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

### *Organet dhe trupat e universitetit*

Neni 50

Organe të universitetit janë: senati i universitetit, rektori dhe drejtoria rektoriale.

Në universitet formohet Këshilli i universitetit si trup i universitetit.

Universiteti privat në vend të këshillit të universitetit mund të ketë organ të themeluesit, me të drejta dhe detyrime të caktuara me aktin e themelimit dhe me statutin e universitetit, në përputhje me këtë ligj.

### *Senati i universitetit*

Neni 51

Senati i universitetit (në vijim të tekstit: senati) është organ drejtues dhe organ profesional i cili përbëhet nga përfaqësues të njëjësive të universitetit, të zgjedhur drejtpërdrejt dhe me votim të fshehtë nga radhët e profesorëve, përkatësisht këshilltarëve shkencorë dhe nga studentët. Studentët përbëjnë të paktën 15% të anëtarëve të senatit. Në senat çdo njësi e universitetit ka të paktën nga një përfaqësues. Rektori është anëtar i Senatit sipas pozitës. Prorektorët marrin pjesë në punën e senatit, pa të drejtë vote.

Në senat një numër i caktuar anëtarësh zgjedhin edhe anëtarët shoqërues të universitetit, të cilët marrin pjesë në punën dhe marrjen e vendimeve të senatit për çështje të përcaktuara me statutin e universitetit.

Numri dhe mënyra e zgjedhjes dhe e përjashtimit të anëtarëve të senatit, si dhe thirrja e mbajtjes së mbledhjeve të senatit, rregullohet me statutin e universitetit.

Anëtarët e senatit zgjidhen për një periudhë katër vjeçare.

### *Kompetencat e senatit*

Neni 52

Senati:

- miraton statutin e universitetit dhe jep pajtimin e tij për rregulloren e njëjësive në kuadër të tij,
- vendos për veprimtarinë mësimore, shkencore, artistike dhe veprimtarinë e lartë profesionale veprimtari (aplikative),
- miraton programet studimore të fakulteteve, përkatësisht të shkollave të larta profesionale,
- përcakton sferat shkencore, përkatësisht artistike, fushat dhe sferat mësimore si dhe disiplinat e mësimimit për të cilat njësitë në kuadër të tij ushtrojnë veprimtari të arsimit të lartë,

- i propozon Këshillit për zhvillim dhe financim të arsimit të lartë (në vijim të tekstit: Këshilli) bazat mbi të cilat do të realizohet bashkëfinancimi,
- vendos për krijimin e njësive të brendshme organizative, organizatave dhe shoqërive tregtare,
- jep mendim për bashkim, ndarje ose bashkëngjitje të njësive të veçanta të universitetit në përputhje me këtë ligj,
- vërteton mendimin për pushimin e funksionimit të njësive të caktuara të universitetit dhe për transformimin e tyre,
- miraton program vjetor e katërvjeçar për zhvillimin dhe punën e universitetit,
- jep mendim dhe propozime në Programin për realizim dhe zhvillim të veprimtarisë së arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë dhe jep mendim për programin vjetor për zhvillim të njësive në kuadrin e tij,
- jep mendim dhe propozime për programin kombëtar për veprimtari shkencore e kërkimore në Republikën e Maqedonisë,
- miraton raportin vjetor të punës së universitetit,
- miraton planin financiar vjetor të universitetit,
- miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar përfundimtar vjetor të universitetit,
- miraton programin e investimeve të universitetit dhe njësive në kuadrin e tij,
- zgjedh profesorët ordinarë,
- vendos lidhur me ndarjen e titullit doktor nderi i shkencave (Doctor honoris causa) dhe titullit profesor nderi i universitetit (Profesor honoris causa),
- zgjedh dhe pushon rektor dhe prorektorë të universitetit,
- vendos për kundërshtimin e dekanit të shkarkuar, përkatësisht drejtorit të njësisë të universitetit,
- vërteton zgjedhjen e dekanit, përkatësisht drejtor të njësive të universitetit që e ka bërë rektori,
- jep mendim në Konferencën ndëruniversitare për normat dhe standardet e ushtrimit të veprimtarisë së arsimit të lartë,
- miraton rregullore për kriteret dhe procedurat e zgjedhjes në tituj arsimorë-shkencorë, shkencorë dhe arsimorë dhe tituj,
- miraton rregullore për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit të studimeve të të tre cikleve të studimit,
- miraton rregullore për sistemin e vetëm të kredive dhe transferimin nga një program studimor në tjetrin, përkatësisht nga një njësi e universitetit në një tjetër,
- miraton rregullore për lëshimin e diplomave, shtesave të diplomave, titullit profesional, përkatësisht shkencor dhe dokumente të tjera për përfundimin e studimeve të arsimit të lartë dhe për kushtet e procedurës për tërheqjen e diplomës së lëshuar,
- miraton rregullore për mënyrën se si ekzekutohen çështjet profesionale-administrative me interes të përbashkët të njësive të universitetit,
- miraton rregullore për organizimin e veprimtarisë botuese,
- miraton program për bashkëpunim ndërkombëtar,
- përcakton obligimet e punës së të punësuarve dhe përcakton principet për rregullimin e marrëdhënieve të punës të të punësuarve që ushtrojnë veprimtari të arsimit të lartë, shkencore e artistike,
- formon komision për vetevalvim të universitetit dhe zgjedh anëtarët e tij,
- miraton rregullore për punën e senatit,
- ndërmerr masa për përparimin dhe mbrojtjen e standardit të studentëve dhe të punësuarve dhe
- realizon punë të tjera të caktuara me këtë ligj dhe me statutin e universitetit.



Senati mund të marrë vendime nëse në seancë marrin pjesë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të senatit, dhe merr vendime me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm.

Për çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet statusore, zgjedhjen e organeve të universitetit dhe zgjedhjen e profesorëve ordinarë, Senati mund të vendos nëse në seancë marrin pjesë së paku 2/3 nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të senatit ndërsa merr vendim me shumicë të anëtarëve prezent.

Në institucionet private të arsimit të lartë punët nga paragrafi 1 alinetë 6, 13,14 e 15 të këtij neni, janë nën kompetencën e organit të themeluesit.

### ***Rektori***

Neni 53

Rektori është organ menaxhimi.

Rektori e prezanton dhe përfaqëson universitetin në vend dhe jashtë tij.

Rektori zgjidhet nga radhët e profesorëve ordinarë për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë të edhe një përzgjedhje tjetër. Rektori zgjidhet në mënyrë dhe nën kushte të caktuara nga statuti i universitetit.

Rektori ushtron detyrën e tij në mënyrë profesionale dhe të drejtat e tij për marrëdhënie pune i realizon sipas kontratës së nënshkruar me senatin. Me kontratë rregullohet edhe vëllimi i angazhimit të tij si mësimdhënës në njësinë nga e cila është zgjedhur, që nuk mund të jetë më shumë se 30% e orarit të punës.

Universiteti ka një ose disa prorektorë, të cilët zgjidhen nga radhët e personave të zgjedhur në titujt mësimorë-shkencorë dhe shkencorë nga njësitë e universitetit. Prorektorët zgjidhen me propozim të rektorit, në mënyrë dhe sipas procedurës së caktuar nga statuti i universitetit.

Ushtrimi i detyrës rektor dhe prorektor nuk mund të bashkohet me ushtrimin e ndonjë funksioni tjetër shtetëror ose funksion në ndonjë parti politike.

Rektori nuk është e domosdoshme të zgjidhet nga radhët e universitetit. Mënyra e zgjedhjes dhe e pushimit të rektorit, më nga afër rregullohet nga statuti i universitetit.

### ***Kompetencat e rektorit***

Neni 54

Rektori në kuadër të menaxhimit me universitetin:

- harmonizon veprimtaritë e arsimit të lartë, ato artistike, kërkimore-shkencore dhe veprimtarinë aplikative si dhe çështje të tjera të universitetit,
- i konvokon dhe udhëheq me mbledhjet e Senatit,

- zbaton vendimet dhe konkluzionet e senatit,
- ndërmerr iniciativën për konvokimin e senatit,
- i shtron senatit dhe drejtorisë rektoriale propozime e vendime dhe akte të tjera të përgjithshme e konkluzione për çështje, shqyrtimi dhe zgjidhja e të cilëve janë në kompetencën e tyre,
- merr vendime lidhur me çështjet financiare e materiale që nuk janë kompetencë e senatit dhe universitetit publik,
- bën promocionin e doktorëve të shkencave,
- ndan çmime të universitetit,
- zgjedh dhe heq nga funksioni dekanë, përkatësisht drejtor të njësisë së universitetit,
- propozon organizimin e brendshëm të universitetit,
- drejton bashkëpunimin ndërkombëtar të universitetit dhe nis bashkëpunime me universitete tjera në vend e jashtë tij,
- i autorizon prorektorët për ushtrimin e një pjese të detyrimeve dhe të drejtave të tij,
- menaxhon me pronën e universitetit publik dhe kujdeset për mirëmbajtjen e saj dhe
- realizon punë të tjera të caktuara me këtë ligj, me statutin dhe me akte të tjera të përgjithshme të universitetit.

Rektori është i obliguar që të paktën një herë në vit, senatit, këshillit të universitetit dhe themeluesit, t'i japë raport për punën e tij dhe për punën e universitetit.

Nëse senati nuk e pranon raportin nga paragrafi 2 i këtij neni, nis procedurë për heqjen nga detyra të rektorit të universitetit.

Përmbajtja dhe forma e raportit nga paragrafi 2 i këtij neni më afërsisht përcaktohen me dekret për formën dhe përmbajtjen e raportit për punën e rektorit, të cilin me propozim të ministrisë kompetente për arsimin e lartë e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Deri në zgjedhjen e rektorit, kryerës i detyrës rektor është njeri nga prorektorët e universitetit i cili zgjidhet nga anëtarët e senatit me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të senatit. Prorektori si kryerës i detyrës rektor i ka të gjitha të drejtat dhe obligimet e rektorit.

Prorektori e kryen detyrën rektor deri në zgjedhjen e rektorit, në rast të pushimit të mandatit të rektorit nga shkaqet si vijon:

- nëse vet e kërkon këtë;
- nëse përgjithmonë e humb aftësinë për kryerjen e detyrës rektor;
- nëse i plotëson kushtet për pension të moshës ose
- nëse është shkarkuar para kalimit të mandatit.

### ***Përgjegjësia e rektorit për ligjshmërinë dhe statutshmërinë***

Neni 55

Rektori është përgjegjës për ligjshmërinë dhe statutshmërinë e punës së universitetit dhe të njësisive në kuadër të tij dhe ka të drejtë e për detyrë të ndalojë zbatimin, përkatësisht të shfuqizojë ndonjë akt të organeve të tyre, për të cilin mendon se nuk është në përputhje me ligjin, statutin, ndonjë akt të përgjithshëm ose vendim të universitetit.

Njësia e universitetit, akti i të cilës është shfuqizuar, mund të ankohet pranë senatit. Vendimi i senatit është përfundimtar.

Nëse brenda afatit të caktuar me statutin e universitetit, njësia nuk propozon kandidatë për dekan përkatësisht drejtor, rektori emëron ushtrues të përkohshëm të detyrës dekan, përkatësisht ushtrues të detyrës drejtor, për një kohë të caktuar nga statuti i universitetit.

Në bazë të statutit të universitetit, për mosrespektim të ligjit, statutit, akteve të përgjithshme ose vendim të universitetit, rektori mund të pushojë dekan ose drejtor të njësisë së universitetit dhe të emërojë ushtrues të përkohshëm të detyrës dekan.

Senati brenda 30 ditësh, nga dita e pushimit të dekanit, merr vendim lidhur me vendimin e rektorit nga paragrafi 4 i këtij neni. Nëse senati e vërteton pushimin, i propozon rektorit heqjen nga detyra të dekanit përkatësisht drejtorit dhe brenda tre muajsh të nisat procedurë për zgjedhje të dekanit përkatësisht drejtorit.

### *Drejtoria rektoriale*

Neni 56

Drejtoria rektoriale përbëhet nga rektori, prorektorët, dekanët e fakulteteve, drejtorët e shkollave të larta profesionale, drejtorët e institucioneve të akredituara shkencore dhe përfaqësues të studentëve.

Me drejtorinë rektoriale menaxhon rektori.

Organizimi dhe mënyra e punës së drejtorisë rektoriale, si dhe numri i përfaqësuesve të studentëve, caktohet më nga afër me statutin e universitetit.

### *Kompetencat e drejtorisë rektoriale*

Neni 57

Drejtoria rektoriale:

- përgatit dhe propozon aktet dhe materialet për çështje për të cilat vendos senat,
- e përcakton dhe shpall konkursin për regjistrimin e studimeve të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, me pëlqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë,
- miraton programet studimore të fakulteteve, përkatësisht të shkollave të larta profesionale,
- me propozim të rektorit zgjedh dhe pushon sekretarin e përgjithshëm të universitetit,
- merr vendime lidhur me bashkëpunimin aktual ndërkombëtar të universitetit,
- miraton lëshimin e diplomave dhe dokumenteve të tjera për studime të arsimit të lartë,
- cakton propozimin për shumën e bashkëfinancimit dhe participimit të studentëve në institucionet publike të arsimit të lartë,
- vendos mbi veprimtarinë botuese të universitetit dhe
- realizon punë të tjera të caktuara me statutin e universitetit.

## *Këshilli i universitetit*

Neni 58

Këshilli i universitetit ka të paktën 11 anëtarë. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit të universitetit, gjashtë anëtarë i propozon senati i universitetit, persona që nuk janë anëtarë të senatit, nga të cilët të paktën një është student, tre anëtarë emëron themeluesi, një anëtar përfaqësues i organizatës së punëdhënësve në Republikën e Maqedonisë dhe një anëtar përfaqësues i vetëqeverisjes lokale, caktuar me statut të universitetit. Në punën e këshillit të universitetit merr pjesë edhe rektori, por pa të drejtë vote.

Mandati i anëtarëve të këshillit të universitetit zgjat katër vjet, me përjashtim të anëtarëve të zgjedhur nga radhët e studentëve mandati i të cilëve zgjat dy vjet.

Këshilli i universitetit, nga radhët e tij, zgjedh kryetar.

Si anëtar i këshillit të universitetit nuk mund të jetë person i cili në bazë të nenit 43 Ligji për institucionet nuk mund të jetë anëtar i ndonjë organi drejtues të ndonjë institucioni si dhe person i punësuar në drejtorinë e universitetit, në ministrinë kompetente për funksionimin e arsimit të lartë, përkatësisht shkencës, person i emëruar në funksion në ndonjë organ shtetëror ose njësi të vetëqeverisjes lokale ose i zgjedhur në ndonjë organ të ndonjë partie politike.

Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit të universitetit më nga afër rregullohen me statutin e universitetit.

## *Kompetencat e këshillit të universiteti*

Neni 59

Këshilli i universitetit mbikëqyr ushtrimin e veprimtarisë së universitetit, detyrave të universitetit në përputhje me këtë ligj, ligjshmërinë e funksionimit të tij, shfrytëzimin racional të burimeve njerëzore e atyre materiale, dhe realizon edhe punë të tjera të caktuara me aktin e themelimit dhe statutin e universitetit.

Këshilli i universitetit nuk mund të ketë kompetenca nga të cilat mund të kufizohet ose cenohet autonomia e universitetit.

Këshilli i universitetit të paktën një herë në vit i dorëzon informatë ministrisë kompetente për arsim të lartë dhe Senatit të universitetit.

Kompetenca dhe mënyra e marrjes së vendimeve të këshillit të universitetit më nga afër rregullohet me këtë ligj dhe me statutin e universitetit.

### *Organi i themeluesit të institucionit privat të arsimit të lartë*

Neni 60

Organ menaxhimi në universitet privat, përkatësisht në institucion privat të arsimit të lartë është organi i themeluesit.

Numrin dhe përbërjen e organit nga paragrafi 1 i këtij neni i përcakton themeluesi me aktin e themelimit të universitetit dhe me statutin e universitetit.

Organi i themeluesit nuk mund të ketë të drejta e detyrime me të cilat kufizohet dhe cenohet autonomia e institucionit të arsimit të lartë ose kufizohen të drejtat e detyrimet e organeve të universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë të caktuara nga ky ligj.

### *Organe të fakultetit dhe të shkollës së lartë profesionale*

Neni 61

Organe të fakultetit, si njësi universiteti, janë këshilli mësimor-shkencor, dekani dhe drejtoria e dekanatit.

Organe të shkollës së lartë profesionale, si njësi e universitetit, janë këshilli pedagogjik, drejtori dhe drejtoria e shkollës së lartë profesionale.

Institucionet private të arsimit të lartë kanë mundësi në mënyrë të përshtatshme t'i zbatojnë dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me organet e fakultetit, përkatësisht të shkollës së lartë profesionale sipas mënyrës në të cilën është i organizuar universiteti.

Organet e institucionit të lartë mësimor privat nuk mund të kenë të drejta e detyrime që kufizojnë e cenojnë autonominë e institucionit të arsimit të lartë të caktuara me këtë ligj.

### *Këshilli mësimor-shkencor, përkatësisht këshilli pedagogjik*

Neni 62

Organ profesional i fakultetit është këshilli mësimor-shkencor, ndërsa i shkollës së lartë profesionale është këshilli pedagogjik.

Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit nga fusha e artit ose nga akademia e arteve mund të mbajë emrin këshill mësimor-shkencor artistik.

Këshilli mësimor-shkencor përbëhet nga profesorët ordinarë dhe inordinarë dhe docentët. Këshilli pedagogjik përbëhet nga profesorët, mësimdhënësit e lartë dhe mësimdhënësit.

Në fakultet, përkatësisht në shkollën e lartë profesionale ku janë zgjedhur mbi 120 mësues, këshillin mësimor-shkencor e përbëjnë përfaqësues të zgjedhur nga njësitë organizative (katedra, institute, qendra etj.), nga radhët e profesorëve ordinarë e ata inordinarë dhe docentëve. Zgjedhja

bëhet në raport me mësuesit e zgjedhur, përkatësisht të renditur në njësinë organizative në mënyrë dhe sipas kushteve të caktuara nga statuti i universitetit dhe nga rregullorja e njësisë.

Personat që janë në marrëdhënie pune në institucion shëndetësor dhe janë zgjedhur në titujt mësues-shkencorë, shkencorë, mësues dhe titull në institucionin e arsimit të lartë dhe ushtrojnë veprimtari të arsimit të lartë dhe të institucionit të arsimit të lartë, kanë status mësuesdhënësi.

Në këshillin arsimor-shkencor, përkatësisht pedagogjik, përfaqësues të tyre zgjedhin studentët.

Numri i përfaqësuesve të studentëve dhe koha e zgjedhjes së tyre caktohen me statutin e universitetit dhe rregulloren e njësisë së universitetit, përkatësisht me statutin e institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

Numri i përfaqësuesve nga radhët e studentëve nuk mund të jetë më i vogël se 10% nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit mësues-shkencor.

Këshilli mësues-shkencor, përkatësisht pedagogjik për programe studimore ose për nevoja të tjera mund të formojë trupa profesionale të caktuar nga statuti.

Institutet shkencore të akredituara për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, në bazë të kushteve të caktuara nga statuti i universitetit, themelojnë këshill shkencor për studimet nga cikli i dytë e i tretë, që përbëhet nga persona të zgjedhur në tituj shkencorë dhe tituj të cilët marrin pjesë në realizimin e orës së mësimit dhe përfaqësues nga studentët.

### ***Kompetencat e këshillit mësues-shkencor dhe këshillit pedagogjik***

Neni 63

Këshilli mësues-shkencor, përkatësisht këshilli pedagogjik:

- miraton rregulloren e njësisë,
- miraton programin katërvjeçar për zhvillim dhe programin vjetor të punës,
- përcakton një ose më shumë kandidatët për dekan përkatësisht drejtor dhe ia dorëzon rektorit të universitetit,
- zgjedh prodekanë përkatësisht zëvendësdrejtorë,
- i propozon senatit programe studimore,
- miraton programe për punën kërkimore-shkencore, përkatësisht artistike,
- bën zgjedhje në tituj mësues-shkencorë docent dhe profesorë inordinarë dhe në tituj,
- propozon numrin e studentëve që do të regjistrohen në vitin e parë të studimeve,
- i propozon drejtorisë së dekanatit masa për krijimin dhe perfeksionimin e kuadrove të rinj arsimorë-shkencorë e artistik dhe masa për punë veçanërisht me studentë të suksesshëm dhe të talentuar,
- i propozon drejtorisë së dekanatit masa dhe merr vendime lidhur me përparimin e punës pedagogjike, kërkimore-shkencore dhe punës aplikuese si dhe lidhur me rrjetin kompjuterik,
- zgjedh sekretarin e fakultetit përkatësisht të shkollës së lartë profesionale, në përputhje me statutin e universitetit,

- zgjedh anëtarët e komisionit të vetevalvimit dhe miraton udhëzues për evalvimin e fakultetit përkatësisht të shkollës së lartë profesionale,
- merr vendime lidhur me bibliotekën, me sistemin bibliotekar-informativ dhe me realizimin e veprimtarisë bibliotekare-informative dhe asaj dokumentuese, në përputhje me statutin e universitetit,
- merr vendime lidhur me takimet, simpoziumet, këshillimet etj.,
- merr vendime lidhur me realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në përputhje me statutin e universitetit dhe
- realizon punë të tjera të caktuara me këtë ligj dhe me statutin e universitetit.

Këshilli mësimor-shkencor, përkatësisht këshilli pedagogjik merr vendime fuqiplote nëse në seancë janë të pranishëm më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, ndërsa merr vendime me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm.

Gjatë zgjedhjes në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë nuk marrin pjesë studentë.

Për çështjet nga paragrafi 1, alinetë 1, 3, 4, 5 e 7 të këtij neni, këshilli mund të marrë vendime fuqiplote nëse janë të pranishëm më shumë se dy të treta e e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, ndërsa vendimi llogaritet si i marrë nëse për të ka votuar shumicë e anëtarëve të pranishëm të këshillit.

Këshilli arsimor - shkencor për çështjet nga paragrafi 1 i këtij neni vendos me votim publik.

Me përjashtim të paragrafit 5 të këtij neni për çështje të caktuara të përcaktuara me statut, këshilli arsimor-shkencor mund të vendosë për votim të fshehtë.

### ***Dekani përkatësisht drejtori dhe kompetencat e tij***

Neni 64

Dekani i fakultetit përkatësisht drejtori i shkollës së lartë profesionale është organ drejtues.

Dekani, përkatësisht drejtori i shkollës së lartë profesionale përfaqëson fakultetin, përkatësisht shkollën e lartë profesionale në vend dhe jashtë tij, në përputhje me statutin e universitetit përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë. Ushtrimi i detyrës dekan dhe prodekan, përkatësisht drejtor i shkollës së lartë profesionale nuk mund të bashkohet me ushtrimin e ndonjë funksioni tjetër shtetëror ose funksion në ndonjë parti politike.

Dekani përkatësisht drejtori në kuadër të ushtrimit të funksionit të tij drejtues:

- zbaton vendimet dhe konkluzionet e senatit dhe rektorit të universiteti,
- zbaton vendimet dhe konkluzionet e këshillit mësimor-shkencor, përkatësisht pedagogjik,
- kujdeset për ushtrim të akorduar të veprimtarisë së arsimit të lartë, asaj artistike, kërkimore-shkencore dhe veprimtarisë aplikative,
- konvokon seancat e këshillit arsimor-shkencor, përkatësisht pedagogjik, propozon rendin e ditës dhe kryeson me to,

- përgatit dhe propozon aktet dhe materialet për çështje për të cilat vendos drejtorja e dekanatit,
- i dorëzon propozime e vendime dhe konkluzione këshillit mësimor-shkencor, përkatësisht pedagogjik, shqyrtimi dhe zgjidhja e të cilave është në kompetencat e tij,
- hap konkurse për zgjedhje të personave në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë-artistikë, shkencorë dhe mësimorë dhe pozicione gjashtë muaj para përfundimit të afatit për të cilin janë zgjedhur,
- bën promocionin e studentëve të diplomuar dhe ndan çmime,
- administron me pronën e fakultetit, përkatësisht të shkollës së lartë profesionale dhe kujdeset për mirëmbajtjen e saj në kuadër të autorizimeve të caktuara me rregulloren e fakultetit, respektivisht shkollës së lartë profesionale dhe statutin e universitetit publik dhe
- realizon edhe punë të tjera në përputhje me këtë ligj, me statutin e universitetit dhe me rregulloren e fakultetit, përkatësisht shkollës së lartë profesionale.

Dekani, përkatësisht drejtori është i obliguar të paktën një herë në vit t'i japë raport këshillit mësimor-shkencor, përkatësisht pedagogjik dhe rektorit të universitetit për punën e tij.

Dekani, përkatësisht drejtori është përgjegjës për ligjshmërinë dhe statutshmërinë e punës së organeve të fakultetit, përkatësisht shkollës së lartë profesionale dhe ka të drejtë e për detyrim ta ndalojë ekzekutimin e ndonjë akti të përgjithshëm dhe ndonjë vendimi të këtyre organeve për të cilin mendon se nuk është në përputhje me ligjin statutin e universitetit dhe rregulloren e fakultetit, përkatësisht shkollës së lartë profesionale dhe për këtë njofton rektorin, i cili merr vendim për këtë çështje kontestuese.

Për ushtrimin e një pjese të të drejtave e detyrimeve të tij dekani mund të autorizojë prodekanë të caktuar, përkatësisht zëvendësdrejtorin.

### *Zgjedhja dhe shkarkimi i dekanit, përkatësisht drejtorit*

Neni 65

Dekani, përkatësisht drejtori zgjidhet nga radhët e profesorëve ordinarë dhe inordinarë, dhe nëse nuk ka profesorë ordinarë dhe inordinarë të njësisë së universitetit, respektivisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë, e nëse nuk ka profesorë ordinarë dhe inordinarë edhe nga radhët e docentëve për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë edhe të një rizgjedhjeje, nën kushtet e caktuara me statutin e universitetit, përkatësisht institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

Fakulteti, përkatësisht shkolla e lartë profesionale mund të ketë një ose disa prodekanë, përkatësisht zëvendësdrejtor, që i propozon dekani, përkatësisht drejtori.

Nëse këshilli mësimor-shkencor, përkatësisht pedagogjik nuk e pranon raportin për punën e dekanit, përkatësisht të drejtorit, nis procedura për shkarkimin e tij nga funksioni.

Mënyra e zgjedhjes dhe e shkarkimit të dekanit e prodekanëve, përkatësisht drejtorit dhe zëvendësdrejtorit më nga afër rregullohen me rregulloren e njësisë, në përputhje me statutin e universitetit.



## *Drejtoria e dekanatit, përkatësisht drejtoria e shkollës së lartë profesionale*

Neni 66

Drejtoria e dekanatit, përkatësisht drejtoria e shkollës së lartë profesionale është organ drejtues i njësisë së universitetit dhe mund të ketë të jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 15 anëtarë.

Drejtoria e dekanatit, përkatësisht drejtoria e shkollës së lartë profesionale përbëhet nga dekani, përkatësisht drejtori, prodekanët, përkatësisht zëvendësdrejtori dhe drejtuesit e njësive të brendshme organizative mësimore-shkencore, përkatësisht pedagogjike të përcaktuara me rregullore e njësisë dhe të paktën një anëtar i zgjedhur nga parlamenti i studentëve.

Drejtoria e dekanatit, përkatësisht drejtoria e shkollës së lartë profesionale konvokon seancë dhe me të kryeson dekani, përkatësisht drejtori.

Drejtoria e dekanatit, përkatësisht drejtori i shkollës së lartë profesionale në kuadër të kompetencave të saj:

- kujdeset për realizimin e veprimtarisë dhe zhvillimin e fakultetit, përkatësisht shkollës së lartë profesionale dhe për marrëdhëniet me bashkësinë më të gjerë shoqërore dhe organet shtetërore,
- sjell akte dhe ndjek zbatimin e tyre, përveç akteve që në bazë të këtij ligji janë kompetencë e këshillit mësimor-shkencor, përkatësisht pedagogjik,
- miraton planin financiar dhe bilancin (raportin financiar vjetor) në kuadër të planit të vetëm financiar të universitetit dhe bilancin e konsoliduar të universitetit publik,
- i propozon universitetit, përkatësisht nëse është e caktuar me këtë ligj themeluesit, ndryshim ose zgjerim të veprimtarisë në përputhje me këtë ligj,
- përgatit dhe propozon aktet dhe materialet për çështje për të cilat vendos drejtoria këshilli mësimor-shkencor, përkatësisht pedagogjik dhe dekani, përkatësisht drejtori dhe
- realizon edhe punë të tjera të përcaktuara me rregulloren e fakultetit, përkatësisht shkollës së lartë profesionale.

Drejtorisë së dekanatit, përkatësisht drejtorisë së shkollës së lartë profesionale nuk mund t'u besohen kompetenca dhe as nuk mund të marrë vendime për çështje me të cilat kufizohet e cenohet autonomia si njësi e universitetit.

Organizimi, mënyra e punës e drejtorisë së dekanatit, përkatësisht drejtorisë së shkollës së lartë profesionale, si dhe numri dhe mënyra e zgjedhjes së përfaqësuesve të studentëve, më nga afër rregullohen me rregulloren e njësisë.

## *Këshilli i bashkëpunimit dhe mirëbesimit me publikun*

Neni 67

Për të realizuar bashkëpunim dhe mirëbesim me publikun, bashkësia afariste, dhomat profesionale dhe institucione e shoqata të tjera qytetarësh nga fusha në të cilën ushtron veprimtari të arsimit të lartë dhe punë kërkimore-shkencore si dhe për të realizuar publik dhe përgjegjësi për ushtrimin e veprimtarisë me interes publik, njësia e universitetit formon këshill të

fakultetit për bashkëpunim dhe mirëbesim me publikun, përkatësisht këshill të shkollës së lartë profesionale për bashkëpunim dhe mirëbesim me publikun.

Si anëtar i këshillit për bashkëpunim dhe mirëbesim me publikun nuk mund të jetë person i cili në bazë të nenit 43 të Ligjit për institucione nuk mund të jetë anëtar i ndonjë organi drejtues të ndonjë institucioni. Përbërja dhe mënyra e delegimit të anëtarëve të tij caktohet me rregulloren e fakultetit, përkatësisht shkollës së lartë profesionale.

Lidhur me çështjet për të cilat diskuton këshilli për bashkëpunim dhe mirëbesim me publikun, miratohen rekomandime.

Obligim i Këshillit për Bashkëpunim dhe Mirëbesim është që të kryejë promovimin e këshillave tanimë ekzistues nga universitetet, shqyrtimin e aktiviteteve të këshillit në mbledhje të rregullta të konferencës së rektorëve të universiteteve publike, respektivisht konferencës ndëruniversitare, t'i japë mendim Senatit të Universitetit për programin studimor. Senati i Universitetit në detyrimisht paraqet mendim për programin studimor të Këshillit për Akreditim dhe Evalvim para miratimit të tij.

Këshillat për Bashkëpunim dhe Mirëbesim me publikun të institucioneve të arsimit të lartë kanë rol këshillëdhënës dhe në to janë anëtarë përfaqësues të komunës/qytetit të Shkupit ku është formuar Këshilli, themeluesi, përfaqësues relevante të komunitetit afarist ose joekonomik nga fushëveprimi i programeve studimore, si dhe ministria kompetentë për çështjet e arsimit të lartë.

Kriteret dhe kompetencat më të afërta të Këshillit për Bashkëpunim dhe Mirëbesim me publikun i përcakton ministri kompetent për çështjet e arsimit të lartë me akt nënligjor.

## **Kreu i shtatë**

### **SIGURIMI DHE VLERËSIMI I CILËSISË I ARSIMIT TË LARTË**

#### *Këshilli për akreditim dhe evalvim të arsimit të lartë*

Neni 68

Sigurimin dhe vlerësimin e kualitetit të arsimit të lartë e kryen Këshilli për akreditim dhe evalvim të arsimit të lartë (në tekstin e mëtejme: Këshilli).

Këshilli ka vulën e cila përmban mbishkrimin: Republika e Maqedonisë-Këshilli për akreditim dhe evalvim të arsimit të lartë-Shkup. Në mes të vulës është stema e Republikës së Maqedonisë.

#### *Sistemi i sigurimit dhe vlerësimit të kualitetit të arsimit të lartë*

Neni 69

Sistemi i sigurimit dhe vlerësimit të kualitetit të arsimit të lartë përfshin:

- lejimin, vërtetimin dhe pranimin e institucionit të arsimit të lartë dhe të programeve studimore, për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë në pajtim me këtë ligj, që realizohet nëpërmjet

akreditimit (në tekstin e mëtejshëm: akreditimi),

- vlerësimin e kualitetit të kryerjes së veprimtarisë së arsimit të lartë, menaxhimin, financimin, aktivitetet akademike dhe të tjera dhe prioritetet e tij, që realizohet nëpërmjet sistemit të evalvimit (në tekstin e mëtejshëm: evalvimi) dhe

- aktivitete dhe mekanizma të tjerë nëpërmjet të cilëve zhvillohet dhe mbahet kualiteti i arsimit të lartë të përcaktuara me ligj dhe me aktet e trupave që e vlerësojnë kualitetin e arsimit të lartë.

Evalvimi kryhet nëpërmjet metodave të evalvimit si evalvimi i jashtëm, vetevalvimi, si dhe nëpërmjet sistemit të vlerësimit të kualitetit të kuadrit akademik.

Gjatë kryerjes së evalvimit të jashtëm për sigurimin e kualitetit të unifikuar të arsimit të lartë në hapësirën e vetme evropiane për arsimin e lartë, zbatohen procedurat dhe standardet e pranuar dhe udhëzuesi (drejtimet) të cilat zbatohen nga Asociacioni Evropian për Evalvim në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe nga institucionet, organizatat dhe asociacionet tjera të cilat i vendosin dhe i zbatojnë standardet dhe udhëzimet evropiane për evalvim për kryerjen e evalvimit të jashtëm, si dhe shërbimet e organizatave dhe asociacioneve të njohura ndërkombëtare të cilat kryejnë sigurimin e kualitetit të arsimit të lartë.

Evalvimin e jashtëm, sipas rregullit, e kryejnë komisionet në sfera dhe zona të veçanta të përbëra së paku prej tre profesorëve nga universitetet e njohura ndërkombëtarisht në tituj ekuivalente me titujt profesor i çrregullt dhe profesor i rregullt dhe së paku me tre vjet përvojë në kryerjen e evalvimit të jashtëm. Njeri nga anëtarët e komisionit është kryetar i komisionit.

Komisionet nga paragrafi 4 i këtij neni i formon Këshilli.

Evalvimi i jashtëm kryhet me kritere të përcaktuara me udhëzim për mënyrën e sigurimit dhe vlerësimit të kualitetit të institucioneve të arsimit të lartë dhe kuadrit akademik në Republikën e Maqedonisë, të cilin e miraton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

Rezultatet nga evalvimi i kualitetit të arsimit të lartë përfshihen në raportet të cilat janë të arritshme për publikun.

### *Përbërja dhe zgjedhja e Këshillit*

Neni 70

Këshilli përbëhet prej 23 anëtarëve nga të cilët nëntë nga radhët e profesorëve të zgjedhur nga Konferenca Ndëruniversitare, në mënyre adekuate me përfaqësimin e universiteteve sipas pjesëmarrjes së tyre në numrin e përgjithshëm të studentëve që janë regjistruar për herë të parë në vitin studimor, dy anëtarë nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, një përfaqësues i trupit me reprezentues të punëdhënësve, dy anëtarë nga parlamenti ndëruniversitar i studentëve dhe nëntë anëtarë të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, nga të cilët së paku gjashtë anëtarë janë nga radhët e profesorëve të institucioneve të arsimit të lartë.

Anëtarë të Këshillit nuk mund të jenë personat e zgjedhur për rektor dhe prorektor të universitetit, dekan i fakultetit, përkatësisht drejtor i shkollës së lartë profesionale dhe drejtor i institucionit shkencor që realizon veprimtari të arsimit të lartë.

Anëtar i Këshillit për Akreditim dhe Evalvim mund të jetë vetëm personi që i plotëson kushtet për mentor të punimit të doktoraturës. [11](#)

Anëtarët e Këshillit zgjidhen për periudhë prej katër vitesh. Një person nuk mund të zgjidhet më tepër se dy herë të njëpasnjëshme.

Anëtarët e Këshillit janë të pavarur dhe të mëvetësishëm në punën e vet dhe nuk mund të revokohen para kalimit të kohës për të cilën janë zgjedhur, përveç nëse anëtarit të Këshillit i ka pushuar statusi i profesorit në marrëdhënie punë në çdo lloj baze, kur është emëruar apo zgjedhur në funksion për shkak të të cilit nuk do të mund të zgjidhet për anëtar, kur Këshilli konstaton se anëtari më tepër se gjashtë muaj nuk është në gjendje t'i kryejë obligimet dhe kur ekziston konflikt interesash i përcaktuar me ligj.

Mbledhjen konstituive të Këshillit e konvokon ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

Kryetari i Këshillit, e paraqet dhe e përfaqëson Këshillin. [12](#)

### ***Kompetencat e Këshillit***

Neni 71

Këshilli është i mëvetësishëm në punën e vet dhe vendos në suazat e kompetencës së vet në bazë të parimit të profesionalizmit dhe kompetencës.

Këshilli në suazat e të drejtave dhe detyrimeve të veta:

- përcakton nëse me projektin për themelimin e institucionit të arsimit të lartë dhe dokumentacionin e parashtruar janë plotësuar kushtet për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë,
- vendos për akreditimin e institucionit shkencor që dëshiron të kryejë veprimtari të arsimit të lartë të studimeve nga cikli i dytë dhe i tretë i studimeve,
- përcakton nëse institucioni i arsimit të lartë i plotëson kushtet për organizimin e studimeve për programe të reja studimore dhe e përcakton kapacitetin për studim në institucionin e arsimit të lartë,
- jep akreditimin e programeve studimore
- më së shumti çdo pesë vjet e ndjek dhe e vlerëson kualitetin e kryerjes së veprimtarisë së arsimit të lartë, punës shkencore- hulumtuese, artistike dhe profesionale, të kuadrit akademik dhe programeve studimore të institucioneve të arsimit të lartë dhe në bazë të vlerësimit e vazhdon ose e merr akreditimin,
- në bazë të raporteve nga evalvimi i jashtëm i institucioneve të arsimit të lartë, e ndjek plotësimin e kushteve të institucioneve të arsimit të lartë të cilave u është dhënë akreditim dhe lejim për fillimin me pune dhe në bazë të kësaj mund ta marrë akreditimin,
- mban evidencë për institucionet e akredituara të arsimit të lartë dhe për akreditime të tjera,

- jep rekomandime të nevojshme për përmirësimin e normativave dhe standardeve për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë dhe
- kryen punë tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Këshilli boton raport për rezultatet nga evalvimi i jashtëm të cilin e dërgon në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, ministrinë kompetente për punët e arsimit të lartë dhe në institucionin e arsimit të lartë për të cilin është kryer evalvimi.

Këshilli e informon ministrin kompetent për punët e arsimit të lartë për lejet dhe akreditimet e marra dhe për rezultatet nga evalvimi.

### *Organizimi dhe puna e Këshillit*

Neni 72

Organizimi, puna, mënyra e vendosjes, metodologjia për akreditim dhe evalvim, standardet për akreditim dhe evalvim, si dhe çështjet tjera në lidhje me punën e Këshillit, më afërsisht rregullohen me rregullore.

Rregulloren nga paragrafi 1 i këtij neni e miraton Këshilli me pëlqim të marrë paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Këshilli nga radhët e anëtarëve formon komisione profesionale për nevojat e kryerjes së akreditimit dhe evalvimit. Nëse në Këshill nuk ka anëtar që është adekuat për zonën, fushën ose sferën e caktuar shkencore, Këshilli në komisione mund të angazhojë edhe persona të jashtëm profesionalë.

Mjetet për punën e Këshillit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në program të veçantë dhe nga të hyrat personale.

Ministri kompetent për punët e arsimit të lartë me akt i përcakton llojin dhe lartësinë e kompensimeve për shpenzimet në procedurën e akreditimit në bazë të shpenzimeve të bëra reale.

Punët profesionale dhe administrative për nevojat e Këshillit i kryen ministria kompetente për punët e arsimit të lartë.

Këshilli në pjesën e evalvimit ndërmerr aktivitete në pajtim me kompetencat e përcaktuara në udhëzimin për evalvim dhe rregulloren për organizimin, punën, mënyrën e vendimmarrjes, metodologjinë për akreditim dhe evalvim, si dhe çështje tjera lidhur me Këshillin për Akreditim dhe Evalvim të Arsimit të Lartë i cili miratohet pas mendimit pozitiv paraprak të marrë nga ministri kompetent për çështjet e arsimit të lartë.

### *Evalvimi i institucioneve të arsimit të lartë*

Neni 73

## ***Agjencia për evalvim***

Neni 74

*I fshirë*

## ***Kompetencat e Agjencisë për evalvim***

Neni 75

*I fshirë*

## ***Organizimi dhe puna e Agjencisë për evalvim***

Neni 76

*I fshirë*

## ***Vetevalvimi***

Neni 77

Vetevalvim të universitetit, njërive të universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë bën komisioni për vetevalvim i universitetit, përkatësisht njësi organizative për vetevalvim e universitetit, komisioni për vetevalvim i njësisë, përkatësisht i institucionit të pavarur të arsimit të lartë, në mënyrë dhe sipas kushteve të caktuara me statutin e universitetit dhe statutin e institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

Anëtarët e komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni zgjidhen me votim të fshehtë nga senati i universitetit, përkatësisht nga këshilli pedagogjik-shkencor, këshilli pedagogjik ose këshilli shkencor, nga radhët e mësuesve më mandat prej katër vjetësh dhe përfaqësuesve të studentëve, për një periudhë kohore prej dy vjetësh.

Komisionet nga paragrafi 1 i këtij neni, vetevalvime bëjnë sipas udhëzuesit për vetevalvim dhe sigurim e vlerësim të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, që e miraton senati i universitetit, përkatësisht organi i institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

Vetevalvimi realizohet në intervale më së shumti prej tre vjetësh. Në procedurën për vetëvalvim merret parasysh edhe vlerësimi i studentëve.

Rezultatet nga vetevalvimi shpallen në ueb faqen e universitetit, të çdo njësie në veçanti (fakultet dhe institucion shkencor) dhe të ministrisë kompetente për punët e arsimit të lartë.

Ministria kompetente për punët e arsimit të lartë, për nevojat e vetevalvimit të institucioneve të arsimit të lartë, vendos Sistem elektronik shtetëror për vetevalvim.

Përmbajtjen, formën dhe mënyrën e shfrytëzimit të Sistemit elektronik shtetëror për vetevalvim i përcakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

Secili universitet, përkatësisht institucion i mëvetësishëm i arsimit të lartë rezultatet i dërgon në ministrinë kompetente për punët e arsimit të lartë e cila përpilon raport integrues për rezultatet nga vetevalvimi për universitetet dhe institucionet e mëvetësishme të arsimit të lartë

Nota nga ana e studentëve merret në fund të çdo viti shkollor, dhe e njëjta merret parasysht gjatë avancimit të arsimtarit në pozicion pedagogjiko-shkencor. [14](#)

Nota merret përmes anketës së studentëve që e realizon institucioni i arsimit të lartë, në mënyrën e përcaktuar me statutin e universitetit ose institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

Neni 77-a

Për zhvillimin dhe ruajtjen e kualitetit në arsimin e lartë në çdo dy vite detyrimisht realizohet rangimi i të gjitha universiteteve dhe institucioneve të arsimit të lartë në përbërje të universiteteve (fakulteteve dhe akademive të arteve), të regjistruara në regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë.

Rangimin nga paragrafi 1 i këtij neni, e realizon personi juridik të cilit e zgjedh ministri kompetent për punët në arsimin e lartë, në procedurë për ndarjen e marrëveshjes për furnizim publik në pajtim me Ligjin për furnizime publike.

Personi juridik i cili do ta realizojë rangimin, duhet t'i përmbush kriteret në vijim:

- të ketë të vendosur sistem relevant për menaxhim me kualitetin,
- të ketë përherë të punësuar së paku 15 persona në tituj arsimore-shkencore që i mbulojnë të gjitha fushat shkencore, me minimum pesë vite përvojë në procesin e sigurimit të shërbimeve konsultuese të institucioneve të arsimit të lartë apo institucioneve shtetërore dhe të kenë udhëhequr projekte hulumtuese shkencore lidhur me aspekte të ndryshme të arsimit të lartë,
- të kenë në disponim së paku pesë bashkëpunëtorë të jashtëm me tituj arsimore-shkencore,
- të kenë kryer rangime të universiteteve dhe/ose institucioneve të arsimit të lartë në përbërje të universiteteve në së paku tri vende të Unionit Evropian,
- të kenë zhvilluar metodologji fleksibile në procesin e rangimit dhe
- rezultatet nga puna e tyre t'i kenë shpallur publikisht.

Universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë në përbërje të universiteteve (fakultetet dhe akademitë e arteve) kanë për obligim që personit juridik i cili e realizon rangimin, t'ia japin të gjitha të dhënat e nevojshme për rangim.

Mjetet e nevojshme për realizimin e rangimit të universiteteve dhe instituteve të arsimit të lartë në përbërje të universiteteve (fakulteteve dhe akademive të arteve) sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Rezultatet e rangimit nga paragrafi 1 i këtij neni dhe kriteret sipas të cilit është realizuar rangimi, janë të arritshme për publikun në afat prej tetë ditësh pas hartimit të raportit për rezultatet e

rangimit me ranglistë, nëpërmjet publikimit në ueb-faqen e ministrisë kompetente për punët e arsimit të lartë.

Ministria kompetente për punët e arsimit të lartë është e obliguar që në afat prej tetë ditësh pas pranimit, ta dorëzojë raportin për rezultatet nga rangimi me ranglistë, te të gjitha universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë në përbërje të universiteteve (fakultetet dhe akademitë e arteve).

### ***Baza e të dhënave në veprimtarinë e arsimit të lartë***

Neni 77-b

Për ndjekjen e veprimtarisë së arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë si dhe për përpilimin e indikatorëve të cilësisë dhe realizimin e veprimtarisë së lartë arsimore dhe mënyrës dhe shpeshimitin e grumbullimit të tyre, ministria kompetente për çështjet nga sfera e arsimit të lartë siguron kushte për formimin dhe sigurimin e bazës së të dhënave për veprimtarinë e arsimit të lartë. Bazën e të dhënave e formon dhe mban ministria kompetente për çështjet e arsimit të lartë. Inspektorati Shtetëror i Arsimit kryen kontroll dhe i mbikëqyr informatat/indikatorët e bazës së të dhënave.

Mënyrën dhe procedurën e mbajtjes së bazës së të dhënave i përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e arsimit të lartë.

Fakultetet janë të obliguara të paraqesin të dhëna për bazën e të dhënave që e mban ministria kompetente për çështjet e arsimit të lartë, si dhe të kryejnë konsultim dhe koordinim të rregullt me Këshillin për Akreditim dhe Evalvim për depozitim të të dhënave rreth programeve arsimore dhe ngjashëm.

Fakultetet janë të obliguara që në nivel tremujor t'i paraqesin të dhënat në ministrinë kompetente për çështjet e arsimit të lartë.

### **Kreu i tetë**

## **ZHVILLIMI, FINANCIMI DHE PRONA E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË**

### ***Programi për veprimtarinë e arsimit të lartë***

Neni 78

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, miraton Program për veprimtarinë e arsimit të lartë.

Programi për veprimtarinë e arsimit të lartë miratohet për një periudhë katërvjeçare.

Programi për veprimtarinë e arsimit të lartë realizohet nëpërmjet programeve vjetore që miratohen në të njëjtën kohë me bilancin vjetor të universitetit.



## ***Përmbajtja e programit***

Neni 79

Me programin për veprimtarinë e arsimit të lartë përcaktohen: qëllimet, drejtimet e zhvillimit, burimi dhe vëllimi i mjeteve financiare të nevojshme për financimin e nevojave shtetërore dhe për realizimin e zhvillimit të veprimtarisë së institucioneve publike të arsimit të lartë, drejtimet në të cilat do të zhvillohet rrjeti i institucioneve të arsimit të lartë, projektimi i profileve të nevojshme, numri i kuadrove pedagogjike-shkencorë dhe atij, ambienti e pajisjet dhe nevojat e tjera për zhvillimin e arsimit të lartë, mjetet financiare të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve private të arsimit të lartë, atëherë kur veprimtaria e tyre është në interes të realizimit të interesit publik.

Në kuadër të mjeteve nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohen edhe mjetet financiare për pjesëmarrje në financimin e programeve studimore të institucioneve private të arsimit të lartë për të cilat Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka vërtetuar se ka interes për kënaqjen e nevojave publike në realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë që ushtrojnë institucionet private të arsimit të lartë.

## ***Këshilli***

Neni 80

Për shkak të realizimit të punëve për financim të caktuara me këtë ligj dhe realizimit të Programit për veprimtarinë e arsimit të lartë, në kuadër të ministrisë kompetente për çështjet e arsimit të lartë, formohet Këshilli.

Këshilli është i pavarur në punën e tij dhe merr vendime në kuadër të kompetencave të tij në bazë të parimit të profesionalizmit dhe kompetencës.

## ***Mjetet për financimin e arsimit të lartë***

Neni 81

Mjetet për financimin e universiteteve publike dhe studimeve me interes publik sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe nga burime të tjera të caktuara me ligj, sipas Programit për veprimtarinë e arsimit të lartë.

Këshilli për çdo vit buxhetor, më së voni 15 dite pas miratimit të buxhetit për vitin rrjedhës fiskal, për punët e arsimit të lartë, në pajtim me Programin për veprimtarinë e arsimit të lartë, ia propozon shumën e përgjithshme të mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për financimin e universiteteve dhe institucioneve të pavarura të larta arsimore, Ministrisë kompetente për çështjet e sferës së arsimit të lartë.

Në bazë të Programit për veprimtarinë e arsimit të lartë përcaktohen edhe masat e kriteret për financimin e programeve studimore që me Programin janë vërtetuar se janë me interes publik (në vijim të tekstit: programe studimore me interes publik).

Baza fillestare për financimin e institucioneve të arsimit të lartë janë planet financiare vjetore të institucioneve të arsimit të lartë.

### ***Përbërja e Këshillit***

Neni 82

Këshilli përbëhet prej 15 anëtarë nga radhët e punonjësve mësimorë-shkencorë, artistikë dhe atyre shkencorë nga universitetet publike, përfaqësues nga organizata e punëdhënësve të Maqedonisë, përfaqësues nga sektori jo afarist dhe nga studentët.

Kryetarin dhe pesë anëtarë të Këshillit, me propozim të ministrit kompetent për çështjet e arsimit të lartë i emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe gjashtë anëtarë nga radhët e punonjësve pedagogjikë-shkencorë, artistikë dhe atyre shkencorë i zgjedh Konferenca rektoriale e universiteteve publike adekuat me pjesëmarrjen e universiteteve sipas pjesëmarrjes së tyre në numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar për herë të parë. Nga një përfaqësues zgjedhin organizata e punëdhënësve të Republikës së Maqedonisë, sektori jo afarist dhe studentët.

Anëtarët e Këshillit zgjidhen për një periudhë katërvjeçare. Mandati i anëtarit të Këshillit i zgjedhur nga studentët zgjat dy vjet.

### ***Kompetencat e Këshillit***

Neni 83

Këshilli në kuadër të kompetencave të tij:

- jep mendim për Programin për veprimtarinë e arsimit të lartë,
- jep mendim për ndarjen e mjeteve financiare për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë,
- propozon akt për masat dhe kriteret e financimit për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë që me propozim të ministrit kompetent për funksionimin e arsimit të lartë e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë,
- jep mendim për ndarjen e mjeteve financiare për investime, për mirëmbajtjen e pajisjeve ekzistuese dhe për furnizim me pajisje të reja, për aprovimin e mjeteve për furnizim me literaturë profesionale dhe për sigurimin e amortizimit dhe sigurimit,
- propozon masa dhe kriteret për stimulimin e studentëve të talentuar dhe për bursat e studentëve që arrijnë rezultate mbi mesataren gjatë studimeve,
- jep mendim për financimin e programeve studimore të institucioneve publike të arsimit të lartë të cilat më pas i dorëzohen Këshillit të akreditimit,
- përcakton shumën më të ulët të mjeteve për studentët e regjistruar e të diplomuar nga programi studimor përkatës (çmimi buxhetor i kostos) për financimin e programeve studimore që janë me interes publik, në bazë të: çmimeve të ndryshme për student për fushat studimore të caktuara me dispozitë nga paragrafi 1 alineja 3 e këtij neni, numrit të studentëve në studimet në vazhdimësi, rezultateve të evalvimit institucional dhe evalvimit të programeve studimore,
- me propozim të universiteteve publike miraton masa e kriteret për bashkëfinancim të studimeve të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe për participimet dhe detyrimet e tjera të

studentëve në institucionet e arsimit të lartë,

- jep propozimin për shumën e bashkëfinancimit dhe participimit të studentëve,
- miraton rregullore për organizimin dhe punën e tij dhe
- realizon edhe punë të tjera të caktuara me këtë ligj.
- Këshilli ka për obligim t'i propozojë matës universitetit, ose njësive në përbërje të tij, për financimin e veprimtarisë shkencore kërkimore, si dhe të nxisë financimin e kërkimeve bazike më së shumti deri në 10% nga mjetet e përgjithshme që ndahen për financimin e veprimtarisë shkencore kërkimore dhe
- Këshilli ka për obligim që ta njoftojë ministrinë kompetente për punët e sferës së arsimit të lartë në rast të zvogëlimit të financimit në sferat e veprimtarisë shkencore kërkimore.

Këshilli shtron propozim edhe për pjesëmarrjen me mjete të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë në financimin e institucioneve private për arsim të lartë, nëse Republika e Maqedonisë ka interes për kënaqjen e disa nevojave të caktuara nëpërmjet programeve të tyre mësimore

Këshilli për punën e tij, çdo tre muaj njofton, ndërsa çdo vit i jep raport për punën e tij ministrit kompetent për funksionimin e arsimit të lartë.

Për aktet që i miraton Këshilli, pajtim jep ministri kompetent për çështjet e arsimit të lartë.

#### ***Mënyra e realizimit të punëve të Këshillit***

Neni 84

Punët profesionale dhe administrativo-teknike të Këshillit i realizon ministria kompetente për çështjet e arsimit të lartë.

#### ***Financimi me mjete nga persona të huaj fizikë e juridikë***

Neni 85

Institucionet e arsimit të lartë mund të pajisen me mjete financiare nga persona fizikë e juridikë të vendit e të huaj.

Për mjetet nga paragrafi 1 të këtij neni personat fizikë e juridikë të vendit e të huaj mund të kenë lehtësime tatimore e doganore të caktuara me ligj.

#### ***Të ardhura të tjera të institucioneve të arsimit të lartë***

Neni 86

Institucionet e arsimit të lartë mund të pajisen me mjete financiare edhe nga:

- ushtrimi i shërbimeve arsimore personave fizikë e juridikë të vendit e të huaj,
- shitja e produkteve dhe e shërbimeve arsimore e profesionale personave fizikë e juridikë të vendit e të huaj,
- kamata,

- të ardhura nga të drejtat e autorit në pronësi të institucionit të arsimit të lartë dhe
- trashëgimi, dhurata, donacione, ndihma dhe burime të tjera.

Me mjetet nga trashëgimitë, dhuratat, donacionet e ndihmat, institucioni i arsimit të lartë disponon sipas qëllimit të dhënësit.

### *Bashkëfinancimi dhe participimet e studimeve*

Neni 87

Universiteti publik, me propozim të njësisë së universitetit mund të shpallë participim të shpenzimeve të studimit për numrin e studentëve financimi i të cilëve bëhet në kuadër të numrit të studentëve shkollimi i të cilëve financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë sipas masave dhe kriterëve për financime nga neni 83 paragrafi 1 alineja 3 e këtij ligji dhe shumës së përcaktuar të mjeteve për participim, me pajtim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Studentët e paguajnë participimin në këste të njëjta para fillimi të çdo semestri.

Institucionet e arsimit të lartë nuk do t'i arkëtojnë participim:

- fëmijëve pa prindër,
- personave me invaliditet të shkallës së parë e të dytë,
- invalidëve të luftës dhe
- personave të rritur nëpër shtëpitë e fëmijëve.

Mjetet për participim të këtyre personave do të mbulohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Universiteti publik, në kuadër të numrit të studentëve të caktuar me konkurs mund të shpallë bashkëfinancim të shpenzimeve të studimeve për studentët shkollimi i të cilëve nuk financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe nga mjetet për bashkëfinancim me pajtim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Studenti, i cili nuk i plotëson kushtet e caktuara me rregullat e studimit dhe me statutin e universitetit publik, i mbart shpenzimet e shkollimit financimi i të cilit nuk bëhet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për periudhë dhe mënyrë të caktuara me statutin e universitetit.

Neni 87-a

Një pjesë e mjeteve të fituara nga participimi i shpenzimeve të studimit për numrin e studentëve, financimi i të cilëve kryhet në suaza të numrit të studentëve arsimit i të cilëve financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe nga financimi i shpenzimeve për studim, për studentet arsimit i të cilëve nuk financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, në lartësi prej 40%, universiteti publik, përkatësisht institucioni publik i arsimit të lartë, detyrimisht i përdor për hulumtime fundamentale dhe të aplikuara, modernizimin e infrastrukturës shkencore kërkimore, për aftësimin dhe përsosjen e kadrove për punë shkencore kërkimore, si dhe për investime dhe

mirëmbajtje investuese. Mjetet në disponim në vlerë prej 40% të përcaktuara në këtë paragraf shfrytëzohen për investim në projektet shkencore – kërkimore, paraqitjen e konkurseve për financim nga universitetet, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të bashkëpunëtorit/asistentit i cili ka për obligim të realizojë së paku një qëndrim studimor në kohëzgjatje jo më pak se një muaj dhe jo më shumë se tre muaj në periudhë prej tri vitesh në 500 universitetet e para të ranguar sipas listës së Shangait, respektivisht 200 universitetet e para më mire të ranguar të sferës përkatëse shkencore, respektivisht në 100 universitetet e para më mirë të ranguar me programin MBA në pajtim me Universitetin e Shangait Xhio Tong, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement- World University Ranking.

Përgatitja dhe ndarja e 40% të mjeteve në disponim, të theksuara në paragrafin 1 të këtij neni behet në pajtim me rregulloren për ndarje të brendshme të financave, të cilin e miraton universiteti, me pëlqim paraprak të marrë nga ministri kompetent për punët e sferës së arsimit të lartë.

### *Prona e patundshme dhe mjete të tjera të institucioneve publike të arsimit të lartë*

Neni 88

Prona e patundshme dhe mjetet e tjera të universiteteve publike e të institucioneve të pavarura të arsimit të lartë dhe mjetet nga trashëgimitë, ndihmat qëllimore, dhuratat dhe donacionet, janë pronë e universitetit, përkatësisht institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

Universitetet publike, përkatësisht institucionet e pavarura të arsimit të lartë disponojnë dhe administrojnë me pronën dhe i shfrytëzojnë materialet, mjetet financiare, të drejtat nga pronësia intelektuale dhe të drejtat e tjera materiale për ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë e asaj shkencore, nën kushte të caktuara me këtë ligj dhe me statutin e universitetit.

Universiteti publik dhe institucionet e pavarura të arsimit të lartë mund ta tjetërsojnë pronën e patundshme me mendim pozitiv paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Mjetet e fituara nga shitja e pronës nga paragrafi 3 i këtij neni, përdoren për investime, mirëmbajtje investuese të pajisjeve me pajtim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

### *Prona e patundshme dhe mjete të tjera të institucioneve private të arsimit të lartë*

Neni 89

Prona e patundshme dhe mjetet e tjera të universiteteve private dhe njësisive në kuadër të tij ose të institucioneve të pavarura private të arsimit të lartë janë pronë e themeluesit.

Prona e patundshme dhe mjetet e tjera nga paragrafi 1 i këtij neni i jepen në shfrytëzim dhe disponim institucioneve private të arsimit të lartë.

Institucionet e pavarura private të arsimit të lartë administrojnë në mënyrë të pavarur me pronën dhe materialet, mjetet financiare dhe të drejtat e tjera materiale i përdorin për ushtrim të veprimtarisë së arsimit të lartë.

### *Përdorimi qëllimor i donacioneve, mjeteve nga fondacionet ose fondet e tjera qëllimore*

Neni 90

Pronat e patundshme dhe mjetet e tjera të dhëna si donacione, mjetet nga fondacionet ose fondet e tjera qëllimore, institucioni i arsimit të lartë i përdor vetëm sipas qëllimit që ka caktuar donatori, në përputhje me ligjin.

Pronat e patundshme dhe pronësi të tjera që institucioni i arsimit të lartë i ka fituar në bazë të donacioneve e dhuratave, janë pronë e institucionit të arsimit të lartë që është pajisur me këtë pronë.

### *Prona e institucionit të lartë arsimor që ka pushuar së funksionuari*

Neni 91

Kur njësi e universitetit pushon së funksionuari, prona, mjetet dhe fitimet që mbeten pas përmbushjes së detyrimeve, i takojnë universitetit në kuadër të të cilit gjendet njësi e universitetit.

Kur universiteti, përkatësisht institucioni i pavarur i arsimit të lartë pushon së funksionuari, prona mjetet dhe fitimet që mbeten pas përmbushjes së detyrimeve, i takojnë themeluesit.

## **Kreu i nëntë**

## **VEPRIMTARIA E ARSIMIT TË LARTË**

### *Studime akademike e profesionale*

Neni 92

Arsimi i lartë realizohet nëpërmjet realizimit të studimeve akademike e profesionale.

Studimet akademike i aftësojnë studentët për ushtrimin e veprimtarive në shkencë dhe arsimin e lartë, në botën afariste, në sektorin publik dhe në shoqëri plotësisht nëpërmjet aftësimin për zhvillim dhe aplikim të arritjeve shkencore e profesionale.

Studimet profesionale u japin studentëve njohuri dhe aftësi që u mundësojnë ushtrim të profesioneve profesionale dhe i aftësojnë ata për inkuadrim të drejtpërdrejtë në procesin e punës.

Studimet akademike e profesionale pajtohen me studimet në hapësirën kërkuese e arsimore evropiane.

## *Cikle të arsimit të lartë*

Neni 93

Programet studimore për marrje të arsimit renditen në tre cikle të arsimit të lartë:

- cikli i parë i studimeve universitare,
- cikli i dytë i studimeve universitare dhe
- cikli i tretë, studime të doktoratit.

Çdo cikël i studimeve universitare përfundon me pajisjen me një titull të caktuar.

Disa programe studimore të caktuara mund të realizohen në mënyrë të integruar midis ciklit të parë e të dytë.

Çdo cikël studimesh duhet të jetë në përputhje me sistemin evropian të transferimit të kredive të transmetimit dhe akumulimit të kredive (në vijim të tekstit: ECTS), sipas të cilit për një vit studimesh si rregull fitohen 60 kredi ECTS.

## *Cikli i parë i studimeve universitare*

Neni 94

Cikli i parë i studimeve universitare, si rregull zgjat nga 3 deri në 4 vjet dhe pas përfundimit të tyre fitohen nga 180 deri në 240 kredi ECTS. Këto studime i aftësojnë studentët për të hyrë në ciklin e dytë të studimeve universitare dhe u japin mundësi për punësim në vende profesionale të caktuara pune.

Personi i cili ka përfunduar studimet nga paragrafi 1 i këtij neni merr diplomë me shtesë të profesionit përkatës, nëse nuk është caktuar ndryshe me ligj.

Në qarkullimin ndërkombëtar edhe diploma në gjuhën angleze, titulli akademik pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve është baccalaureus, përkatësisht baccalaurea.

## *Cikli i dytë i studimeve universitare*

Neni 95

Studimet akademike universitare të ciklit të dytë zgjasin një deri në dy vjet dhe pas përfundimit të tyre fitohen 60 deri në 120 kredi ECTS. Këto studime mund të zgjasin edhe më shumë nëse kjo është në përputhje me standardet evropiane të pranuar për një profil të caktuar.

Numri i përgjithshëm i kredive që fitohen në ciklin e parë e të dytë të studimeve universitare është 300 kredi ECTS.

Personi i cili ka përfunduar studimet nga paragrafi 1 i këtij neni me një total prej 300 kredi ECTS pajiset me titullin shkencor - magjistër, ose me titull tjetër të studimeve nga neni 106 i këtij ligji.

Në qarkullim ndërkombëtar dhe diploma në gjuhën angleze, titulli shkencor pas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve është master.

Neni 95-a [15](#)

Një mësimpldhënës njëkohësisht mund të jetë mentor i më së shumti 12 kandidatëve në nivel vjetor të cilët përgatisin punime të magjistraturës.

Të drejtë të jetë mentor i punimit të magjistraturës ka vetëm mësimpldhënësi i cili ka publikuar së paku gjashtë punime në revista shkencore ndërkombëtare ose një punim në reviste me faktor impakti dhe që ka marrë akreditim nga Këshilli për Akreditim dhe Evalvim në arsimin e lartë.

Këshilli për Akreditim dhe Evalvim në arsimin e lartë mban regjistër të mentorëve të punimeve të magjistraturës dhe doktoraturës, që azhurnohet në çdo tre muaj.

Përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit nga paragrafi 3 i këtij neni i përcakton ministri me akt nënligjor.

Mentorët e studentëve të ciklit të dytë të studimeve nevojitet të kenë publikuar punime në revista bibliografike me punime të indeksuara si vijon: Ebsco, Emerald, Scopus dhe Thomson Reuters.

### *Cikli i tretë i studimeve universitare - studime të doktoratës*

Neni 96

Studimet e doktoratës si rregull zgjasin tre vjet dhe kanë 180 kredi ECTS. Me mbrojtjen publike të doktoratës pajiset me titulli doktor i shkencave (dr.sc) përkatësisht doktor i arteve (dr.art).

Studimet e doktoratës mund të ndiqen pas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve akademike.

Universiteti mund të organizojë studime të ciklit të tretë me kohëzgjatje më pak se tre vjet, me të cilat fitohet titulli specialist i një fushë të caktuar (spec.). Titulli specialist, në fakt shkurtimi i tij i bashkëngjiten titullit akademik të fituar në ciklin e dytë të studimeve universitare.

Universiteti mund të vërtetojë se me përfundimin e studimeve të specializimit fitohet një lloj tjetër titulli nga titulli i përshkruar në paragrafin 3 të këtij neni, në rast se për një fushë të caktuar profesionale me ligj të veçantë është përcaktuar perfeksionim specializimi.

Universiteti me akt të përgjithshëm rregullon fitimin e kredive ECTS të studimeve të doktoratës dhe i përcakton kreditë ECTS të nevojshme për regjistrimin e punimit të doktoratës.

Në institucionet e arsimit të lartë të cilat realizojnë programe studimore nga cikli i tretë i studimeve universitare - të doktoraturës, mentori i punimit të doktoraturës duhet të ketë së paku gjashtë punime të recensuara shkencore - hulumtuese të botuara në revista ndërkombëtare shkencore ose publikime ndërkombëtare shkencore prej të cilave së paku dy në revista ndërkombëtare me impakt faktor, në sferë të caktuar, në pesë vitet e fundit. [16](#)



## *I shfuqizuar [17](#)*

Komisioni për mbrojtjen e punimit të doktoraturës përbëhet prej pesë anëtarëve nga të cilët katër janë nga sfera shkencore përkatëse nga institucioni i cili i organizon studimet e doktoraturës dhe një anëtar i jashtëm.

Anëtarët e komisionit nga paragrafi 8 i këtij neni duhet të jenë persona me tituj mësimor-shkencor profesor ordinar ose profesor inordinar.

Institucioni i arsimit të lartë nuk do t'i lejojë mbrojtjen e punimit të doktoraturës kandidatit i cili para mbrojtjes së punimit të doktoraturës nuk ka botuar dy punime shkencore-hulumtuese të recensuara si autor i parë në revista shkencore ndërkombëtarë ose publikime shkencore ndërkombëtare.

Revista shkencore ndërkombëtare sipas këtij ligji është revistë e cila ka këshill redaktues ndërkombëtar në të cilin marrin pjesë së paku pesë vende me ç'rast numri i anëtarëve nga një vend nuk mund të tejkalojë 40% nga numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe e cila botohet së paku pesë vjet pa ndërprerë dhe ka së paku dhjetë botime në pesë vitet e fundit.

Publikime shkencore ndërkombëtare sipas këtij ligji janë: libri i recensuar dhe i botuar jashtë vendit; përmbledhja e punimeve shkencore të prezantuara në takime akademike ndërkombëtare me shkallë të pranimit të punimeve më së shumti prej 40%, ku anëtarët e komitetit të programit janë së paku prej katër vendeve; si dhe punimet shkencore të shpallura në gazeta vjetore dhe tituj të gazetave ndërkombëtare me shkallë të pranimit të punimeve më së shumti prej 40%, ku anëtarët e komitetit të programit janë së paku prej katër vendeve.

Kriteret minimale për mentor të punimeve të magjistraturës dhe doktoraturës që duhet t'i plotësojë personi, janë të përcaktuara në dispozitat e Dekretit për normat dhe standardet për themelimin e institucionit të lartë arsimor dhe kryerjen e veprimtarisë së lartë arsimore. [18](#)

Numri i studentëve të cilët regjistrohen në programin studimor të doktoraturës për të tre vitet e studimeve të doktoraturës duhet të jetë në pajtim me numrin e mentorëve në dispozicion.

Një profesor mund të jetë mentor më së shumti i tre doktorantëve të cilët te ai trajnohen për punë shkencore.

Për një sferë shkencore mund të organizohet vetëm një program studimor i doktoraturës, përveç në raste të programeve interdisiplinare të studimit.

Programi studimor për studimet e doktoraturës nga paragrafi 1 i këtij neni përfshin punë aktive hulumtuese në mentorim dhe përfshin:

- trajnim të organizuar akademik, i cili përmban kurse përparimtare dhe profesionale,
- projekt të pavarur hulumtues në mentorim (projekt doktrature);
- mobilitet ndërkombëtar: së paku qëndrim një javor,
- ligjërata dhe lloj tjetër të aktiviteteve komunikuese,
- publikime në revista shkencore ndërkombëtare dhe pjesëmarrje aktive në takime

ndërkombëtare në lidhje me punimin e doktoraturës dhe  
- përpunim dhe mbrojtje publike të punimit të doktoraturës në bazë të projektit të doktoraturës.

Programi studimor për studime të doktoraturës evalvohet së paku në çdo tre vjet.

Studimet e doktoraturës nga sfera e arteve përbëhen prej dy pjesëve: punim i doktoraturës dhe realizim publik i veprave artistike ose ekspozitë.

Dispozitat nga paragrafët 6 dhe 10 të këtij neni nuk kanë të bëjnë me studimet e doktoraturës nga sfera e artit, filologjisë dhe historisë nacionale. Kushtet e veçanta për studimet e doktoraturës nga sfera e artit, filologjisë dhe historisë nacionale i përcakton institucioni i arsimit të lartë me akt të veçantë.

### *Studime profesionale*

Neni 97

Studimet profesionale realizohen nëpër universitete e shkolla të larta profesionale.

Studimet profesionale zgjasin tre vjet dhe pas përfundimit të tyre fitohen 180 kredi ECTS.

Me ndonjë përjashtim, studimet profesionale mund të zgjasin katër vjet nëse kjo është në përputhje me standardet e mirënjohura ndërkombëtare dhe me këto studime fitohen 240 kredi ECTS.

Në kuadër të ciklit të parë të studimeve profesionale mund të realizohen edhe programe të shkurtra profesionale studimore me 60 deri në 120 kredi ECTS.

Me përfundimin e studimeve profesionale me 60 deri në 120 kredi ECTS fitohet titull përkatës profesional, në përputhje me ligjin.

Me përfundimin e studimeve profesionale me 180 kredi ECTS merret diploma me shtesë për profesionin përkatës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Në trafikun ndërkombëtar edhe diploma në gjuhën angleze, titulli profesional pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve profesionale është baccalaureus, përkatësisht baccalaurea, me shtesë të profesionit, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Universitetet dhe shkollat e larta profesionale mund të organizojnë studime profesionale specializimi nga cikli i dytë për persona që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve profesionale, përkatësisht akademike. Këto studime zgjasin një deri në dy vjet dhe pas përfundimit të tyre fitohet titulli - specialist i një profesioni të caktuar (spec.) që përdoret përkrah titullit profesional të fituar në studimet profesionale ose studimet akademike të ciklit të parë.

## *Titulli profesional e shkencor*

Neni 98

Titujt profesionalë e shkencorë përcaktohen në përputhje me ligjin, statutin e universitetit dhe rregulloren e njësisë së universitetit, përkatësisht statutit të institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

Titujt profesionale dhe shkallet akademike “i diplomuar”, “magjistër” dhe “doktor” definoohen me Dekretin për kornizë nacionale të kualifikimeve në pajtim me Klasifikimin Ndërkombëtar Fraskatiev të fushave shkencore.

## *Përmbajtja e programeve studimore*

Neni 99 [19](#)

Programet studimore të ciklit të parë, dytë e tretë të studimeve përpilohen sipas normave, standardeve dhe metodologjisë së pranuar në hapësirën e vetme evropiane për arsim të lartë dhe në këtë mënyrë mundësohet realizimi i programeve të institucioneve të arsimit të lartë në këtë hapësirë.

Profili, qëllimet dhe bazat fillestare për përpilimin e programeve studimore më nga afër përcaktohen nga dispozita për kornizën kombëtare të kualifikimeve të arsimit të lartë që me propozim të ministrit kompetent për funksionimin e arsimit të lartë, e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Programet studimore në të gjitha vitet studimore duhet të përmbajnë lëndë të detyrueshme dhe të zgjedhura mësimore. Lëndët e detyrueshme mësimore duhet të jenë nga sfera përkatëse e njësisë së universitetit, përkatësisht të njësisë së brendshme të organizmit (institut, katedër, seksion), me ç'rast pjesëmarrja e tyre është më së shumti deri në 60% nga numri i lëndëve. Pjesën tjetër të programit studimor e përbëjnë 30% lëndë mësimore zgjedhore të cilat studentet individualisht i zgjedhin nga radhët e të gjitha lëndëve mësimore të përfaqësuara në njësinë e universitetin dhe 10% lëndë mësimore zgjedhore të cilat studentët individualisht i zgjedhin nga lista e lëndëve të lira zgjedhore të propozuara nga çdo njësi e universitetit në veçanti. Në këto 10% lëndë zgjedhore arsimore detyrimisht të përfshihen lëndë nga sfera e sipërmarrësisë dhe inovacioneve të këtyre fakulteteve ku mësohen këto lëndë.

Të gjitha programet studimore të të gjitha institucioneve të arsimit të lartë, të ndara në mënyrë të barabartë sipas lëndëve të detyrueshme dhe zgjedhore mësimore përmbajnë edhe "dritare për mobilitet", përkatësisht lëndë mësimore aktivitetet e të cilave mund të realizohen edhe në gjuhën angleze dhe numri i tyre minimal arrin jo më pak se 10% nga programi studimor ose së paku 20 SETK.

Lista e lëndëve të lira zgjedhore nga paragrafi 1 i këtij neni në mënyrë të detyrueshme shpallet në ueb faqen e njësisë së institucionit të arsimit të lartë dhe në universitet, si dhe në tabelën e shpalljeve në institucionin e arsimit të lartë.

Mënyrën e vërtetimit të kompatibilitetit të Kornizës nacionale për kualifikime të larta arsimore me Kornizën evropiane të kualifikimeve të larta arsimore e përcakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

Ministria kompetentë për punët e arsimit të lartë mban Regjistër për kualifikime të larta arsimore.

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit nga paragrafi (5) i këtij neni e përcakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

Studentët e regjistruar në programe studimore në ciklin e dytë të studimeve universitare dhe në programet studimore për ciklin e tretë, studime për doktoratë në universitetet shtetërore, në mënyrë të pavarur i zgjedhin lëndët mësimore zgjedhore nga radhët e gjitha lëndëve mësimore zgjedhore të përfshira në programet studimore të njësive në universitetet shtetërore.

Kur universiteti i vendit zbaton program studimor për marrjen e diplomës së përbashkët me universitetet të huaj, në lidhje me bashkëmarrëdhënien e përfaqësimit të lëndëve zgjedhore dhe të detyrueshme, zbatohen dispozitat e institucionit të arsimit të lartë, ku zbatohet programi studimor.

Institucioni i arsimit të lartë, 10% nga lëndët e obligueshme dhe 10% nga lëndët zgjedhore nga çdo vit studimor, i realizon përmes mësimit klinik.

Me mësim klinik nga paragrafi 5 i këtij neni, nënkuptohet realizimi i mësimit nga eksperti i spikatur i praktikës nga sfera përkatëse, i cili nuk mund të realizojë mësim klinik më tepër se tre vite shkollore.

Pa kalimit të tre viteve shkollore, eksperti nga paragrafi 6 i këtij neni, mund të angazhohet përsëri, nëse tre vite paraprakisht nuk realizon mësim klinik.

Mënyra dhe kushtet për realizimin e mësimit klinik, rregullohet me statutin e universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

Kushtet që duhet t'i plotësojë eksperti i spikatur nga paragrafi 6 i këtij neni, i përcakton ministri.

Studenti në secilin vit studimor, obligativisht e përcjell mësimin praktik, që nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë, si një nga kushtet për regjistrimin e vitit të ardhshëm studimor. Mënyrën dhe kushtet e organizimit të mësimit praktik, i përcakton ministri.

Komponentët obligues që programet studimore të ciklit të parë, të dytë e të tretë duhet të posedojnë, më nga afër i rregullon Këshilli i akreditimit me akt të veçantë.

Programet studimore mund të kenë edhe komponentë të tjerë të caktuar me statutin e universitetit, përkatësisht me rregulloren e njësisë në përputhje me statutin e universitetit, përkatësisht me statutin e institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

Programi arsimor i cili emërohet si program studimor që nuk është akredituar sipas këtij ligji, nuk llogaritet për program studimor nga cilido cikël i shkollimit, dhe as me përfundimin e tij nuk mund të fitohet ndonjë titull profesional ose shkencor të caktuar me këtë ligj.

### *Programe për perfeksionim profesional*

Neni 100

Universitetet dhe shkollat e larta profesionale mund të organizojnë programe të ndryshme të perfeksionimit profesional duke pasur parasysh konceptin e mësimin të përjetshëm. Këto programe organizohen për perfeksionim, përplotësim, për thellim dhe modernizim të njohurive dhe nuk llogariten për studime në kuptim të këtij ligji. Pas përfundimit të programeve për perfeksionim profesional merret një vërtetim, përkatësisht certifikatë që e lëshon universiteti, përkatësisht shkolla e lartë profesionale.

Pjesëmarrësit në format e perfeksionimit profesional nuk kanë status të studentit.

Format për perfeksionim profesional dhe kushtet e tjera për organizimin e tyre si dhe të drejtat dhe detyrimet e personave që i kanë ndjekur ato rregullohen me akt të përgjithshëm të universiteteve dhe të njësisve të tyre, në përputhje me statutin e universitetit, përkatësisht të shkollës së pavarur të lartë profesionale.

Përveç programeve për ngritje kualifikuese, përkatësisht profesionale, universiteti dhe njësitë e tij, përkatësisht shkolla e lartë profesionale, institucioni i arsimit të lartë ka për obligim të organizojë forma të ndryshme të mësimin joformal e së paku nga dy kurse/trajtime në vit për program studimor dhe ngjashëm, nëse kjo nuk ndikon në realizimin e programeve studimore për arritjen e arsimit të lartë.

Universiteti ose njësia në përbërje të tij, institucioni i arsimit të lartë, përkatësisht shkolla e lartë profesionale ka për obligim të organizojë qëndrim studimor për së paku 30 prej studentë të vet, në kohëzgjatje jo më pak se një muaj e jo më shumë se tre muaj në 500 universitetet e para të ranguar sipas listës së Shangait, përkatësisht 200 universitetet e para të ranguar më mirë nga sfera përkatëse shkencore, përkatësisht 100 universitetet e para të ranguar më mirë me programin MBA sipas Universitetit Xhio Tong të Shangait, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement-World University Ranking.

Studentët nga paragrafi 5 i këtij neni nevojitet të kenë realizuar notë mesatare mbi 9 deri në momentin e zgjedhjes për qëndrim studimor, si dhe të kenë njohuri të gjuhës angleze të cilën kandidati e dëshmon me vërtetim për njohjen e gjuhës, si vijon (TOEFEL) - së paku 74 pikë për testim elektronik nëpërmjet kompjuterit, jo më i vjetër se dy vjet nga dita e lëshimit, (IELTS) - së paku 6 pikë, jo më i vjetër se dy vjet nga dita e lëshimit, (TOLES) - njohuri bazike (Foundation level), (ILEC) - i dhënë me sukses së paku B2 dhe certifikatë të Kembrixhit për anglishte preliminare (Cambridge Certificate of Preliminary English) - (B1).

Fakulteti përkatësisht shkolla e lartë profesionale, institucioni i arsimit të lartë ka për obligim të realizojë vizitë për 3% nga profesorët e tij në vit, në 500 universitetet e para të ranguar sipas

listës së Shangait, përkatësisht 200 universitetet e para të ranguara më mirë nga sfera shkencore përkatëse, përkatësisht 100 universitetet e para të ranguara më mirë me programin MBA në pajtim me universitetin e Shangait Xhio Tong, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement-World University Ranking.

Shpenzimet e qëndrimit, shkollimit, sigurimit, transportit dhe ngjashëm, që dalin nga aktivitetet e përcaktuara në paragrafët 5 dhe 7 të këtij neni, universiteti ose njësia në përbërje të tij, institucioni i arsimit të lartë, përkatësisht shkolla e lartë profesionale i paguan nga të hyrat me të cilat disponojnë në mënyrë të pavarur njësitë, institucioni i arsimit të lartë, përkatësisht shkolla e lartë profesionale.

### *Arsim profesional më i shkurtër se tre vjet*

Neni 101

Për njohuri dhe trajnime profesionale, institucionet e arsimit të lartë mund të organizojnë shkollim profesional me kohëzgjatje më të shkurtër se tre vjet.

Për njohuritë dhe trajnimet nga paragrafi 1 i këtij neni, lëshohet certifikatë ose ndonjë dokument tjetër i caktuar me statutin e universitetit, përkatësisht me rregullat e njësisë së universitetit, përkatësisht me statutin e shkollës së lartë profesionale.

Personit i cili është pajisur me certifikatë ose me një tjetër dokument për titull profesional, sipas programit që është pjesë e programit studimor të akredituar të ciklit të parë të studimeve profesionale të arsimit të lartë për njohuri dhe trajnim profesional të shprehur në kredi mund t'i njihet si pjesë e programit studimor të arsimit të lartë. Kreditë e fituara shënohen në certifikatë ose në dokumentin tjetër nga paragrafi 2 i këtij neni.

Personi i cili është pajisur me njohuri profesionale dhe me kredi sipas paragrafit 3 të këtij neni dhe ka njohuri nga forma të tjera mësimi që do të evalvohet në mënyrë përkatëse nga institucioni i arsimit të lartë mund të vazhdojë me studimet sipas programit mësimor të përshtatshëm me kreditë e fituara dhe njohuritë e vlerësuara, sipas kushteve të caktuara me statutin e universitetit dhe rregulloren e njësisë, përkatësisht statutin e shkollës së lartë të pavarur profesional.

### *Programi studimor për diplomë të përbashkët*

Neni 102

Programi studimor për pajisje me diplomë të përbashkët është program studimor që universiteti, përkatësisht njësia e tij, përkatësisht shkolla e lartë e pavarur profesionale e pranon dhe e realizon së bashku me një ose disa universitete, përkatësisht shkolla të larta të pavarura profesionale nga Republika e Maqedonisë ose nga jashtë shtetit të akredituar në vendin në të cilin u gjendet edhe selia.

Lidhur me programet studimore për pajisjen me diplomë të përbashkët, universiteti ose njësia e tij, përkatësisht institucioni i pavarur i arsimit të lartë përveç dispozitave të këtij ligji për akreditimin e programeve studimore, duhet të marrin parasysh edhe masat për përpilimin dhe

pranimin e programeve studimore për pajisje me diplomë të përbashkët, që i Këshilli i akreditimit i cakton gjatë akreditimit.

Dispozitat për mësim klinik nga neni 99 paragrafët 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 nuk zbatohen për programin studimor për marrjen e diplomës së përbashkët, e cila realizohet bashkë me universitetet e huaja, me ç'rast zbatohen dispozitat e institucionit të arsimit të lartë, ku zbatohet programi studimor

Diploma e përbashkët është dokument publik. Përmbajtja dhe forma e diplomës së përbashkët si dhe bashkëngjitjet e diplomës i cakton universiteti, përkatësisht shkolla e lartë e pavarur profesionale.

Programet studimore në gjuhën angleze universitetet i dorëzojnë për mendim para se të njëjtat të akreditohen nga Këshilli për Akreditim dhe Evalvim, në ministrin; kompetente për punët e arsimit të lartë më së voni deri më 15 maj në vitin rrjedhës.

Këshilli për Akreditim dhe Evalvim u miraton program studimor në gjuhën angleze universiteteve, në bazë të mendimit pozitiv të marrë nga ministria kompetentë për punët nga sfera e arsimit të lartë.

### *Gjuhët në të cilat realizohet mësimi*

Neni 103

Mësimi në institucionet e arsimit të lartë realizohet në gjuhën maqedonase.

Pjesëtarët e bashkësive për arsye të shprehjes, ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit të tyre dhe veçantive të tjera, kanë të drejtë mësimin në institucionin publik të arsimit të lartë, sipas programeve studimore dhe përmbajtjeve të përshtatshme ta realizojnë në gjuhën e bashkësisë, e ndryshme nga gjuha maqedonase, në përputhje me këtë ligj dhe me statutin e institucionit të arsimit të lartë. Financimi nga ana e shtetit do të sigurohet për arsimin e lartë edhe në gjuhën që e flasin të paktën 20% e popullsisë së Republikës së Maqedonisë.

Mësimi në institucionet pedagogjike publike të arsimit të lartë për edukatorë të edukimit parashkollor dhe për mësues të arsimit tetëvjeçar si dhe të lëndëve didaktike-metodike për mësues të shkollave të mesme, mund të realizohet edhe në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive të tjera që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Mësimi në institucionet e arsimit të lartë mund të realizohet në një nga gjuhët botërore, për disa programe studimore të caktuara për gjuhë të huaja ose për një pjesë të programeve studimore në të cilat marrin pjesë mësues - mysafirë nga jashtë shtetit dhe për programe studimore për të cilat mësimi realizohet në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e bashkësisë së ndryshme nga gjuha maqedonase. Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë që mësimi për tërë programin studimor të realizohet paralelisht në gjuhën maqedonase dhe në një nga gjuhët botërore.

Në institucionin e larte arsimor mësimi së paku për dy programe studimore për ciklin e parë të studimeve akademike dhe profesionale dhe së paku katër programe studimore për ciklin e dytë të studimeve akademike dhe profesionale në mënyrë të detyrueshme realizohet dhe jepet në gjuhën angleze.

Në ciklin e tretë të studimeve institucioni i lartë arsimor mund të sigurojë mësim dhe punë shkencore-hulumtuese përkatësisht dhënia dhe mbrojtja e punimit të doktoraturës duhet të realizohet në gjuhën angleze.

Mësimi i institucioneve private të arsimit të lartë mund të realizohet edhe në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë ose në gjuhët e huaja.

Kur mësimi realizohet në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë ose në gjuhët botërore, gjuha maqedonase studiohet si lëndë e veçantë mësimore, dhe mësimi realizohet në gjuhën maqedonase për të paktën edhe dy lëndë mësimi.

Kur mësimi realizohet në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, në përputhje me paragrafin 2, 3, dhe 4 të këtij neni, gjuha maqedonase studiohet si lëndë e veçantë mësimore, dhe mësimi realizohet në gjuhën maqedonase për të paktën edhe dy lëndë mësimi nga programi mësimor.

Lëndët e mësimimit përcaktohen me statut të institucionit të arsimit të lartë, me fond orësh të caktuara me dispozitën për norma dhe standarde.

### *Organi që miraton programet studimore*

Neni 104

Programet studimore të ciklit të parë, të dytë e të tretë dhe programet studimore për perfeksionim i miraton senati i universitetit me propozim të këshillit mësimor-shkencor, përkatësisht këshillit pedagogjik të njësisë së universitetit, përkatësisht këshillit pedagogjik të shkollës së lartë të pavarur profesionale.

Për programet studimore të ciklit të parë, të dytë e të tretë akreditimin e bën Këshilli i Akreditimit, ndërsa vendimin për fillimin e punës e jep ministria kompetente për funksionimin e arsimit të lartë.

Për programet studimore të ciklit të parë, të dytë e të tretë, që financohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, pajtimin e jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë me mendim paraprak nga Këshilli.

Për programet studimore të ciklit të parë, të dytë e të tretë të institucioneve private të arsimit të lartë, pajtimin si dhe vendim për fillimin e punës jep ministria kompetente për funksionimin e arsimit të lartë, me akreditim paraprak nga Këshilli i akreditimit.



Universiteti, përkatësisht institucioni i pavarur i arsimit të lartë, programet studimore i shpall publikisht jo më vonë se shpallja e konkursit për regjistrimin e studentëve.

Komponentët obligues të programeve studimore ndryshohen sipas të njëjtës procedurë që edhe janë pranuar.

Institucionet publike të arsimit të lartë mund të realizojnë programe studimore të akredituara që nuk financohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

### ***Vlerësimi i programeve studimore me kredi sipas ECTS***

Neni 105

Programet studimore vlerësohen me kredi sipas ECTS. Çdo vit i programit studimor përmban 60 kredi.

Programet studimore të ciklit të parë që përmbajnë nga 180 deri në 240 kredi dhe zgjasin tre deri në katër vjet në varësi të llojit të programit vlerësohen si programe studimore profesionale ose akademike.

Programet studimore të ciklit të dytë që përmbajnë 60 kredi dhe së bashku me 180 kredi të fituara në ciklin e parë të studimeve akademike të diplomës dhe zgjasin një vit vlerësohen si studime specializimi.

Programet studimore të ciklit të dytë që përmbajnë 120 kredi dhe së bashku me 180 kredi të fituara në ciklin e parë të studimeve akademike të diplomës dhe zgjasin dy vjet, përkatësisht që përmbajnë 60 kredi dhe së bashku me 240 kredi të fituara në ciklin e parë të studimeve akademike dhe zgjasin një vit, vlerësohen si studime master.

Programet studimore të ciklit të dytë që organizohen si studime (të vetme) të vazhdueshme dhe përmbajnë 60 plus 60 kredi dhe së bashku me 180 kredi të fituara në ciklin e parë të studimeve akademike dhe zgjasin dy vjet, mund të vlerësohen pas përfundimit të vitit të parë si studime specializimi, ndërsa pas përfundimit të vitit të dytë si studime master.

Programet studimore të ciklit të tretë që mund të përmbajnë 180 kredi ose që mund të vlerësohen në bazë të karakterit të studimeve të nivelit të tretë dhe së bashku me 300 kredi të fituara në ciklin e dytë të studimeve master dhe zgjasin tre vjet vlerësohen si studime doktorate.

Programet studimore për perfeksionim, pas përfundimit të ciklit të parë ose të dytë të studimeve përmbajnë jo më pak se 10 e jo më shumë se 60 kredi.

### ***Programe studimore për profesione të rregulluara***

Neni 106

Me përjashtim të dispozitave të këtij ligji kohëzgjatja e studimeve për titujt që merren në çdo cikël të studimeve të cilët janë të lidhur me ushtrimin e profesioneve të rregulluara është:

- 1) studimet themelore nga sfera e mjekësisë përfshijnë së paku gjashtë vjet shkollimi ose 5.500 orë të trajnimit teorik dhe praktik që realizohet në universitet;
- 2) trajnimi i specializuar për mjekësi përfshin trajnim teorik dhe praktik në universitet ose në spital universitar ose ku është adekuate, institucion për kurim shëndetësor, i lejuar për këtë qëllim nga ministria kompetente për çështjet nga sfera e shëndetësisë;
- 3) specializimi nga sfera e mjekësisë rregullohet me ligj të veçantë;
- 4) trajnimi për infermiere me profil të përgjithshëm zgjat së paku tre vjet ose përfshin 4.600 orë trajnimi teorik dhe klinik, me ç'rast periudha e trajnimit teorik paraqet së paku një të tretën dhe periudha e trajnimit klinik paraqet së paku gjysmën e kohëzgjatjes minimale të trajnimit;
- 5) trajnimi i specializuar i stomatologjisë përfshin trajnim teorik dhe praktik në qendrën klinike universitare të lejuar për këtë qëllim nga ministria kompetente për çështje të shëndetësisë;
- 6) specializimi nga sfera e stomatologjisë rregullohet me ligj të veçantë;
- 7) trajnimi themelor për veterinerë përfshin kurs për trajnim teorik dhe praktik në formën e rregullt me kohëzgjatje minimale prej pesë vitesh, i cili përfshin si minimum programin e përshkruar me rregullat e Bashkimit Evropian, të realizuar në universitetin i cili siguron trajnim në bazë të aktvendimit të ministrit kompetent për çështjet e arsimit të lartë;
- 8) trajnim i rregullt special për mami i cili përfshin trajnim teorik dhe praktik me kohëzgjatje minimale prej tre vitesh (kursi I), i cili si minimum e përfshin programin e përpiluar me rregullat e Bashkimit Evropian;
- 9) trajnimi themelor për farmacistë përfshin kurs për trajnim teorik dhe praktik në formën e rregullt me kohëzgjatje prej së paku pesë vitesh, i cili përfshin si minimum programin e përshkruar me rregullat e Bashkimit Evropian, të realizuar në universitetin i cili siguron trajnim në bazë të aktvendimit të ministrit kompetent për punët e shëndetësisë dhe i cili përfshin së paku:
  - (a) trajnim të rregullt teorik dhe praktik katërvjeçar i siguruar në universitet dhe
  - (b) stazh gjashtëmujor në barnatore të hapur për publikun ose në spital, nën mbikëqyrje të njësisë farmacistë të spitalit;
- 10) trajnim për arkitekt përfshin së paku trajnim të rregullt katërvjeçar ose trajnim gjashtëvjeçar, i cili përfshin trajnim të rregullt në kohëzgjatje prej tre vitesh në universitet ose në institucion përkatës arsimor. Trajnimi duhet të shpije në dhënien e suksesshëm të provimit në nivel universitar.
- 11) trajnimi themelor për mësimdhënës në arsimin fillor dhe të mesëm përfshin kurs për trajnim teorik dhe praktik në formën e rregullt me kohëzgjatje prej së paku katër vitesh i realizuar në universitetin i cili siguron trajnim në bazë të aktvendimit të ministrit kompetent për punët e arsimit të lartë.

### *Programe studimore për studime juridike*

Neni 106-a

Programet studimore për studime juridike të ciklit të parë (studimore juridike universitare) zgjasin tre vjet, përkatësisht gjashtë semestra, përmbajnë së paku 180 kredi dhe me to fitohet titulli profesional "jurist".

Programet studimore për studime juridike profesionale të ciklit të dytë që përmbajnë së paku 60 kredi (studime juridike universitare, zgjasin një vit (dy semestra) dhe me përfundimin e tyre, bashkërisht me ciklin e parë, pasi të fitohen gjithsej 240 kredi dhe pas mbrojtjes së punimit të përfunduar të diplomës, fitohet titulli profesional "jurist i diplomuar".

Programet studimore për studime juridike profesionale të ciklit të dytë që përmbajnë 120 kredi (studime juridike pasuniversitare, zgjasin dy vite (katër semestra) dhe me përfundimin e tyre, bashkërisht me ciklin e parë, pasi të fitohen gjithsej 300 kredi dhe pas mbrojtjes së tezës profesionale të magistraturës me ato fitohet titulli profesional "magjistër i drejtësisë".

Programet studimore për studime akademike të shkencave juridike me 90 kredi (studime shkencore pasuniversitare) zgjasin dy vjet dhe me përfundimin e tyre dhe mbrojtjen e tezës së magistraturës fitohet titulli "magjistër i shkencave juridike".

Obligimi nga neni 99 paragrafi 3 të këtij ligji për raportin e lëndëve mësimore të detyrueshme dhe zgjedhore nuk ka të bëjë me programet studimore për studime juridike.

### *Transmetimi i kredive*

Neni 107

Kreditë mund të transmetohen nga një program mësimor në një tjetër të njëjtë, të ngjashëm ose të ndryshëm në kuadër të një universiteti, përkatësisht nga një universitet në një tjetër, përkatësisht nga një institucion i pavarur i arsimit të lartë në një tjetër, përkatësisht universitet.

Më nga afër kriteret dhe kushtet për transmetimin e kredive dhe kushtet për transferimin ndërmjet programeve studimore rregullohen me akt të përgjithshëm të universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë, përkatësisht me marrëveshje të nënshkruar ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë.

### *Kushtet dhe mënyra e regjistrimit të studimeve*

Neni 108

Në ciklin e parë të studimeve universitare dhe profesionale mund të regjistrohet person i cili ka kaluar provimet e maturës së shtetit ose maturës ndërkombëtare.

Nëse në konkursin për regjistrim të studentëve në ciklin e parë të studimeve universitare e profesionale në afatin e parë të regjistrimit nuk paraqitet numër i mjaftueshëm kandidatësh që i plotësojnë kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, të drejtë regjistrimi në ciklin e parë të studimeve mund të kenë edhe personat që kanë kaluar provimet e maturës shkollore të arsimit gjimnazial ose provim përfundimtar për arsim të mesëm profesional përkatës me kohëzgjatje prej katër vjetësh.

Në ciklin e parë të studimeve universitare nga sfera e arteve mund të regjistrohet person i cili ka kaluar provimin e maturës së shtetit, maturës ndërkombëtare ose maturës së shkollore të shkollës së arteve.

Regjistrimi i studimeve bëhet mbi bazën e konkursit publik që shpallet nga universiteti, përkatësisht institucioni i pavarur i arsimit të lartë të cilët i realizojnë studimet të paktën pesë muaj para fillimit të mësimit. Konkursi për regjistrim përmban: emrin e institucionit të arsimit të lartë dhe adresën e tij, titullin e programit studimor, vendin e realizimit të programit studimor,

kohëzgjatjen e studimeve, kushtet e regjistrimit, numrin e parashikuar të vendeve të lira për regjistrim, procedurën dhe afatet për paraqitje dhe realizim të regjistrimit.

Universiteti, përkatësisht shkolla e lartë e pavarur profesionale e përcakton procedurën e selektimit të kandidatëve për regjistrim në mënyrë që garanton barazi të të gjithë kandidatëve pa dallim nga raca, ngjyra e lëkurës, seksi, gjuha, feja, bindja politike ose ndonjë bindje tjetër, prejardhja etnike, kombëtare ose shoqërore, prona, lindja, pozicioni social, invaliditeti, orientimi seksual dhe mosha.

Universiteti, përkatësisht shkolla e lartë e pavarur profesionale përcaktojnë kriteret në bazë të të cilave do të bëhet selektimi dhe zgjedhja e kandidatëve për regjistrim.

Për institucionin publik të arsimit të lartë, konkursi shpallet nga universiteti, në mënyrë të caktuar me statut dhe me pajtim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Për institucionin privat të arsimit të lartë, konkursi shpallet nga institucioni i arsimit të lartë në mënyrë të caktuar me statutin e tij.

Universiteti, përkatësisht shkolla e lartë e pavarur profesionale vendos se cilat programe mësimore për arsim të mesëm janë të përshtatshme për regjistrim nëpër akademi të veçanta ose studime profesionale.

Me përjashtim, nën kushte të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë në studime, mund të regjistrohen edhe persona pa përfundim paraprak të arsimit përkatës, nëse bëhet fjalë për persona mjaft të talentuar për të cilët mund të pritët që edhe pa përfundim paraprak të arsimit do t'i përfundojnë studimet me sukses.

Në programet studimore të ciklit të dytë të studimeve universitare mund të regjistrohet person i cili ka përfunduar programe studimore përkatëse të ciklit të parë. Universiteti dhe njësitë e tij përcaktojnë se cilat studime janë përkatëse për regjistrim të disa programeve studimore të veçanta të ciklit të dytë si dhe kushtet për regjistrim të kandidatëve që kanë përfunduar programe të tjera studimore.

Personi i cili ka përfunduar studime profesionale mund të regjistrohet në programet studimore akademike të ciklit të dytë nëse kjo është parashikuar me akt të universitetit dhe të njësitë të tij që i realizojnë ato studime, përkatësisht shkollës së lartë të pavarur profesionale, ku gjatë regjistrimit mund të caktohet dhënia e disa provimeve të diferencuara.

Në studimet e doktoratës mund të regjistrohet person i cili ka përfunduar studime përkatëse të ciklit të dytë. Universiteti, mund të vendos edhe kushte të tjera për regjistrim të studimeve të doktoratës.

Shtetasit e huaj regjistrohen në studime nën kushte të njëjta si edhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë, me përjashtim vetëm nën kushte të caktuara në paragrafin 1, 2, dhe 3 të këtij neni, por në përputhje me vendimet e organeve shtetërore kompetente ose të institucionit të arsimit të lartë, mund të kërkohet nga ata që të paguajnë një pjesë ose shumën e plotë të çmimit të

studimeve. Shtetasve të huaj mund tu kufizohet ose shkurtohet regjistrimi nëse bëhet fjalë për studime që kanë të bëjnë me arsimin policor ose ushtarak ose studime që janë me interes kombëtar të sigurimit.

### *Vlerësim i njëjtë i arsimit të huaj*

Neni 109

Konsiderohet se kushtet për regjistrim nga nenet 107 e 108 të këtij ligji i përmbush edhe personi i cili ka mbaruar arsim sipas të njëjtit program studimor jashtë shtetit.

Me statutin e universitetit caktohen kushtet e regjistrimit nga paragrafi 1 i këtij neni për personin që ka mbaruar arsim të njëjtë jashtë shtetit.

### *Vendim lidhur me numrin e studentëve që regjistrohen*

Neni 110

Vendimin lidhur me numrin e studentëve që regjistrohen në institucione publike të arsimit të lartë, shkollimi të cilit financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, me propozim të universitetit publik, dhe me mendim paraprak të Këshillit, e merr Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Vendimin për numrin e studentëve që regjistrohen në institucione publike të arsimit të lartë jashtë numrit të caktuar në paragrafin 1 të këtij neni, e merr universiteti, nën kushte të caktuara me këtë ligj me pajtim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Numri i përgjithshëm i studentëve që mund të regjistrohen në institucionet e arsimit të lartë sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, përcaktohet në bazë të kapacitetit të caktuar me vendimin për akreditim të institucionit të arsimit të lartë.

Vendimin për numrin e studentëve që regjistrohen në institucionin privat të arsimit të lartë, me propozim të këshillit mësimor-shkencor, përkatësisht këshillit pedagogjik, e merr organi drejtues i institucionit privat të arsimit të lartë, nën kushte të caktuara me këtë ligj. Numri i studentëve nuk mund të jetë më i madh se numri i caktuar në bazë të kapacitetit me vendimin për akreditim të institucionit të arsimit të lartë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë merr vendim edhe për kuotën plotësuese për regjistrimin e studentëve pjesëtarë të bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Neni 110-a

Qeveria e Republikës së Maqedonisë me vendim e përcakton numrin e kuotave të studentëve të liruar nga pagesa e regjistrimit në studime të doktoraturës dhe magjistraturës dhe specializime që ndahen në nivel vjetor në bazë të Programit nacional për arsim të lartë dhe veprimtari hulumtuese shkencore.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë me vendim e përcakton numrin e kuotave për studentet e regjistruar në programet studimore, si dhe numrin e studentëve që do të lirohen nga pagesa e regjistrimit në kuadër të kuotave shtetërore.

Obligimi për pagesën e regjistrimit të studentëve nga paragrafi 2 i këtij neni në kuadër të kuotave shtetërore iu mbetet fakulteteve.

Të drejtë për shkollim falas kanë studentet me mesatare mbi 9 në vitin paraprak.

### *Fillimi dhe përfundimi i vitit studimor*

Neni 111

Viti studimor fillon më 15 shtator dhe përfundon me 14 shtator të vitit të ardhshëm dhe ndahet në dy semestra, dimëror e veror ose në tre semestra, me mundësi që mësimi të realizohet në cikle. Fillimi dhe kohëzgjatja e mësimit sipas semestrave caktohet me statutin e universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

### *Vëllimi dhe organizimi i studimeve*

Neni 112

Në kuadër të jo më shumë se 40 javë në vit, mbingarkesa e përgjithshme e studentëve është nga 1.500 deri në 1.800 orë në vit.

Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni programet studimore nga cikli i parë përmbajnë jo më pak se 20 dhe jo më shumë se 30 orë leksionesh, ushtrime dhe seminare në javë dhe 30 javë në vit.

Me përjashtim nëse programi studimor përmban aftësim praktik, mbingarkesa e përgjithshme e studentit nuk duhet të tejkalojë 40 orë në javë dhe 45 javë në vit.

Mbingarkesa e studentit nga paragrafi 1 i këtij neni përfshin: leksione, ushtrime, seminare dhe forma të tjera të studimeve që janë të përshtatshme me specifikën e sferës pedagogjike-shkencore (aftësim praktik, hospitim, shfaqje, punë në terren etj), mësim konsultativo-instruktiv, forma të kontrollit të vazhdueshëm të njohurive dhe provime, që llogariten si orë kontakti, si dhe puna studimore individuale (punë sportive, kërkime në literaturë, punë seminare, punë projekti), mësim autodidakt, si dhe përgatitja e diplomës (master, doktorata).

Personi i zgjedhur në titull mësimit-shkencor dhe mësimit në institucionet e larta arsimorë në fillimin e çdo viti të studimit studentëve në mënyrë të detyrueshme u propozon literature bazë e cila i përmban elementet të cilat studentet do t'i shfrytëzojnë për dhënien e provimeve.

Literatura bazë nga paragrafi 5 i këtij neni në mënyrë të detyrueshme shpallet në ueb faqen e institucionit të lartë arsimor.

Literatura themelore nga paragrafi 5 i këtij neni detyrimisht e përmban dhe literaturën të cilën e siguron, shtyp dhe dorëzon te institucionet e arsimit të lartë, ministria kompetente për punët e arsimit të lartë.

## 20

Ministria kompetente për punët e arsimit të lartë çdo vit siguron literaturë të përkthyer dhe të shtypur profesionale, nga 50 libra universitarë që përdoren në dhjetë universitetet e para të ranguar në pajtim me Listën e Shangait.

Propozimet për literaturën profesionale nga paragrafi 8 i këtij neni, institucionet e larta arsimore në Republikën e Maqedonisë i dorëzojnë në ministrinë kompetente për punën e arsimit të lartë, më së voni deri më 15 shtator.

Ministria kompetente për punët e arsimit të lartë, më së voni deri më 31 dhjetor, në ueb faqen e vet publikon se cila literaturë profesionale do të përkthehet dhe shtypet për vitin e ardhshëm studimor.

Mjetet financiare për përkthim dhe botim të literaturës profesionale dhe sferat shkencore për të cilat përkthehet dhe botohet literatura profesionale nga paragrafi 8 i këtij neni, përcaktohen në programin vjetor të cilin e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrisë kompetente për punët e arsimit të lartë.

Në mënyrë dhe procedurë të caktuar me statutin e universitetit, përkatësisht të institucionit të arsimit të lartë, organizimi dhe renditja kohore e leksioneve, seminareve dhe ushtrimeve mund të përshtatet me specifikën e programit studimor (programe studimore në art e të tjera).

Vendim për orarin e orëve dhe mësimin miraton Drejtorja e Dekanatit, me propozim të njësisë të brendshme organizuese të Fakultetit.

Numri i përgjithshëm i orëve të çdo cikli ndahen në mënyrë të barabarte ndërmjet të gjithë mësimitdhënësve nga sfera e njëjtë ose e ngjashme shkencore.

Mësimdhënësit i cili nuk e plotëson numrin minimal të orëve për aktivitetin mësimor për vitin shkollor, me aktvendim të dekanit i caktohen orë mësimi nga sfera e ngjashme shkencore.

Nëse natyra e studimeve e mundëson këtë, me programin studimor mund të përshtatet organizimi dhe renditja kohore e leksioneve, seminareve dhe ushtrimeve sipas mundësive të studentëve (studime me korrespondencë). Përshtatja bëhet sipas kushteve dhe mënyrës e procedurës të caktuara me rregulloren e njësisë, në përputhje me statutin e universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

## *Përfundimi i studimeve*

Neni 113

Studimet e ciklit të parë përfundojnë me dhënien e të gjitha provimeve, përgatitjen e punimit të diplomës ose dhënien e provimit përfundimtar, në përputhje me programin studimor.

Studimet e ciklit të dytë përfundojnë me dhënien e të gjitha provimeve, përgatitjen e magjistraturës (punë shkencore profesionale ose master) dhe me mbrojtjen e saj, në përputhje me programin studimor.

Për plotësimin e detyrimit për dhënie të provimeve, kryhet kontrolli i njohurive me qëllim që të vlerësohet nëse dhe në çfarë masë kualifikimet e arritura të studentit përkojnë me qëllimet, aftësitë dhe kërkesat akademike të përcaktuara me deskriptore të përgjithshëm dhe specifike të kualifikimit, me të cilat përcaktohen rezultatet e mësimit për program të veçantë studimor nga cikli përkatës i studimeve në pajtim me Dekretin për kornizë nacionale të kualifikimeve të arsimit të lartë.

Llojet e kontrollit të njohurisë doemos duhet t'i pasqyrojnë qëllimet e lëndës mësimore dhe programit studimor dhe të mundësojnë vlerësim individual të arritjeve të çdo studenti veç e veç.

Forma dhe përmbajtja e vlerësimit doemos duhet t'i pasqyrojnë përmbajtjen dhe metodat e punës të lëndës mësimore dhe programit studimor.

Kontrolli i njohurive të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë në studimet universitare realizohet nëpërmjet vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm.

Vlerësimin e jashtëm e kryejnë vlerësuesit e jashtëm, të përcaktuar nga Këshilli i Akreditimit dhe Evalvimit të Arsimit të Lartë.

Së paku  $\frac{1}{4}$  e numrit të përgjithshëm të SETK-ut të programit mësimor, vlerësohet nga vlerësues i jashtëm dhe i brendshëm. Nga ky numër përjashtohen kreditë që studenti i fiton nga mobiliteti.

Ministri kompetent për punët nga sfera e arsimit të lartë miraton program katërvjeçar për vlerësim të jashtëm, sipas të cilit çdo vit përcakton se për cilat sfera shkencore do të kryhet vlerësim i jashtëm.

Lëndët mësimore që do të vlerësohen edhe nga vlerësues të jashtëm, i përcakton Këshilli i Akreditimit dhe Evalvimit të Arsimit të Lartë.

Vlerësimi i jashtëm mbulon pjesë të rëndësishme të lëndës mësimore dhe programit studimor duke e përfshirë edhe punimin e magjistraturës, por jo më pak se 60% të aktiviteteve nga të cilat sipas sistemit të SETK-ut formohet nota e ciklit të parë të studimeve, përkatësisht jo më pak se 70% të aktiviteteve nga të cilat sipas sistemit të SETK-ut formohet nota e ciklit të dytë të studimeve.



Nota përfundimtare e lëndës mësimore është pozitive, nëse studenti ka marrë notë pozitive edhe nga vlerësuesi i jashtë edhe nga vlerësuesi i brendshëm për të gjitha aktivitetet që vlerësohen.

Lartësinë e kompensimit për punën e vlerësuesit të jashtëm, e përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e arsimit të lartë.

Mjetet e kompensimit nga paragrafi 13 i këtij neni, të institucioneve publike të arsimit të lartë, sigurohen nga buxheti i ministrisë kompetente për arsim të lartë.

Procedura e paraqitjes, e vlerësimit dhe e mbrojtjes së punimit profesional ose e magjistraturës bëhet para komisionit të përbërë prej tre anëtarësh me tituj mësimorë-shkencorë dhe shkencorë nga të cilët së paku dy duhet të jenë nga fusha përkatëse shkencore në të cilën është tema e punimit profesional ose e magjistraturës.

Studimet e doktoratës përfundojnë me dhënien e të gjitha provimeve, përgatitjen edhe mbrojtjen e punimit të doktoratës (disertacionit).

Në komisionin për mbrojtjen e punimit të magjistraturës ose doktoraturës, anëtar nuk mund të jetë personi i cili me personin që e mbron punimin e magjistraturës ose doktoraturës (disertacionin) është në farefisni në vijë të drejtë deri në cilëndo shkallë, ndërsa në vije anësore deri në shkallë të katërt, ose është bashkëshort, person që jeton në bashkësi jashtëmartesore ose farefis sipas krushqisë deri në shkallë të dytë, pa dallim nëse është bërë shkurorëzim ose jo.

Anëtarët e komisionit nga paragrafi 17 i këtij neni ndërmjet veti nuk duhet të jenë farefis në vijë të drejtë deri në cilëndo shkallë, ndërsa në vije anësore deri në shkallë të katërt, ose të jenë bashkëshorte, persona të cilët jetojnë në bashkësi jashtëmartesore ose farefis sipas krushqisë deri në shkallë të dytë, pa dallim nëse është bërë shkurorëzim ose jo.

Me programin studimor mund të caktohet se studimet e doktoratës së arteve përfundojnë me dhënien e të gjitha provimeve dhe dhënien e provimit përfundimtar para komisionit dhe/ose me përgatitjen ose realizimin e veprës artistike.

Procedura për regjistrimin, vlerësimin dhe mbrojtjen e disertacionit të doktoratit, përkatësisht përgatitjes dhe/ose realizimit të veprës artistike, rregullohet me statutin e universitetit. Mbrojtja e disertacionit të doktoratës bëhet para komisionit të përbërë nga 5 anëtarë në pozicione pedagogjiko-shkencore dhe shkencore nga të cilët të paktën 3 janë nga sfera shkencore përkatëse e temës së disertacionit të doktoratës.

Studimet profesionale të specializimit përfundojnë me dhënien e të gjitha provimeve, përgatitjen e trustit profesional dhe/ose dhënien e provimit përfundimtar përkatës në përputhje me programin studimor.

Me përfundimin e studimeve në bazë të këtij neni, studenti pajiset me titull përkatës profesional ose akademik ose me nivel si dhe me të drejta të tjera në përputhje me rregullat e veçanta.

Universiteti, instituti ose shkolla e larte profesionale e pavarur, personave që kane realizuar mesatare prej minimum 7,5 në ciklin e parë dhe të dytë, pas përfundimit të studimeve mundet me kërkesë të tyre t'u lejojë që përsëri të hyjnë në provim në numër të caktuar lëndësh, por jo më tepër se pesë lëndë.

Provimi i përsëritur i lëndëve nga paragrafi 23 i këtij neni mund të kryhet vetëm një herë.

### ***Kontrolli i njohurive***

Neni 114

Kontrolli i njohurive të studentit, sipas lëndëve të mësimit, bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit pedagogjik-arsimor dhe shprehet me pikë.

Për përmbushjen e detyrimeve për dhënien e provimit (në pjesë ose komplet), studenti mund të realizojë e shumta 100 pikë ose të marrë vlerësim pozitiv që shprehet deri në 10 (dhjetë), ku nota 5 (pesë) shënon sukses-arritje të pamjaftueshme.

Kontrolli i njohurive për lëndë mësimi të veçanta bëhet në mënyra të caktuara në programin studimor dhe në afate të caktuara me statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Universiteti, përkatësisht shkolla e lartë e pavarur profesionale, përcakton mënyrën e kontrollit të njohurive dhe dhënien e provimeve.

Vlerësimi përfundimtar në mënyrë të detyrueshme shënohet në indeks ose në ndonjë dokument tjetër dhe në formularin për vlerësim përfundimtar.

Nota mesatare e studentit përbën një mesatare aritmetikore të notave të vlerësimit përfundimtar për të gjitha lëndët e mësimit gjatë studimeve, përfshirë edhe provimin përfundimtar.

Certifikata ose dokumenti për vlerësimin e kryer lëshohet në bazë të të dhënave në fletëparaqitjet për provime për çdo program lëndor, të nënshkruara nga mësime dhënësi.

### ***Kundërshtim për notën e kontrollit të njohurive***

Neni 115

Studenti, brenda 24 orëve, mund të kundërshtojë pranë dekanit, përkatësisht drejtorit të institucionit të arsimit të lartë, nëse nuk është i kënaqur me vlerësimin përfundimtar, përkatësisht me notën, ose nëse mendon se provimi nuk është realizuar në përputhje me këtë ligj dhe me rregulloren e institucionit të arsimit të lartë.

Nëse dekani konfirmon se janë përmbushur kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, mësuesi do ta rikontrollojë notën e vlerësimit përfundimtar. Nëse mësuesi nuk e rikontrollon notën që ka vënë, studenti e jep provimin para një komisioni prej tre anëtarësh të përbërë nga mësues të së njëjtës fushë ose fushë të ngjashme mësimore-shkencore, në 24 orët e ardhshme, të ditës së ardhshme të punës.

Me kërkesë, studentit i mundësohet ta përsërisë vlerësimin përfundimtar për notë përfundimtare më të lartë për lëndën e mësimin në periudhë e shumta prej katër muajsh nga dhënia e provimit.

### *Diploma dhe shtesa e diplomës*

Neni 116

Studentit që do t'i përmbushë të gjitha detyrimet sipas programit studimor për pajisje me arsim të lartë në çdo cikël të shkollimit, universiteti dhe njësia e universitetit, përkatësisht shkolla e lartë e pavarur profesionale, në bazë të evidencës që mbahet për të, atij i lëshohet diplomë. Me diplomën vërtetohet që studenti ka përfunduar program studimor të ciklit të parë, të dytë e të tretë dhe pajiset me titull përkatës profesional ose shkencor. Pjesë përbërëse e diplomës është shtesa e diplomës.

Diplomën dhe shtesën e diplomës së universitetit e firmos rektori dhe dekani, përkatësisht drejtori i njësisë së universitetit dhe verifikohet me vulën e thatë të universitetit.

Diplomën dhe shtesën e diplomës së shkollës së lartë të pavarur profesionale e firmos drejtori, dhe verifikohet me vulë të thatë të shkollës së lartë të pavarur profesionale.

Shtojca e diplomës e lëshuar nga Universiteti, instituti ose shkolla e lartë profesionale e pavarur, përveç të dhënave të përcaktuara në nenin 2 pika 8 të këtij ligji, e përmban edhe mesataren e personit të realizuar përfundimisht me lëndët të dhëna në mënyrë plotësuese në pajtim me nenin 113 paragrafët 23 dhe 24 të këtij ligji.

Në shtojcën e diplomës për personat që do të realizojnë dhënie provimi në mënyrë plotësuese të një numri të caktuar të lëndëve në pajtim me nenin 113 paragrafët 23 dhe 24 të këtij ligji, shkruhet nota vetëm për ata që kanë realizuar mesatare 8 dhe mbi 8.

Diplomën e përbashkët dhe shtesën e diplomës e firmosin persona të autorizuar të institucioneve të pavarura të arsimit të lartë që organizojnë programet studimore për pajisje me diplomë të përbashkët.

Studentit, që do t'i përmbushë të gjitha detyrimet sipas programit studimor për perfeksionim ose vetëm një pjesë nga programi studimor për pajisje me arsim, i lëshohet vërtetim, për pjesën përfundimtare të programit studimor, i cili përmban të dhëna për nivelin, natyrën dhe përmbajtjen e studimeve, si dhe rezultatet e arritura.

Dokumente tjera publike, në kuptim të këtij ligji janë: vërtetimi, legjitimacioni i studentit dhe indeksi.

Legjitimacioni i studentit shërben për identifikimin e studentit, si dhe për evidencën elektronike për praninë e tij në mësim.

Institucionet e larta arsimore indeksin e studentit në mënyrë të detyrueshme e lëshojnë në formë të shkruar ose elektronike (indeks elektronik) ose vetëm në formë elektronike. Vërtetimi,

legjitimacioni i studentit dhe indeksi i studentit për pjesëtarët e bashkësive të cilët mësimin e përcjellin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase lëshohet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin në të cilën mbahet mësimi.

Universitetet publike mjetet e nevojshme për lëshimin e legjitimacionit të studentit dhe indeksin e studentit (indeksi elektronik) i sigurojnë nga burimet e përcaktuara në nenet 86 dhe 87 të këtij ligji.

Përmbajtja dhe forma e diplomës dhe udhëzuesi për përgatitjen e shtesës së diplomës dhe të dokumenteve të tjera publike të caktuara me këtë ligj, i përcakton ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë.

### *Heqja e diplomës*

Neni 117

Studentit që është pajisur me diplomë, në përputhje me këtë ligj mund t'i hiqet diploma e lëshuar, përkatësisht titulli profesional ose shkencor i fituar, nëse vërtetohet se nuk i ka përmbushur kushtet për pajisjen me statusin e studentit të institucionit përkatës të arsimit të lartë, se është pajisur me titull profesional ose shkencor në kundërshtim me kushtet për pajisje me titull profesional, përkatësisht shkencor, të caktuara me statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Kushtet dhe procedurën e heqjes së diplomës caktohen me rregulloren e universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

### *Promocioni për studimet e përfunduara*

Neni 118

Promocionin e personave që kanë përfunduar programe studimore profesionale ose akademike të ciklit të parë ose të programit studimor master ose të programeve studimore të specializimit të ciklit të dytë, e bën dekani, përkatësisht drejtori sipas procedurës së përcaktuar me rregulloren e njësisë, përkatësisht të institutit shkencor.

Promocionin e personave që kanë përfunduar programe studimore të doktoratës nga cikli i tretë dhe janë pajisur me titull shkencor doktor i shkencave, e bën rektori i universitetit, sipas procedurës së përcaktuar me statutin e universiteti.

### *Mbajtja dhe ruajtja e të dhënave personale*

Neni 119

Institucionet e arsimit të lartë mbajnë këtë evidencë me të dhënat personale të studentëve:

- 1) evidenca e studentëve të paraqitur për regjistrim dhe studentëve të regjistruar;
- 2) karton personal, që mbahet për çdo student që nga fillimi i studimeve deri në përfundimin e tyre përkatësisht deri në çregjistrim;
- 3) procesverbal për provimin, me të cilin evidentohen formulari i provimit, ecuria e provimit dhe

nota e arritur dhe

4) evidenca e dokumenteve të lëshuara për përfundim të studimeve.

Evidencat nga paragrafi 1 pikat 1), 2) dhe 4) të këtij neni përfshijnë. emrin dhe mbiemrin e studentit (për studentet edhe mbiemrin e vajzërisë), seksin, datën dhe vendin e lindjes, shtetin e lindjes, vendbanimin ose vendqëndrimin, numrin e amzës, nënshtetësinë, arsimin paraprak, mënyrën e studimit si dhe të dhëna të tjera sipas rregullave të veçanta. Evidenca nga paragrafi 1 pika 2 e këtij neni përfshin edhe të dhëna për provimet e dhëna, për avancimin dhe përfundimin e studimeve.

Evidencat nga paragrafi 1 pika 3) e këtij neni përfshin: emrin dhe mbiemrin e studentit, (për studentet edhe mbiemrin e vajzërisë), seksin, numrin e amzës, mënyrën e studimit, vitin e studimit dhe vitin studimor të regjistrimit të parë, datën dhe provimin, të dhëna lidhur me atë nëse provimin e jep për herë të parë apo e përsërit, si dhe notën e marrë në provim.

Dispozitat lidhur me mbajtjen, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave personale nga evidencat sipas këtij ligji, përdoren edhe për dokumentacion, në bazë të të cilit janë grumbulluar të dhënat personale. Dokumentet e arsimit paraprak pas përfundimit të procedurës së regjistrimit i kthehen studentit.

### ***Regjistri i studentëve të regjistruar, regjistri kryesor i studentëve të diplomuar***

Neni 120

Në institucionet e arsimit të lartë mbahen: libri amzë i studentëve të regjistruar dhe libri amzë i studentëve të diplomuar dhe dosje për çdo student. Formën dhe mënyrën e mbajtjes (në materiale dhe elektronike) dhe përmbajtjes së librit amzë të studentëve të regjistruar dhe të librit themeltar të studentëve të diplomuar, i përcakton ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë.

Regjistri i studentëve të regjistruar dhe regjistri themeltar i studentëve të diplomuar janë dokumente me vlerë të përhershme.

Neni 120-a

Për politikat e shkencës, dhe zhvillimin e veprimtarisë së përgjithshme shkencore dhe zhvillimin teknologjik në Republikën e Maqedonisë, si trup profesional dhe këshillëdhënës i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë formohet Këshill Nacional për arsimin e lartë, shkencën, inovacionet dhe teknologjitë (në tekstin e mëtutjeshëm: Këshilli Nacional).

Këshilli Nacional miraton rregullore për punë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë më së paku njëherë në vit i dorëzon raport për punën e tij.

Puna e Këshillit Nacional është publike.

## Neni 120-b

Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton aktvendim për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Nacional.

Këshilli Nacional përbëhet nga shtatëmbëdhjetë anëtarë, si vijon: Ministri kompetent për punët e arsimit dhe shkencës, kryetari i ASHAM-it, përfaqësuesi nga konferenca e rektorit, gjashtë anëtarë të emëruar nga Qeveria, nga një përfaqësues prej gjashtë zonat shkencore nga radha e kuadrit mësimor-shkencor dhe hulumtues nga konferenca ndëruniversitare, dy përfaqësues nga komuniteti i biznesit.

Të gjashtë anëtarët e emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, si dhe përfaqësuesit nga komuniteti i biznesit doemos duhet të jenë persona doktorë shkence, me minimum një shkallë të arsimit të kryer në 500 universitetet e para të ranguar sipas listës së Shangait, përkatësisht 200 universitetet e para të ranguar më mirë nga sfera shkencore përkatëse, përkatësisht 100 universitetet e para të ranguar më mirë me programin MBA në pajtim me universitetin e Shangait Xhio Tong, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement-World University Ranking, si dhe minimum pesë vjet përvojë pune dhe njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze.

Përfaqësuesit nga komuniteti i biznesit, anëtarët e Këshillit Nacional, nuk mund të jenë persona pronarë, themelues, të punësuar, profesorë, asistentë në institucionin privat të arsimit të lartë ose shkollën për arsim të lartë, ose farefis i tyre i afërt deri në brezin e dytë.

Mandati i anëtarit të Këshillit Nacional të Qeverisë është dy vjet.

Kryetar i Këshillit Nacional është ministri kompetent për punët e arsimit dhe shkencës.

Gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit Nacional zbatohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të qytetarëve që u përkasin të gjitha komuniteteve dhe respektohen kriteret e profesionalizmit dhe kompetencës.

Këshilli Nacional vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Punët profesionale dhe administrative teknike të Këshillit Nacional i kryen Ministria.

Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit u takon kompensim për punën në Këshill, shumën e të cilit e përcakton Qeveria në bazë të prezencës në mbledhjet e Këshillit.

## Neni 120-v

Kompetencat e Këshillit Nacional janë dhënia e propozimeve dhe mendimeve për:

- baza dhe drejtime nisëse të Qeverisë për Programin nacional për arsimin e lartë dhe veprimtaritë shkencore-hulumtuese,
- hulumtim shkencor, menaxhim me politikat shkencore,
- rregulla nga sfera e veprimtarisë shkencore-hulumtuese,
- sferat dhe programet prioritare për hulumtim shkencor dhe zhvillim teknologjik,

- harmonizim i Programit nacional me nevojat strategjike të Republikës së Maqedonisë,
- masat për zhvillimin e Republikës së Maqedonisë në të gjitha segmentet, të vendosura mbi bazë shkencore,
- zhvillim i politikave të veçanta me kërkesë të ministrit nga sfera e arsimit të lartë dhe shkaqet për financimin e tyre,
- programet dhe projektet më të rëndësishme për zhvillimin e Republikës së Maqedonisë,
- përcjellje e rezultateve dhe efekteve për zhvillimin e Republikës së Maqedonisë mbi bazë shkencore,
- Iniciativat lidhur me programet dhe projektet për bashkëpunim ndërkombëtar me interes të veçantë shtetëror,
- iniciativat lidhur me programet dhe projektet për bashkëpunim ndërkombëtar,
- trendët botërore dhe evropiane në veprimtarinë shkencore - hulumtuese dhe propozon masa për futjen e tyre në Republikën e Maqedonisë,
- programet vjetore të subjekteve për ushtrimin e veprimtarisë shkencore-hulumtuese,
- mjetet e kërkuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për realizimin e programeve vjetore për veprimtarinë shkencore-hulumtuese,
- realizimin e evalvimit të brendshëm dhe të jashtëm të veprimtarisë shkencore-hulumtuese dhe për përgatitjen e akteve nënligjore të cilat e rregullojnë këtë materie,
- realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar,
- krijimin dhe mirëmbajtjen e bazave të të dhënave për sistemin e veprimtarisë shkencore hulumtuese dhe
- çështje tjera të cilat do t'i kërkojë Qeveria.

### *Programi nacional për arsimin e lartë dhe veprimtari shkencore hulumtuese*

Neni 120-g

Programi nacional për veprimtari shkencore hulumtuese i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: programi nacional) del nga dokumentet strategjike zhvillimore nacionale të Republikës së Maqedonisë.

Në Programin nacional përcaktohen bazat nisëse, qëllimet, përmbajtja dhe vëllimi i detyrave në sferën e shkencës, mënyra e bashkërendimit të tyre dhe mënyra e financimit të veprimtarisë shkencore-hulumtuese, projeksionet për nevojat e kuadrove për shkencën dhe indikatorët për përcjelljen e efikasitetit të realizimit të veprimtarisë shkencore-hulumtuese, përmasa ndërkombëtare, lidhshmëria me ekonominë dhe rrjetin institucional, zhvillimi i arsimit të lartë dhe shkëmbimi i përvojave me institucionet tjera të arsimit të lartë në tërë botën për plotësimin e rekomandimeve nga procesi i Bolonjës.

Programi kombëtar është bazë për drejtimin dhe përcaktimin e shumës së fondeve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, për të kryer hulumtime shkencore.

Programi nacional realizohet nëpërmjet programit vjetor, realizimin e të cilit e përcjell ministri kompetent për punët nga sfera e arsimit të lartë.

Programin nacional e miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën prej katër vitesh, ndërsa pas mendimit paraparak të Këshillit Nacional, ASHAM-it dhe Konferencës Ndëruniversitare.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë Qeveria në çdo dy vjet i dorëzon raport për realizimin e programit dhe për gjendjen e veprimtarisë shkencore-hulumtuese dhe arsimit të lartë në vend.

## **Kreu i dhjetë**

# **TITUJT MËSIMORË-SHKENCORË, MËSIMORË DHE TË BASHKËPUNËTORËVE**

## *Titujt arsimorë-shkencorë dhe arsimorë*

Neni 121

Në fakultet titujt arsimorë-shkencorë janë docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar.

Në fakultetet e lëmit të shkencave filologjike dhe në institucionet e tjera të arsimit të lartë në të cilat realizohet mësimi i gjuhës titujt mësimorë-shkencorë janë lektor dhe lektor i lartë.

Në shkollat e larta profesionale titujt mësimorë janë mësimdhënës, mësimdhënës i lartë dhe profesor i shkollës së lartë profesionale.

Në institucionet e arsimit të lartë mund të bëhet zgjedhje edhe në tituj shkencorë në përputhje me Ligjin për veprimtarinë kërkimore-shkencore.

Veprimtari të arsimit të lartë mund të ushtrojë vetëm person i zgjedhur në tituj mësimorë-shkencorë dhe mësimorë dhe titujt për aq kohë për sa është zgjedhur.

Personi i zgjedhur në titullin mësimor-shkencor dhe mësimor gjatë një semestri të vitit të studimit mund të realizojë ligjëratë të më së shumti katër lëndëve mësimore nga cikli i parë i studimeve në një universitet.

Lëndët mësimore nga paragrafi 6 i këtij neni në mënyrë të detyrueshme janë nga e njëjta sferë shkencore.

Me përjashtim të paragrafit 5 të këtij ligji veprimtari të arsimit të lartë të studimeve nga cikli i parë, i dytë dhe i tretë mund të ushtrojë person i zgjedhur në tituj shkencorë në përputhje me dispozitat e Ligjit për veprimtari kërkimore-shkencore, sipas ekuivalencës së titujve të caktuara nga ky ligj.

Neni 122

*I fshirë [21](#)*



### *Asistentë-doktorantë*

Neni 123

Në fakultete zgjidhen asistentë - doktorantë të sferave shkencore përkatësisht artistike të përcaktuara me rregulloren e njësisë.

Asistentet-doktorantë zgjidhen me mandat pesëvjeçar nëpërmjet konkursit publik dhe vendosin marrëdhënie pune me orar të caktuar.

Asistentët-doktorantë marrin pjesë në procesin mësimor në vëllimin e përcaktuar me rregulloren e njësisë.

Asistentet-doktorantë mund të mbajnë ligjërata dhe të realizojnë provime, vetëm në prani të mentorit të tij.

Asistenti-doktorant detyrimisht regjistrohet në studime të doktoraturës deri në Konkursin e parë të shpallur nga Shkolla e doktoraturë, ndërsa shpenzimet e asistentit për studime të doktoraturës i mbulon institucioni i arsimit të lartë.

Nëse asistenti-doktorant nuk mbron disertacion të doktoraturës deri në skadimin e afatit kohor për të cilin është zgjedhur, i ndërpritet marrëdhënia e punës.

Institucioni i arsimit të lartë dhe asistenti-doktorant lidhin marrëveshje me të cilën rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella.

Shpallja e konkursit për pranimin e asistentëve-doktorantë publikohet në së paku tri gazeta ditore, në ¼ e faqes nga Universiteti ose njësia në përbërje të tij, përkatësisht shkolla e arsimit të lartë.

### *Kriteret për zgjedhje*

Neni 124

Zgjedhja në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë dhe tituj bëhen sipas kriterëve dhe procedurave të caktuara me këtë Ligj dhe me Rregulloren e universitetit, përkatësisht institucionit të pavarur të arsimit të lartë, mbi kriteret unike për zgjedhje të përcaktuara nga Konferenca ndëruniversitare.

### *Kritere për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë*

Neni 125

Arsimtarët në titujt mësimor-shkencor zgjidhen në sfera mësimore-shkencore të përcaktuara me statutin e universitetit, përkatësisht me statutin e shkollës së lartë të pavarur profesionale.

Për docent mund të zgjidhet personi i cili ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera mësimore në të cilën është zgjedhur, sukses mesatar së paku tetë në studimet e ciklit të parë dhe të dytë për çdo cikël veçanërisht, të botuara së paku katër punime shkencore-hulumtuese në sferën përkatëse në revista shkencore ndërkombëtare ose publikime shkencore ndërkombëtare ose dy punime shkencore në reviste shkencore me impakt faktor në pesë vitet e fundit, arritje në zbatimin e rezultateve hulumtuese dhe aftësi për realizimin e llojeve të veçanta të veprimtarive të larta arsimore dhe vlerësim pozitiv nga vetevalvimi.

Profesor i çrregullt mund zgjidhet personi i cili ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore në të cilën zgjidhet, të botuara së paku pesë punime shkencore-hulumtuese në sferën përkatëse në revista shkencore ndërkombëtare ose publikime shkencore ndërkombëtare ose tre punime shkencore në reviste shkencore me impakt faktor në pesë vitet e fundit, pjesëmarrje në projekte shkencore-hulumtuese, përkatësisht arritje të rëndësishme në zbatimin e rezultateve shkencore-hulumtuese, kontribut në aftësimin e arsimtarëve më të ri dhe i cili ka treguar aftësi për realizimin e llojeve të ndryshme të veprimtarive të larta arsimore dhe vlerësim pozitiv nga vetevalvimi.

Profesor i rregullt mund të zgjidhet personi i cili ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore për të cilën zgjidhet, të botuara së paku gjashtë punime shkencore-hulumtuese në sferën përkatëse në revista shkencore ndërkombëtare ose publikime shkencore ndërkombëtare ose katër punime shkencore në revistë shkencore me impakt faktor në pesë vitet e fundit, i cili ka marrë pjesë ose ka udhëhequr me projekte shkencore-hulumtuese dhe i cili ka kontribut në aftësimin e arsimtarëve më të ri dhe i cili ka treguar aftësi për realizimin e llojeve të ndryshme të veprimtarive të larta arsimore dhe vlerësim pozitiv nga vetevalvimi.

Për zgjedhje të sërishme për profesor të rregullt mund të zgjidhet personi i cili ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore për të cilën zgjidhet, të botuara së paku gjashtë punime shkencore-hulumtuese në sferën përkatëse në revista shkencore ndërkombëtare ose publikime shkencorë ndërkombëtarë ose katër punime shkencore në revistë shkencore me impakt faktor në pesë vitet e fundit, i cili ka marrë pjesë ose ka udhëhequr me projekte shkencore-hulumtuese dhe i cili ka kontribut në aftësimin e arsimtarëve më të ri dhe i cili ka treguar aftësi për realizimin e llojeve të ndryshme të veprimtarive të larta arsimore dhe vlerësim pozitiv nga vetevalvimi.

Në titullin mësimor-shkencor në njësi të njëjtët të institucionit të lartë arsimor nuk mund të zgjidhet personi i cili ka mbrojtur punim doktoraturë në fakultetin ku ka themeluar marrëdhënie pune përkatësisht në titull mësimor-shkencor, mësimor, përkatësisht bashkëpunëtor personi i cili është farefis në brez të parë deri në cilën do shkallë, ndërsa në vije anësore deri në shkallë të katërt.

Paragrafi 5 i këtij neni nuk ka të bëjë me personin i cili ka mbaruar studime të magjistraturës ose doktoraturës në një nga 500 universitetet e ranguar në listën e fundit të shpallur nga këto institucione: Instituti për Arsim të Lartë në Universitetin e Shangait Xhio Tong, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement – World University Ranking.

Paragrafi 6 i këtij neni nuk ka të bëjë për persona të cilët janë të zgjedhur në tituj mësimor-shkencor dhe bashkëpunëtor në institucion të lartë arsimor para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozitat e paragrafëve 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni nuk do të zbatohen për studimin e arteve, filologjisë dhe historisë kombëtare. Kushtet e veçanta për fushat e arti, filologjisë dhe historisë kombëtare i përshkruan institucioni për arsim të lartë me një akt të veçantë.

#### ***Kritere për zgjedhjen e asistentit-doktorant***

Neni 125-a

Asistent-doktorant mund të zgjidhet personi i cili ka kryer ciklin e dytë të studimeve nga sfera përkatëse shkencore, përkatësisht artistike, ka realizuar sukses mesatar prej së paku 8,50 në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, ka njohuri të gjuhës angleze të cilën kandidati e dëshmon me certifikatë për njohjen e gjuhës, dhe atë (TOEFEL) - së paku 74 pikë për dhënien elektronike të provimit nëpërmjet kompjuterit, jo më e vjetër se dy vjet nga dita e lëshimit, (IELTS) - së paku 6 pikë, jo më e vjetër se dy vjet nga dita e lëshimit, (TOLES) - njohuri bazike (Foundation leve), (ILEC) - e dhënë me sukses së paku B 2 (B2) dhe certifikatë Kembrixh për gjuhë angleze paraprake (Cambridge Certificate of Preliminary English) (B1); si dhe të tregojë aftësi për veprimtari shkencore-mësimore, përkatësisht mësimore- artistike.

Procedura për zgjedhje në asistent-doktorant zbatohet në pajtim me dispozitat e nenit 131 dhe nenit 132 të këtij ligji.

#### ***Kritere për zgjedhje në titujt e lektorëve***

Neni 126

Lektor mund të zgjidhet person i cili ka përfunduar studimet nga cikli i dytë i sferës shkencore në të cilën zgjidhet dhe tregon aftësi për punë arsimore, zotëron me problemet e disiplinës së tij dhe ka përvojë praktike në punën arsimore.

Lektor i lartë mund të zgjidhet person i cili ka përfunduar studimet e ciklit të dytë nga sfera shkencore në të cilën zgjidhet, ka publikuar punime shkencore dhe profesionale dhe tregon aftësi për punë arsimore.

#### ***Kritere të veçanta për zgjedhje në lëndët profesionale-artistike***

Neni 127

Docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar për lëndët profesionale-artistike, mund të zgjidhet edhe person që nuk ka nivel shkencor doktor shkencash, i cili ka përfunduar arsim të lartë të nivelit të dytë përkatës, ka vepra arti dhe profesionale të njohura, përkatësisht realizime që kanë domethënie të veçantë për afirmimin e kulturës dhe artit brenda dhe jashtë vendit, si dhe ka aftësi për punë arsimore.

### ***Kritere për zgjedhje në tituj në shkollën e lartë profesionale***

Neni 128

Ligjërues në shkollë të lartë profesionale mund të zgjidhet person i cili ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve akademike dhe tregon aftësi për punë të lartë arsimore e profesionale, ka publikuar punime shkencore dhe ka një përvojë të suksesshme shumëvjeçare në profesionin e tij.

Ligjërues i lartë në shkollë të lartë profesionale mund të zgjidhet person i cili ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve akademike, ka publikuar një numër të madh punimesh shkencore, përkatësisht profesionale dhe ka aftësi për punë të lartë arsimore e profesionale.

Profesor i shkollës së lartë profesionale mund të zgjidhet person i cili ka përfunduar doktoratë shkencash, ka publikuar punime shkencore e profesionale dhe ka aftësi për realizimin e punës së lartë arsimore e profesionale.

Neni 129

*I fshirë [22](#)*

Neni 130

*I fshirë*

### ***Konkursi për zgjedhje***

Neni 131

Zgjedhja në tituj mësues-shkencorë, shkencorë dhe mësues dhe tituj, bëhet me konkurs publik, që e shpall institucioni i arsimit të lartë në shtypin ditor.

Konkursi hapet për zgjedhje në të gjithë titujt mësues-shkencorë, shkencorë, përkatësisht pedagogjikë.

Marrja e titujve mësues-shkencorë e mësuesve të zgjedhur bëhet në mënyrë graduale.

Gjatë zgjedhjes nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohen dispozitat e këtij ligji për zgjedhje në tituj mësues-shkencorë, shkencorë dhe mësues.

Procedura e konkursit mund të zgjasë më së shumti gjashtë muaj. Nëse ajo nuk përfundon gjatë këtij afati, ndalohet procedura dhe shpallet konkurs i ri.

## *Procedura e zgjedhjes*

Neni 132

Zgjedhjen e kandidatëve në titujt mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë, e bën Këshilli mësimor-shkencor, përkatësisht Këshilli pedagogjik në bazë të vlerësimit të referatit të komisionit recensues, i cili formohet pas përfundimit të afatit të paraqitjes së kandidatëve.

Komisionin recensues e formon Këshilli mësimor-shkencor, përkatësisht Këshilli pedagogjik dhe përbëhet të paktën nga tre anëtarë. Anëtarët e komisionit recensues mund të jenë nga institucioni i arsimit të lartë i cili bën zgjedhjen dhe nga institucione të tjera të arsimit të lartë e institute shkencore që ushtrojnë veprimtari të arsimit të lartë në përputhje me këtë ligj.

Më shumë se gjysmën e anëtarëve të komisionit recensues e përbëjnë persona të zgjedhur në pozicione mësimore-shkencore dhe mësimore nga e njëjta sferë mësimore-shkencore, përkatësisht artistike nga e cila zgjidhet kandidati, ndërsa anëtarët e tjerë janë nga sfera të ngjashme mësimore-shkencore, përkatësisht artistike.

Anëtarët e komisionit recensues nuk mund të jenë në titull më të ulët se titulli që zgjidhet kandidati. Në bazë të parimit të reciprocitetit, anëtar i komisionit recensues, nën të njëjtat kushte të caktuara nga ky ligj për anëtarët e komisionit recensues, mund të jetë edhe mësimdhënës nga ndonjë institucion i akredituar i arsimit të lartë i shtetit të huaj me të cilin universiteti ka nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim të përbashkët.

Për të gjithë kandidatët e paraqitur komisioni recensues përgatit referat me shkrim. Referati i komisionit recensues përmban vlerësimin për arritjet shkencore, profesionale, pedagogjike dhe arritje të tjera të kandidatëve, që janë me rëndësi sa i përket përcaktimit të kushteve për zgjedhje të titullit përkatës, si dhe propozimit për zgjedhje të kandidatit në titullin përkatës. Institucioni i arsimit të lartë e publikon referatin e komisionit recensues në buletinin përkatës të universitetit dhe faqen web të universiteti, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë të paktën 15 ditë para ditës së zgjedhjes.

Komisioni recensues në referat i vlerëson realizimet e përgjithshme shkencore, profesionale dhe realizimet tjera të kandidatëve nga fillimi i karrierës deri në ditën e paraqitjes, në bazë të gjithë dokumentacionit të parashtruar që është me rëndësi për zgjedhjen. Komisioni recensues i vlerëson realizimet e kandidatit në afat prej tre muajsh

Nëse këshilli mësimor-shkencor, këshilli mësimor-artistik, përkatësisht këshilli pedagogjik nuk e zgjedh kandidatin e propozuar, konkursi përsëritet.

Zgjedhja në titull është bazë për themelimin e marrëdhënies së punës për kohë të caktuar, përkatësisht të pacaktuar.

Procedura për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë, më nga afër rregullohet me rregulloren e fakultetit dhe shkollës së lartë profesionale në bazë të rregullores për

kriteret dhe procedurat e zgjedhjeve në titujt mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë, të miratuar nga universiteti.

### *Themelimi i marrëdhënies së punës*

Neni 133

Personat e zgjedhur në titujt mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë, përkatësisht në titull bashkëpunëtori, themelojnë marrëdhënie pune dhe kanë të drejta e obligime nga kjo marrëdhënie pune në përputhje me këtë dhe me ligj tjetër dhe në bazë të kontratës kolektive të nënshkruar ndërmjet sindikatës së shumicës të organizuar në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë dhe Qeverisë të Republikës së Maqedonisë.

Personat e zgjedhur në titujt mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë, përkatësisht në titull bashkëpunëtori të cilët janë në marrëdhënie pune në institucionin publik të arsimit të lartë, ushtrojnë edhe veprimtari shëndetësore, në institucion publik shëndetësor.

Personat që janë në marrëdhënie pune në ndonjë institucion shëndetësor ndërsa janë zgjedhur në titujt mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë, përkatësisht në titull bashkëpunëtori në institucionin e arsimit të lartë, ushtrojnë edhe veprimtari të arsimit të lartë në institucion e arsimit të lartë.

Kushtet dhe mënyra sipas të cilave personat nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni ushtrojnë veprimtari shëndetësore, përkatësisht të arsimit të lartë dhe veprimtari kërkimore-shkencore, rregullohen me marrëveshje ndërmjet institucionit shëndetësor dhe atij të arsimit të lartë, në përputhje me ligjin.

Personat e zgjedhur në titujt mësimor-shkencor, mësimor, përkatësisht bashkëpunëtor janë të detyruar t'i realizojnë detyrimet pedagogjike.

Me detyrime pedagogjike të kuadrit mësimor-shkencor dhe mësimor nënkuptohet: realizimi i mësimi, mbajtja e konsultimeve me studente, mbajtja e provimeve, realizimi i mentorimit të studenteve dhe të ngjashme.

Me detyrime pedagogjike të kuadrit bashkëpunues nënkuptohet: mbajtja e ushtrimeve me studente, mbajtja e konsultimeve me studente dhe të ngjashme.

Kryerja e detyrimeve pedagogjike nga paragrafët 6 dhe 7 të këtij neni realizohen me pjesëmarrje të detyrueshme të kuadrit mësimor-shkencor, mësimor, përkatësisht bashkëpunues.

Për mbajtjen dhe praninë në mësim të kuadrit mësimor-shkencor dhe mësimor, përkatësisht mbajtjen dhe praninë në ushtrime të bashkëpunëtorëve, çdo institucion i lartë arsimor në mënyrë të detyrueshme mban evidencë elektronike.

Universitetet publike mjetet e nevojshme për mbajtjen e evidencës elektronike i sigurojnë nga burimet e përcaktuara në nenet 86 dhe 87 të këtij ligji.

Formën dhe përmbajtjen e evidencës nga paragrafi 9 i këtij neni e përcakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

Me zgjedhjen në titujt mësues-shkencorë, shkencorë dhe mësues, në titull, personi i zgjedhur themelon marrëdhënie pune për atë periudhë për të cilën është zgjedhur.

Në institucionin e arsimit të lartë, me pajtim të personit të zgjedhur nga paragrafi 1 i këtij neni, themelimi i marrëdhënieve të punës mund të jetë edhe për një periudhë më të shkurtër se periudha për të cilën është zgjedhur.

Personi i zgjedhur në titullin mësues-shkencor ose titullin bashkëpunëtor të cilit i pushon marrëdhënia e punës për shkak të ushtrimit të funksionit të personit të emëruar ose të zgjedhur, nuk mund të realizojë mësimin dhe të realizojë provime, nuk mund të jetë mentor ose anëtar i komisionit për vlerësim ose mbrojtje të tezës së magjistraturës dhe disertacionit të doktoraturës dhe nuk mund të pranojë kompensim nga institucioni i arsimit të lartë për veprimtarinë e ushtruar mësuese, shkencore-hulumtuese ose të aplikueshme.

### *Periudhat kohore për të cilat bëhet zgjedhja*

Neni 134

Docenti, profesori inordinar dhe ordinar dhe profesori i shkollës së lartë profesionale zgjidhen për një periudhë prej pesë vjetësh, ndërsa zgjidhje e serishme për profesor të rregullt gjatë kohës prej shtatë vjet.

Profesori ordinar pas zgjedhjes së përsëritur, respektivisht profesori i shkollës së lartë profesionale pas zgjedhjes së dytë, kanë marrëdhënie pune me afat kohor të pacaktuar dhe ruajnë titullin profesor ordinar përkatësisht profesor për gjithë jetën.

Lektori dhe lektori i lartë, mësimdhënësi dhe mësimdhënësi i lartë zgjidhen për një periudhë prej katër vjetësh.

### *Zgjedhje në titull pas kalimit të afatit kohor për të cilin është bërë zgjedhja*

Neni 135

Më së voni gjashtë muaj para skadimit të afatit kohor për të cilin është bërë zgjedhje në titujt mësues-shkencorë, shkencorë dhe mësues, në titull, rektori, dekani, përkatësisht drejtori shpallin konkurs për zgjedhje në të gjitha titujt mësues-shkencorë, shkencorë dhe mësues, në titujt.

Gjatë zgjedhjeve nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohen dispozitat e këtij ligji për zgjedhje në titujt mësues-shkencorë, shkencorë dhe mësues dhe titujt.

Koha e shpalljes së konkursit nga paragrafi 1 i këtij neni zgjatet për kohën e kaluar në leje lindjeje, sëmundje më të gjatë se gjashtë muaj, si dhe pezullimin e marrëdhënieve të punës në rastet e caktuara me ligj.

## *Zgjedhje e parakohshme në titull më të lartë*

Neni 136

Zgjedhje në titull më të lartë mësimitor-shkencor, mësimitor dhe shkencor dhe në titull, mund të bëhet para përfundimit të periudhës për të cilën është bërë zgjedhja në pozicionin ekzistues nëse mësuesi i ka përmbushur kushtet për zgjedhje në pozicion më të lartë dhe me punën prej të cilave së paku dy punime shkencore në revistat më prestigjioze ndërkombëtare me impakt faktor ose punimet janë cituar në to, shkencore e pedagogjike ka dhënë kontribut të veçantë për zhvillimin, përkatësisht aplikimin e veprimtarisë shkencore, përkatësisht artistike për të cilën është zgjedhur dhe ka botuar vepra shkencore dhe profesionale, pas përfundimit të paktën të gjysmës së kohës për të cilën është bërë zgjedhja.

Me përjashtim, personi mund të zgjidhet në titull më të lartë mësimitor-shkencor, mësimitor dhe shkencor ose titull edhe më herët, para mbarimit të së paku gjysmës së kohës për të cilën është bërë zgjedhja në titullin ekzistues, nëse përveç kushteve nga paragrafi 1 të këtij neni ka botuar së paku katër vepra shkencore ose profesionale në revista më prestigjioze ndërkombëtare me impakt faktor ose së paku ato janë cituar në të njëjtat. Zgjedhja e parakohshme në titullin më të lartë pas skadimit të gjysmës së periudhës kohore për të cilën është bërë zgjedhja në titullin ekzistues mund të realizohet për personat të cilat kanë doktoruar ose magjistruar në njërin prej 200 universiteteve të para të rangut të lartë në pajtim me listën e Shangait.

Zgjedhje e parakohshme në titull më të lartë para kalimit të së paku gjysmës së kohës për të cilën është bërë zgjedhja në titullin ekzistues, mund të realizohet për personat që e kanë marrë statusin shkencor-hulumtues pas doktoraturës në njërin prej 50 universiteteve të parë të ranguar lartë sipas rangimit të fundit të përcaktuar në listën e Shangait, nëse në këto universitete kanë udhëhequr projekt shkencor.

Aktvendim për përmbushjen e kushteve dhe fitimin e titullit nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni miraton dekani.

Personi i cili ka magjistruar ose ka doktoruar në njërin prej 200 universiteteve të para të ranguar në pajtim me rangimin e fundit në listën e Shangait, përkatësisht 200 universitetet e para të rangut më të mirë nga sfera shkencore përkatëse, përkatësisht 100 universitetet e para të rangut më të mirë sipas programit MBA në pajtim me universitetin e Shangait Xhio Tong, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement-World University Rankging, nga sfera shkencore për të cilën nuk ka veprimtari të mjaftueshme shkencore-hulumtuese në Republikën e Maqedonisë, mund të parashtrijë kërkesë për përkrahje nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e cila në bashkëpunim me dekanatin nga fakulteti përkatës, mund të ngrenë procedurë për marrëdhënie pune, në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Iniciativën për zgjedhje në titull më të lartë para përfundimit të afatit, duhet ta japin të paktën 2 institute, përkatësisht katedra nga fusha të ngjashme shkencore.

Procedura për zgjedhje të parakohshme në titull më të lartë realizohet në pajtim me nenet 131 deri 134 të këtij ligji.



Universiteti, përkatësisht instituti i pavarur i arsimit të lartë, shpall konkurs dhe realizon procedurën për zgjedhje të parakohshme në titull më të lartë, në përputhje me rregulloren për kriteret e vetme për zgjedhje të titullit dhe rregullores për kriteret dhe procedurë për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë dhe në tituj.

### *Personat që nuk janë zgjedhur*

Neni 137

Nëse gjatë zgjedhjes personi i cili më parë ka qenë i zgjedhur në titujt mësimorë-shkencorë, mësimorë dhe në titull, do të propozohet për zgjedhje në titull më të lartë dhe nuk do të zgjidhet në pozicionin më të lartë të propozuar, votohet sërish për zgjedhje në pozicionin ekzistues në të cilin është zgjedhur më parë.

Personit i cili nuk është zgjedhur në pozicion, i përfundon marrëdhënia e punës.

Personi nga paragrafi 2 i këtij neni ka të drejtë të kundërshtimi pranë organit i cili vendos lidhur me zgjedhjen. Nëse kundërshtimi nuk pranohet, personi ka të drejtë të ankohet pranë senatit të universitetit, i cili formon komision prej tre anëtarësh, të përbërë nga profesorë ordinarë nga e njëjta sferë ose nga sferë e ngjashme me sferën e atij që bën ankesën, nga të cilët dy anëtarë janë nga një tjetër institucion i arsimit të lartë. Komisioni dorëzon raport në të cilin jep vlerësim lidhur me zgjedhjen. Vendimi i senatit të universitetit është përfundimtar.

### *Përfundim i parakohshëm i zgjedhjes*

Neni 138

Personi i zgjedhur në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë dhe mësimorë dhe në titullin, është i detyruar vazhdimisht të perfeksionohet e të tregohet nga pikëpamja shkencore, profesionale, përkatësisht artistike, ta ushtrojë me sukses veprimtarinë e arsimit të lartë, të japë kontributin e tij në formimin e kuadrove të reja mësimorë-shkencore, përkatësisht artistike, të kujdeset për realizimin me sukses të programeve studimore, si dhe të japë kontributin e tij në zhvillimin, përkatësisht aplikimin e veprimtarisë shkencore, përkatësisht artistike për të cilën është zgjedhur.

Personit të zgjedhur në tituj mësimorë-shkencorë, mësimorë dhe në titullin mund t'i pushojë marrëdhënia e punës edhe para përfundimit të periudhës për të cilën ai është zgjedhur, nën kushte dhe procedurë të përcaktuar me ligj dhe statut, nëse verifikohet se për një kohë më të gjatë nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse pengon aktivitetet ligjore e statusore të institucionit të arsimit të lartë ose nëse pengon anëtarët e tjerë në realizimin e të drejtave të tyre dhe detyrimeve të tyre në institucionin e arsimit të lartë, nëse kanë ndaluar së ekzistuari kushtet kryesore në bazë të të cilave është bërë zgjedhja dhe shkelje të tjera disiplinore.

Kundër personit të zgjedhur në titullin mësimor - shkencor, mësimor, respektivisht titullin e bashkëpunëtorit, ngritët procedurë disiplinore nëse nuk i kryen detyrimet e veta pedagogjike, e veçanërisht nëse konstatohet se pa arsye nuk e realizon mësimin, gjegjësisht ushtrimet për studentët.

Me propozim të dekanit, rektori detyrimisht formon komision disiplinor, në rast të moskryerjes së detyrimeve pedagogjike.

Personit nga paragrafi 3 i këtij neni, i kumtohet dënim me para në lartësi prej 10 deri 30% të shumës njëmuajore të rrogës neto që i është paguar në muajin para kryerjes së shkeljes disiplinore, në kohëzgjatje prej tre deri në gjashtë muaj.

Në rast se personit nga paragrafi (3) i këtij neni i janë kumtuar dy masa disiplinore gjatë një viti akademik ose tre masa disiplinore gjatë dy viteve të fundit akademike, atij i pushon marrëdhënia e punës.

Aktvendim për pushimin e marrëdhënies së punës miraton rektori. [23](#)

Vendimin për përfundimin e zgjedhjes dhe marrëdhënieve të punës para përfundimit të periudhës për të cilën është zgjedhur personi në fjalë në tituj mësimorë-shkencorë dhe mësimorë ose në titullin, e merr organi që e ka zgjedhur në bazë të referatit të komisionit të përbërë nga tre profesorë ordinarë.

Personi nga paragrafi 3 i këtij neni ka të drejtë kundërshtimi pranë organit i cili vendos lidhur me përfundimin e zgjedhjes.

Nëse kundërshtimi nuk pranohet, personi ka të drejtë të ankohet pranë senatit të universitetit, i cili formon komision prej tre anëtarësh, të përbërë nga profesorë ordinarë nga e njëjta sferë ose nga sferë e ngjashme me sferën e atij që bën ankesën, nga të cilët dy anëtarë janë nga një tjetër institucion i arsimit të lartë. Komisioni dorëzon referat në të cilin jep vlerësim lidhur me zgjedhjen.

Vendimi i senatit të universitetit është përfundimtar.

### ***E drejta e ushtrimit të veprimtarisë në një institucion tjetër të arsimit të lartë***

Neni 139

Personi nga një njësi e universitetit mund të ushtrojë veprimtari të arsimit të lartë, përkatësisht artistike në njësi tjetër të universitetit në pozicion në të cilin është zgjedhur në të njëjtën sferë ose të sferë të ngjashme mësimore-shkencore, përkatësisht artistike. Personi nga një njësi e universitetit mund të ushtrojë veprimtari të arsimit të lartë, përkatësisht artistike në njësi tjetër të një universiteti tjetër, përkatësisht shkolla e lartë profesionale e pavarur në pozicion në të cilin është zgjedhur në të njëjtën sferë ose të sferë të ngjashme mësimore-shkencore, përkatësisht artistike, me pajtim të universitetit.

Personi nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni mund të ushtrojë veprimtari të arsimit të lartë jo më shumë se 100% të vëllimit të caktuar me dispozitën për norma dhe standarde.

### *Profesorë visiting*

Neni 140

Me ftesë të organit administrues të institucionit të arsimit të lartë, profesorët e akredituar të institucioneve të arsimit të lartë, profesorët e pensionuar nga 100 universitetet e para të radhitura në listën e fundit të publikuar të Institutit për arsimin sipëror në Universitetin e Shangait Xhio Tong, shkencëtarët e dalluar dhe artistët e spikatur nga vendi dhe jashtë, mundën si mysafirë pa shpalljen e konkursit, ta realizojnë veprimtarinë shkencore hulumtuese të arsimit të lartë, për kohën e caktuar.

Mënyrën, kohën dhe kushtet në të cilat kryhet veprimtaria nga paragrafi 1 i këtij neni, i përcakton ministri.

Universiteti, institucioni i arsimit të lartë, përkatësisht shkolla e arsimit të lartë detyrimisht miraton program për përfshirjen e visiting-profesoreve nga 500 universitetet e para të ranguara në pajtim me rangimin e fundit në listën e Shangait, përkatësisht 200 universitetet e para të rangut më të mirë nga sfera shkencore përkatëse, përkatësisht 100 universitetet e para të rangut më të mirë sipas programit MBA në pajtim me universitetin e Shangait Xhio Tong, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement- World University Rankging në programet studimore të fakulteteve të tyre, përkatësisht njësisive në përbërje.

Programi miratohet për periudhën prej 2 vitesh. Universiteti, institucioni i arsimit të lartë, përkatësisht shkolla e arsimit të lartë në pajtim me programin për përfshirjen e visiting-profesorëve nga paragrafi 3 i këtij neni, ka për obligim që para fillimit të vitit shkollor të angazhojë visiting - profesore nga 500 universitetet e para të ranguara në pajtim me universitetin e Shangait Xhio Tong, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement- World University Rankging në programet studimore të fakulteteve të tyre.

Neni 141

Shkencëtarë, ekspertë nga praktika dhe artistë të afirmuar, pa dallim nëse i përmbushin kushtet e caktuara me këtë ligj për zgjedhje në pozicione si specialistë dhe ekspertë, me ftesë, mund të realizojnë mësim për pjesë të caktuara të lëndës së mësimit, në vëllim dhe sipas kushteve të caktuara me statutin e institucionit të arsimit të lartë.

### *Pozicione të titulluara*

Neni 142

Shkencëtarë, ekspertë nga praktika dhe artistë dhe të afirmuar të institucionit të arsimit të lartë, të cilët i përmbushin kushtet për zgjedhje në pozicione, por për të cilët nuk ka vend të lirë pune për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, përkatësisht mësimorë mund të zgjidhen në pozicionin docent i titulluar dhe profesor inordinar i titulluar, sipas kushteve dhe procedurës së caktuar me këtë ligj.

Llojin dhe vëllimin e pjesëmarrjes në ushtrimin e veprimtarisë së arsimit të lartë të personave të zgjedhur më pozicionet e titulluara e përcakton këshilli mësimor-shkencor, përkatësisht mësimor-artistik.

### *Ekivalenca e titujve*

Neni 143

Për ushtrim të veprimtarisë së arsimit të lartë, nën kushte të caktuara me këtë ligj titujt shkencorë e të fituar sipas dispozitave të Ligjit për veprimtari kërkimore-shkencore, u përgjigjen këtyre pozicioneve shkencore e të bashkëpunëtorit të caktuara me këtë ligj: këshilltar shkencor - profesor ordinar, bashkëpunëtor i lartë shkencor - profesor inordinar, bashkëpunëtor shkencor - docent në institucion të arsimit të lartë.

### *Profesor nderi dhe doktor nderi i shkencave*

Neni 144

Një profesori të mirënjohur nga universiteti i Republikës së Maqedonisë dhe jashtë shtetit, i cili ka dhënë një kontribut të veçantë për zhvillimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, me propozim të njësisë, universiteti mund t'i ndajë titullin profesor nderi (profesor honoris causa).

Shkencëtarëve, afaristëve, artistëve dhe personave të tjerë të njohur nga vendi dhe bota, të cilët me veprat e tyre kanë dhënë kontribut të veçantë për zhvillimin e botëkuptimit shkencor, kulturor ose në ndonjë lloj tjetër mënyre kanë dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e arsimit të lartë, me propozim të institucionit të arsimit të lartë, përkatësisht institut shkencor të akredituar, universiteti mund t'i ndajë titullin doktor i nderuar i shkencave (doctor honoris causa).

Më nga afër dispozitat për ndarjen e titujve profesor nderi dhe doktor nderi i shkencave si dhe të drejtat e tyre, përcaktohen me statutin e universitetit.

### *Profesor emeritus*

Neni 145

Universiteti, me propozim të këshillit mësimor-shkencor të njësisë së universitetit, mund t'i ndajë titullin profesor emeritus një profesori ordinar në pension i cili është dalluar në mënyrë të veçantë në punën e tij shkencore, përkatësisht artistike, i cili ka tashmë reputacion ndërkombëtar dhe ka arritur rezultate në sigurimin e kuadrove të reja mësimore-shkencore e bashkëpunëtorë në sferën në të cilën është zgjedhur. Numri i përgjithshëm i profesorëve emeritus nuk mund të jetë më shumë se 5% nga numri i përgjithshëm i profesorëve të universitetit.

Profesor emeritus mund të marrë pjesë në realizimin e mësimin të studimeve të ciklit të tretë, në sferën në të cilën është zgjedhur.

Më nga afër dispozitat për ndarjen e titullit profesor emeritus dhe për të drejtat e tij, caktohen me statutin e universitetit.

## *Mungesë nga puna e paguar, e papaguar dhe viti dhe rritja e përkohshme e rrogës sabat*

Neni 146

Personit të zgjedhur në pozicionin mësimit-shkencor, shkencor dhe mësimit dhe pozicionin, në çdo pesë vjet, institucioni i arsimit të lartë mund t'i aprovojë mungesë nga puna të paguar me kohëzgjatje deri në një vit, përkatësisht mungesë nga puna të papaguar me kohëzgjatje deri në tre vjet për perfeksionim - specializim profesionale, përkatësisht shkencor në sferën përkatëse shkencore, përkatësisht artistike ose për qëndrim në institucion shkencor ose arti të arsimit të lartë me status në pozicion mësimit-shkencor ose kërkimor-shkencor.

Personi i zgjedhur në pozicionin mësimit-shkencor, shkencor përkatësisht mësimit në gjashtë vjet të ushtrimit të punës ka të drejtë për për thellim të specializimit në fushën që është lëndë e këtij kërkimi me kohëzgjatje e shumta dymbëdhjetë muaj, dhe për të cilën gjë detyrimi pedagogjik i shtyhet, por nuk mund të shtohet më shumë se një e treta.

Personave nga paragrafi 2 i këtij neni, nëse u lejohet qëndrim për thellim dhe përsosje profesionale përkatësisht shkencore në njërin nga 100 universitetet e para të ranguar në listën e fundit të shpallur nga institucionet vijuese: Instituti për arsimin e lartë pranë universitetit të Shangajit Xhio Tong, US News and Report i Times Higher Education Supplement-World University Ranking, Ministria e Arsimit dhe Shkencës iu lejon kompensim të harxhimeve për qëndrim në universitetin përkatës për vendosje, ushqim, sigurim shëndetësor dhe shpenzime të rrugës. Lartësia e kompensimit të shpenzimeve për qëndrim, verifikohet në bazë të njoftimit të universitetit përkatës. Gjatë kohës së qëndrimit studimor personi ka të drejtë page në lartësi prej 70% të pagës së fundit të paguar para shkuarjes në qëndrim për thellim dhe përsosje profesionale përkatësisht shkencore.

Mënyrën dhe procedurën e realizimit të së drejtës nga paragrafi 3 dhe 4 i këtij neni e përcakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

Kushtet për shfrytëzimin e të drejtave nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni, rregullohen më nga afër me statutin e universitetit përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

Neni 146-a

Arsimtarit të institucioneve publike të arsimit të lartë, që do të publikojë punim shkencor apo profesional në revistat më prestigjioze ndërkombëtare me faktor ndikimi, i rritet rroga në tre vitet e ardhshme për 20% nga rroga që e ka marrë.

Mënyrën e rritjes së rrogës nga paragrafi 1 të këtij neni, e përcakton ministri.

Neni 146-b

Mësimdhënësit i cili ka udhëhequr ose ka marrë pjesë në projektin arsimor të njërit nga 50 universitetet e para të radhura në pajtim me listën e fundit të shpallur të Shangait, i paguhet kompensim mujor në shumë prej 30% të rrogës që e ka pranuar në periudhë prej një viti, me çka

pjesëmarrësi merr 20% për tre vite, ndërsa udhëheqësi merr 50% për vitin e parë dhe 20% për dy vitet e ardhshme.

Mësimdhënësit kanë të drejtë për kthimin e shpenzimeve rrugore dhe ditore dhe shpenzimet për kuotizimin për pjesëmarrje në së paku dy konferencat ndërkombëtare në vit të organizuara/të mbajtura në njërin nga shtetet e OECD-së, nëse kanë paraqitur punë shkencore nga materia në fjalë.

Mësimdhënësit të cilët ligjërojnë në programet studimore për të cilët institucioni i lartë arsimor i Republikës së Maqedonisë jep diplomë të dyfishtë ose të përbashkët me universitet të radhitur ndër 200 universitetet e rangut më të lart në pajtim me listën e Shangait kanë të drejtë për kompensim mujor prej 15% nga rroga e paguar e fundit, në muajt në të cilët mbahen ligjëratat.

Mësimdhënësit të punësuar në universitet, për çdo punim të publikuar në reviste shkencore me faktor impakti, autor i të cilit është mësimdhënësi, mund t'i paguhet kompensim i njëfishtë në lartësi të një rrogë të fundit neto që i është paguar mësimdhënësit.

Profesorët e huaj të cilët ligjërojnë në programet studimore për të cilët institucioni i lartë arsimor i Republikës së Maqedonisë lëshon diplomë të dyfishtë ose të përbashkët me universitet të radhitur ndër 200 universitetet e para të rangut më të lartë kanë të drejtë për kompensim të rrogave dhe të shpenzimeve ditore, nëse ato nuk u janë mbuluar ose nëse ekzistojnë kushte për këtë.

Kompensimet nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni paguhet nga të hyrat me të cilat në mënyrë të pavarur disponojnë njësitë e universitetit.

Kompensimi nga paragrafi 5 paguhet nga të hyrat të cilat universiteti i ka fituar nga njësitë e dedikuara për financimin e veprimtarive të integruara.

### ***Fundi i marrëdhënieve të punës për shkak të plotësimit të kushteve për pension***

Neni 147

Personit të zgjedhur në pozicionin mësimor-shkencor ose pedagogjik, i cili gjatë viti shkollor e ka vazhduar marrëveshjen për punësim në pajtim me rregullat për marrëdhënie pune, marrëdhëniet e punës i zgjasin deri në fund të atij viti shkollor.

Profesor ordinar në pension mund të realizojë studime të ciklit të tretë ose të punojë në projekte kërkimore-shkencore nën kushte të caktuara me statutin e universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

## ***Periudha në të cilën fitohen të drejtat e detyrimet e pozicionit për personat të zgjedhur nga komisioni amë***

Neni 148

Person i zgjedhur në pozicionin mësimor-shkencor dhe pedagogjik dhe pozicionin, nga komisioni amë në procedurën e themelimit të institucionit të arsimit të lartë, fiton të drejta dhe detyrime në pozicionin për të cilin është zgjedhur, të caktuara me këtë ligj, ditën e regjistrimit të institucionit të arsimit të lartë në regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë.

### **Kreu i njëmbëdhjetë**

## **STUDENTËT**

### ***Statusi i studentit***

Neni 149

Statusi student, dhe me këtë edhe anëtar i bashkësisë akademike fitohet me regjistrimin në ciklin e parë, të dytë e të tretë të studimeve në universitet, përkatësisht në institucion të pavarur të arsimit të lartë.

Statusi student vërtetohet me librezën e anëtarësimit studentor.

### ***Të drejtat dhe detyrimet e studentit***

Neni 150

Studenti ka të drejtë të ketë:

- studime dhe proces shkollimi cilësor ashtu siç është parashikuar me programet studimore,
- shprehje të lirë të mendimit dhe qëndrimeve gjatë orës së mësimit dhe gjatë aktiviteteve të tjera të institucionit të arsimit të lartë,
- të drejtë të shprehjes (vlerësimi) sa i përket cilësisë së mësimit dhe profesorëve,
- studime të rregullta dhe status të studentit të rregullt si dhe të drejtë për studime me korrespondencë e status të studentit me korrespondencë,
- të përparojë rregullisht, të shkollohet e të përfundojë studimet nën kushte që kanë qenë të vlefshme gjatë regjistrimit të tij,
- të regjistrohet e shkollohet nën kushte të njëjta të caktuara me ligj, statut dhe program studentor,
- të marrë pjesë në menaxhimin me institucionin e arsimit të lartë në bazë të këtij ligji dhe statutit të institucionit të arsimit të lartë,
- të mbrojë të drejtat dhe detyrimet e tij para organeve të institucionit të arsimit të lartë dhe
- të mbrojë personalitetin e studentit nga keqpërdorimi dhe të mbrojë dinjitetin e tij.

Studenti ka të drejtë edhe:

- të mund të përparojë dhe t'i përfundojë studimet për një periudhë më të shkurtër se ajo që është parashikuar nga programi studimor,

- të studiojë në të njëjtën kohë në disa programe studimore nga specializime të ndryshme dhe të ndjekë kurse suplementare,
- t'i vazhdojë studimet në tjetër institucion të arsimit të lartë nëse institucioni i arsimit të lartë në të cilin është regjistruar pushon së funksionuari,
- të shfrytëzojë bibliotekën dhe bazën e të dhënave, ambientin, pajisjet (mjete shkollore ndihmëse), software-in dhe infrastrukturë tjetër shkencore e profesionale të universitetit dhe të njësisve të tij, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë,
- të marrë pjesë në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe profesionale dhe ku i garantohen çmimet e të drejtat e autorit, të zbulimit dhe të drejta e çmime të tjera të ngjashme,
- të zgjedhë e të zgjidhet, si përfaqësues i studentëve në organet e institucioneve të arsimit të lartë,
- të shfrytëzojë shërbime të standardit studentor (strehim, ushqim, mbrojtje shëndetësore dhe të tjera), transport urban e ndërurban sipas kushteve të caktuara me ligj nga ushtruesit e veprimtarive përkatëse,
- të shfrytëzojë objektet universitare për veprimtari sportive e kulturore,
- të transferohet nga një institucion i arsimit të lartë në tjetrin, përkatësisht nga një program studimor në tjetrin dhe gjatë kësaj të shfrytëzojë favorët e sistemit të kredive,
- të marrë pjesë në punën e organizatave të studentëve,
- të marrë pjesë në format e organizimit të organizatave studentore të caktuara me statutin e universitetit,
- t'i vazhdojë studimet e ndërprera, nën kushte të caktuara me statutin e institucionit të arsimit të lartë,
- të përdorë pushime jo më pak se 60 ditë në kuadër të një viti kalendarik,
- të fitojë bursë shteti ose lloje të tjera bursash ose të shfrytëzojë kredi financiare për tu mirëmbajtur gjatë kohës së shkollimit,
- të realizojë bashkëpunim me studentë në vend dhe jashtë tij dhe
- të realizojë edhe të drejta të tjera në bazë të ligjit dhe statutit të institucionit të arsimit të lartë.

Studenti ka detyrim që:

- të përmbushë detyrat të caktuara në programet studimore,
- t'i respektojë dispozitat e këtij ligji, statutit të institucionit të arsimit të lartë dhe aktet e tjera juridike të rregullave të brendshme,
- t'i zbatojë vendimet e organit drejtues, rektorit, përkatësisht drejtorit të institucionit të pavarur të arsimit të lartë,
- të reagojë në përputhje me kodin etik studentor të cilin e përgatit dhe miraton institucioni i arsimit të lartë në përputhje me përfaqësimin studentor.

Studentët e të gjitha niveleve të arsimit të lartë që janë pa prindër, të verbër, shurdhë, invalidë të grupit të parë e të dytë, nënë me fëmijë deri në moshën gjashtë vjeçare dhe të hospitalizuarit kanë të drejtë për favore të veçanta të caktuara me statutin e institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

Të drejtat nga paragrafi 1 dhe 2 dhe detyrimet nga paragrafi 3 i këtij neni, studenti i institucionit të arsimit të lartë i realizon në vëllim dhe sipas kushteve të caktuara me ligj dhe statutin e institucionit të arsimit të lartë.



Për arsye mbrojtjen e të drejtave të studentëve, në çdo universitet formohet avokati i studentëve. Kompetencat, zgjedhja dhe puna e avokatit të studentëve përcaktohen me statutin e universitetit.

Neni 150-a

Studentët e regjistruar në ciklin e dytë të studimeve universitare dhe në ciklin e tretë të studimeve për doktoratë në universitete shtetërore, të cilët do të kenë mundësi për qëndrim studimor në një nga 100 universitetet e para të ranguara në listën e fundit të shpallur nga institucionet vijuese: Instituti për arsim të lartë pranë universitetit të Shangajit Xhio Tong, US News and Report i Times Higher Education Supplemet –World University Ranking, Ministria e Arsimit dhe Shkencës iu lejon kompensim të harxhimeve për qëndrim studimor në universitetin përkatës për vendosje, ushqim, sigurim shëndetësor dhe shpenzime të rrugës. Lartësia e kompensimit të shpenzimeve për qëndrimin studimor, verifikohet në bazë të njoftimit të universitetit përkatës.

Mënyrën dhe procedurën e realizimit të së drejtës nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

### *Studime paralele*

Neni 151

Studenti mund të studiojë në dy ose më shumë programe studimore njëkohësisht të ciklit të parë të studimeve (studim paralel), një ose më shumë institucione të arsimit të lartë.

Studenti është i liruar nga pagesa e shpenzimeve për studimin e programit të dytë studimor dhe të çdo programi të ardhshëm studimor në të cilin do të regjistrohet nëse:

- në programin e parë studimor e ka kryer me sukses vitin e parë akademik dhe e përfundon çdo vit të ardhshëm akademik me notë mesatare mbi 9 dhe
- nëse programi i dytë dhe çdo program i ardhshëm studimor ku do të regjistrohet është nga sfera shkencore e shkencave bio-teknike, teknike teknologjike ose të shkencave matematiko-natyrore, komunikacion dhe transport, inxhinieri industriale dhe menaxhment, kontroll të kualitetit, mjedis jetësor dhe gjeografi.

Për nevojat e studimit paralel, institucionet e arsimit të lartë në veçanti i përshtatin aktivitetet e parapara me programet studimore.

Në programin e dhënë studimor numri më i madh i studentëve për studim paralel mund të jetë deri në dhjetë studente.

Institucionet e arsimit të lartë, studimin paralel e rregullojnë me rregullore të veçantë me të cilën më afër rregullohen mënyra dhe kushtet për studim.

### *Transferimi nga një program studimor në tjetrin*

Neni 152

Gjatë studimeve, studenti mund të transferohet nga një program studimor në një tjetër ose nga një institucion i arsimit të lartë në një tjetër, nën kushte të caktuara me program studimor, përkatësisht me statut të institucionit të arsimit të lartë në të cilin studenti transferohet.

Student i cili ka qenë i regjistruar në institucionin e arsimit të lartë i cili ka pushuar së funksionuari, ka të drejtë t'i vazhdojë studimet në një institucion të arsimit të lartë të njëjtë ose të ngjashëm nën kushte të caktuara me këtë ligj dhe me statutin e institucionit të arsimit të lartë në të cilin do t'i vazhdojë studimet.

### *Rregulla të studimit*

Neni 153

Me statutin e universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë dhe më nga afër me rregullat e njësisë së universitetit, përkatësisht me statutin e institucionit të pavarur të arsimit të lartë më nga afër rregullohen procedurat dhe rregullat veçanërisht për:

- kalendarin studentor,
- procedurat e regjistrimit,
- regjimin e provimeve,
- përparimin, përfshirë edhe kushtet për përparim të shpejtë,
- përfundimin e studimeve,
- transferimin ndërmjet programeve studimore,
- përsëritjen e vitit përkatësisht përparimin e kushtëzuar,
- vazhdimin e studimeve pas ndërprerjes,
- studimin paralel, ndërdisiplinor dhe individual dhe
- njohjen e provimeve dhe detyrimeve të tjera studimore të dhëna në institucione të ndryshme të pavarura të arsimit të lartë.

Me statutin e universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë përveç çështjeve nga paragrafi 1 i këtij neni, rregullohet edhe:

- lloji i dokumenteve që i lëshohen studentit mbi bazën e evidencës të caktuar me këtë ligj,
- procedura për mbrojtjen e të drejtave të studentëve,
- organet, kompetente për realizimin e procedurave dhe për marrjen e vendimeve,
- përgjegjësia disiplinore dhe të drejtat e detyrimit e studentëve në procedurën disiplinore dhe
- rregulla të tjera lidhur me të drejtat dhe detyrimet e studentëve.

### *Fundi i statusit student*

Neni 154

Studentit i përfundon statusi i studentit në institucionin e arsimit të lartë sipas kushteve dhe procedurës së caktuar me statutin e institucionit të arsimit të lartë. Statusi nga paragrafi 1 i këtij neni përfundon nëse studenti:

- diplomon,
- nuk i përfundon studimet në periudhën e caktuar me ligj dhe statut,
- nuk e plotëson kushtin për regjistrim në vit më të lartë brenda afatit të caktuar me statut dhe rregullat,
- çregjistrohet dhe
- përjashtohet.

Statusi nga paragrafi 1 i këtij neni mund të rinovohet sipas procedurës së caktuar me statutin e institucionit të arsimit të lartë, me përjashtim vetëm nëse statuti ka pushuar së funksionuari përgjithmonë. Shpenzimet për rinovimin e statusit i mbart studentit.

### *Masa disiplinore*

Neni 155

Për cenim të obligimeve dhe për mospërbushje të detyrimeve, studentit në studime diplomike mund t'i jepet masa disiplinore: vërejtje, vërejtje publike dhe përjashtim.

Masa disiplinore përjashtim zbatohet për vitin shkollor në të cilin është dhënë.

Masat disiplinore i jep komisioni për masa disiplinore të institucionit përkatës të arsimit të lartë.

Në përbërjen e komisionit disiplinor një anëtar delegohet nga studentët e institucionit të arsimit të lartë në të cilin është i regjistruar studentit.

Me statutin e universitetit përkatësisht statutin e shkollës së lartë profesionale të pavarur përcaktohet përbërja e komisionit disiplinor, mënyra dhe procedura për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore, masat dhe kushtet nën të cilat jepet masa disiplinore dhe e drejta e mbrojtjes së studentit.

Procedura për përgjegjësi disiplinore realizohet në bazë të parimit të drejtësisë dhe dëgjimit nga ana e komisionit për masa disiplinore.

### *Pjesëmarrja e studentëve në menaxhim*

Neni 156

Studentët marrin pjesë në menaxhimin e institucioneve të arsimit të lartë nëpërmjet përfaqësuesve që i zgjedhin në parlamentin studentor të universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë, parlamentit studentor ndëruniversitar, në organet e institucioneve të arsimit të lartë, nëpërmjet formave të vetorganizimit ose ndonjë mënyre tjetër sipas kushteve të caktuara me ligj dhe me statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Parlamenti studentor i universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë dhe parlamentit studentor ndëruniversitar, u mundëson studentëve realizimin e interesave të përbashkëta si partnerë në procesin e arsimit të lartë.

Pjesëmarrja e studentëve në organet e universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë, në parlamentin studentor, çështjet për të cilat marrin vendime në mënyrë të barabartë, numri, mënyra e zgjedhjes dhe çështje të tjera domethënëse për realizimin e të drejtave të tyre, rregullohen me statutin e universitetit dhe rregullat e njëjësive të universitetit, përkatësisht me statutin e institucionit të pavarur të arsimit të lartë.

Pjesëmarrja e studentëve në parlamentin ndëruniversitar, çështjet për të cilat marrin vendime në mënyrë të barabartë, numri, mënyra e zgjedhjes dhe çështje të tjera domethënëse për realizimin e të drejtave të tyre, më nga afër rregullohen me statutin e parlamentit ndëruniversitar.

## **Kreu i dymbëdhjetë**

### **EKUIVALENCA DHE NJOHJA E KUALIFIKIMEVE TË ARSIMIT TË LARTË**

Neni 157

Ekuivalenca dhe njohja e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë bëhet në përputhje me këtë ligj dhe me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare.

Kriteri bazë për ekuivalencën dhe njohjen e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë, i caktuar me sistemin e përgjithshëm të njohjes së kualifikimeve, me rregullat e Bashkimit Evropian është statusi i institucionit të arsimit të lartë i cili e ka lëshuar kualifikimin, përkatësisht nëse ky institucion është i akredituar dhe i autorizuar nga organet kompetente të shtetit amë (ose nga ndonjë tjetër) për lëshimin e kualifikimeve, përkatësisht diplomave dhe dëftesave, ndërsa njohja e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë do të bëhet në bazë të sistemit Evropian të transferimit të kredive.

Neni 158

Lidhur me ekuivalencën dhe njohjen e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë mbahet evidencë. Mënyrën e mbajtjes së evidencës e përcakton Ministria kompetente për funksionimin e arsimit të lartë.

Neni 159

Për ekuivalencën dhe njohjen e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë, ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë formon komisione sipas fushave dhe sferave të caktuara, të përbëra nga pesë anëtarë nga Profesorë Universiteti nga sfera përkatëse. Punët profesionale dhe administrative – teknike të komisioneve i ën ministria përkatëse për arsim të lartë.

Ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë merr dhe publikon vendimin për ekuivalencën dhe njohjen e kualifikimi të huaj të arsimit të lartë brenda 20 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës për ekuivalencë dhe njohje të kualifikimit të huaj të arsimit të lartë, me propozim të komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni.

Ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë merr dhe publikon vendimin për ekuivalencën dhe njohjen e kualifikimi të huaj të arsimit të lartë brenda 8 ditë pune, nëse kualifikimi i huaj i arsimit të lartë është fituar në një nga 500 universitetet e para të renditura në listën e fundit të publikuar nga këto institucione: Instituti i arsimit të lartë pranë Universitetit Xhio Tong të Shangait, US News and Report dhe Times Higher Education Supplemet –World University Ranking.

Nëse ministri kompetent për punët e arsimit të lartë nuk miraton aktvendim për ekuivalencë dhe pranim të kualifikimit të arsimit të lartë të huaj, përkatësisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës në afatin nga paragrafi 2, përkatësisht 3 të këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditëve të punës të parashtojë kërkesë në sekretarinë e ministrit kompetent për punët e arsimit të lartë dhe ministri kompetent për punët në arsimin e lartë të miratojë aktvendim. Nëse ministri kompetent për punët e arsimit të lartë nuk ka sekretari, kërkesa parashtrëhet në sekretarinë e selisë së ministrisë kompetente për punët e arsimit të lartë.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi 4 i këtij neni, i përcakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

Me kërkesën për miratimin e aktvendimit për ekuivalencë dhe pranim të kualifikimit të arsimit të lartë të huaj nga paragrafi 4 i këtij neni, kërkuuesi dorëzon edhe kopje nga kërkesa nga paragrafi 2, përkatësisht paragrafi 3 i këtij neni.

Ministri kompetent për punët e arsimit të lartë është i obliguar që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi 4 në sekretarinë e ministrit kompetent për punët e arsimit të lartë, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për ekuivalencë dhe pranim të kualifikimit të arsimit të lartë të huaj pranohet apo refuzohet.

Nëse ministri kompetent për punët e arsimit të lartë nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi 7 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

Inspektori është i obliguar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi 8 i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje në ministrinë kompetente për punët e arsimit të lartë nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Inspektori pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin, miraton aktvendim me të cilin e ngarkon ministrin kompetent për punët e arsimit të lartë që në afat prej dhjetë ditësh të vendose për kërkesën e paraqitur, përkatësisht ta pranojë apo refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur.

Nëse ministri kompetent për punët e arsimit të lartë nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi 10 i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuara në Ligjin për inspeksionin administrativ dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin ministri kompetent për punët e

arsimit të lartë do të vendosë për kërkesën e paraqitur për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Nëse ministri kompetent për punët në arsimin e lartë nuk vendos në afatin nga paragrafi 11 i këtij neni, inspektori do të parashtojë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në afat prej 3 ditëve e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Nëse inspektori nuk vepron për njoftimin nga paragrafi 8 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë që të parashtojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit, ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi 13 i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar për njoftimin e parashtruesit të kërkesës nga paragrafi 8 i këtij neni dhe/ose nuk parashtron kallëzim në pajtim me paragrafin 12 të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ për inspektorin dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në ministrinë kompetente për punët e arsimit të lartë nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi 14 i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim të prokurori publik kompetent kundër inspektorit, dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Në rastin nga paragrafi 15 i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë punë do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

Në rastet nga paragrafi 16 i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin 14 të këtij neni, qytetari mund të parashtojë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

Nëse ministri kompetent për punët e arsimit të lartë nuk vendos në afatin nga paragrafi 10 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngrihte kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Akti nënligjor nga paragrafi 5 i këtij neni, miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të këtij ligji.

Pas miratimit të aktit nënligjor ai menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e ministrisë.

#### Neni 159-a

Në institucionin e lartë arsimor në Republikën e Maqedonisë që jep diplomë të përbashkët me Universitetin nga lista e 500 universiteteve të rangut më të lartë në pajtim me listën e fundit të Shangait, pa zbatimin e procedurës për ekuivalencën dhe pranimin e kualifikimeve të larta arsimore, mund të regjistrohet studenti i cili arsim paraprak ka ndjekur në institucionin e lartë arsimor të akredituar në shtetin nënshkrues të Konventës për pranimin e kualifikimeve të larta arsimore në rajonin e Evropës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 47/2002).

Pa zbatimin e procedurës për ekuivalencë dhe pranimin e kualifikimeve të larta arsimore mund të regjistrohet studenti i cili paraprakisht arsimin e ka kryer në institucionin e lartë arsimor të akredituar në një nga 100 universitetet e para të rangut më të lartë pas programit të MBA-së në pajtim me radhitjen e fundit të universitetit të Shangait Xhio Tong, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement-World University Rankging.

Pa zbatimin e procedurës për ekuivalence dhe pranimin e kualifikimeve të larta arsimore mund të regjistrohet studenti i cili paraprakisht arsimin e ka kryer në institucionin e lartë arsimor të akredituar në një nga 200 universitetet e parë të rangut më të lartë të sferës shkencore në pajtim me radhitjen e fundit të universitetit të Shangait Xhio Tong, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement- World University Rankging.

#### Neni 160

Kërkuesi i cili nuk është i kënaqur me vendimin e njohjes së kualifikimit të huaj të arsimit të lartë, ka mundësi brenda 15 ditësh nga dita e pranimin të vendimit, të ankohet pranë Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë.

#### *Neni 161*

Qendra informative për ekuivalencën dhe njohjen e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë (në vijim të tekstit: ICEP) si shërbim i specializuar pranë Ministrisë kompetente për funksionimin e arsimit të lartë, realizon veprimtari që kanë të bëjnë me punët profesionale administrative në realizimin e procedurës së ekuivalencës dhe njohjes së kualifikimit të huaj të arsimit të lartë.

ICEP përcakton llojin dhe shkallën e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë duke e krahasuar me kualifikimet e arsimit të lartë që fitohen në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë, por duke pasur parasysh kornizën Kombëtare të kualifikimeve. Ekuivalenca bëhet në përputhje me tre ciklet e kualifikimit të parashikuar me procesin e Bolonjës në hapësirën Evropiane të arsimit të lartë, përkatësisht nivelet e parashikuara me kornizën Evropiane të kualifikimeve.

## Neni 161-a

Procedura për ekuivalencën dhe njohjen e kualifikimit të huaj për arsim të lartë, fillohet me parashtrimin e kërkesës për njohjen e kualifikimit të huaj për arsim të lartë (në tekstin e mëtejme: kërkesa) nga bartësi i kualifikimit të huaj për arsim të lartë në Qendrën Informativë për Ekuivalence dhe për Njohjen e Kualifikimeve të Huaja për Arsim të Lartë (në tekstin e mëtejme QIENJ) në ministrinë kompetente për çështjet e arsimit të lartë.

Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni përmban: të dhëna për kërkuarësin: emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, numrin unik amë (në rast se ka), vendin dhe shtetin e lindjes, shtetësinë, kombësinë, gjininë (mashkullore, femërore), adresën e banimit: qytetin dhe shtetin, e-postën, numrin e telefonit për kontakt; të dhëna për kualifikimin e huaj të fituar për arsim të lartë, për të cilin kërkohet njohje: emrin e institucionit për arsim të lartë, adresën e institucionit për arsim të lartë, qytetin, shtetin, ueb adresën e institucionit për arsim të lartë, fushën studiuuese - drejtimin; mënyrën e studimit (e rregullt, me korrespondencë, mësim në largësi, diplomë e përbashkët); shkallën/titullin/emrin/profesionin e fituar; kohëzgjatjen e studimeve sipas programit studiuës, datën e regjistrimit të studimeve; datën e përfundimit të studimeve; datën e lëshimit të kualifikimit, kushtet për fitimin e kualifikimit të huaj për arsim të lartë (teza, disertacioni, provimi i dhënë, tjetër); nëse kualifikimi për arsim të lartë është fituar në një nga 500 universitetet e para të ranguar në listën e fundit të shpallur nga institucionet në vijim: Instituti për Arsim të Lartë në Universitetin Xhio Tong në Shanghai, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement - World University Ranking; të dhëna për arsimin paraprak: arsimin e mesëm: emrin e institucionit, qytetin dhe shtetin, titullin e kualifikimit të fituar, vitin e regjistrimit, vitin e përfundimit; arsimin e lartë: emrin e institucionit për arsim të lartë, qytetin dhe shtetin, titullin e kualifikimit të fituar, vitin e regjistrimit, vitin e përfundimit, qëllimin e njohjes së kualifikimit të huaj për arsim të lartë në Republikën e Maqedonisë (vazhdim i arsimit, punësim dhe tjetër); deklaratën e parashtruesit të kërkesës për vlefshmërinë e dokumentacionit të parashtruar në QIENJ, qytetin dhe datën e parashtrimit të dokumentacionit dhe nënshkrimin e kërkuarësit.

Lartësinë e kompensimit të shpenzimeve për procedurën për njohje, në bazë të shpenzimeve të bëra reale, mënyrën e ndarjes së kompensimeve, lirimin nga pagimi i shpenzimeve dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës, i përcakton ministri përgjegjës për çështjet e arsimit të lartë.

## Neni 161-b

Me kërkesën nga neni 161-a, paragrafi 1 i këtij ligji, bashkëngjiten edhe dokumentet në vijim:

- diploma e huaj për arsim të lartë në origjinal, e verifikuar me vulë apostil, për shikim,
- fotokopje e diplomës për arsim të lartë, e verifikuar te noteri,
- përkthim i diplomës së arsimit të lartë në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, i verifikuar te noteri,
- vërtetim origjinal me notat/transkript gjegjësisht shtojce e diplomës,
- fotokopje të vërtetimit me notat/transkript, e verifikuar te noteri,
- përkthim i vërtetimit me notat/transkript në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, i verifikuar te noteri,



- indeksi origjinal,
- fotokopje e diplomës nga arsimit paraprak, e verifikuar te noteri,
- vërtetim i lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, për vlefshmërinë e dokumentit të huaj për arsim të lartë, i lëshuar nga i njejt,
- vërtetim për akreditimin dhe për autorizimin e institucionit për arsim të lartë i cili e ka lëshuar kualifikimin për arsim të lartë, të lëshuar nga organet kompetente, përgjegjëse për akreditim dhe për autorizim në shtetin amë,
- plan dhe program studimor gjatë kohëzgjatjes së studimit,
- punimi i magjistraturës ose disertacioni i doktoraturës në formë të shtypur ose elektronike,
- librezë për specializim me turne të shënuara (në rast se bëhet fjalë për studime nga fusha shkencore e shkencave mjekësore dhe shëndetësisë),
- dy punime shkencore kërkimore të recensuara të publikuara si autor i parë në revistat ndërkombëtare shkencore si edhe provë se studimet kanë zgjatur së paku tre vjet (në rast se bëhet fjalë për njohjen e kualifikimit të arsimit të lartë për studime doktoraturë),
- fletëpagesë dhe
- dokumente të tjera për të cilat komisioni vlerëson se janë të nevojshme, e të cilat kanë të bëjnë me njohjen e kualifikimit të huaj për arsim të lartë.

Nëse diploma nga paragrafi 1, alineja 8 e këtij neni është fituar jashtë, kërkuesi për të të dorëzojë provë për nostrifikimin e kryer nga ana e ministrisë kompetente për çështjet e arsimit të lartë.

#### Neni 161-v

Nëse procedura nga neni 161-a e këtij ligji ka të bëjë me njohjen e kualifikimit të arsimit të lartë të fituar në njërën nga 500 universitetet e para të ranguara në listën e fundit të shpallur nga institucionet në vijim: Instituti për Arsim të Lartë në Universitetin Xhio Tong në Shangai, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement - World University Ranking, ministri përgjegjës për çështjet e arsimit të lartë miraton aktvendim për ekuivalencë dhe për njohjen e kualifikimit të huaj të fituar për arsim të lartë, pa propozim të komisioneve nga neni 159 i këtij ligji.

Gjatë ekuivalencës dhe njohjes së kualifikimit të huaj për arsim të lartë nga paragrafi 1 i këtij neni, merren parasysh krahasimi dhe ngjashmëria e kualifikimit të huaj për arsim të lartë me kualifikimet vendore për arsim të lartë, respektivisht harmonizimi me Kornizën nacionale për kualifikime.

Për procedurën nga paragrafi 1 i këtij neni, me kërkesën parashtrohet origjinali dhe fotokopja e verifikuar te noteri e diplomës dhe vërtetimit origjinal me notat/transkript, gjegjësisht shtojca e diplomës për kualifikimin e huaj të fituar për arsim të lartë. Ato duhet të jenë të përkthyer dhe të verifikuara nga përkthyesi i autorizuar gjyqësor.

Kërkuesi parashtron edhe provë së kualifikimi i huaj për arsim të lartë është fituar në njërën nga 500 universitetet e para të ranguara në listën e fundit të shpallur nga institucionet në vijim: Instituti për Arsim të Lartë në Universitetin Xhio Tong në Shangai, US News and Report dhe Times Higher Education Supplement - World University Ranking.

Përmbushjen e kushteve nga paragrafi 2, 3 dhe 4 të këtij neni e kontrollon QIENJ.

Nëse konstatohet se nuk janë përmbushur kushtet nga ky nen, ministri përgjegjës për çështjet e arsimit të lartë miraton aktvendim për mosnjohjen e kualifikimit të huaj për arsim të lartë.

#### Neni 161-g

Aktvendimi për ekuivalencë dhe për njohje të kualifikimit të huaj për arsim të lartë, do të anulohet nga ministri përgjegjës për punët e arsimit të lartë në procedure të veçantë, në rast se konstatohet pavlefshmëria e dokumentit të huaj për arsim të lartë ose në rast se ai është lëshuar nga institucioni i huaj për arsim të lartë i cili nuk është akredituar në procedurë përkatëse.

Aktvendimi për mosnjohjen e kualifikimit të huaj për arsim të lartë do të lëshohet nga ministri përgjegjës për çështjet e arsimit të lartë në rast se komisioni profesional nga fusha përkatëse konstaton dallime thelbësore në krahasim me programin studimor (arsimor) vendor, dallime në vëllimin, përmbajtjen, kohëzgjatjen ose shkallën e arsimit të lartë, ndërsa të njëjtat janë të rëndësishme për funksionin e kualifikimit.

#### Neni 161-d

QIENJ-ja dërgon kërkesë për kontrollimin e vlefshmërisë së dokumentit të huaj për arsim të lartë respektivisht bartësit të tij, në institucionin i cili e ka lëshuar dokumentin.

QIENJ-ja e kontrollon akreditimin e institucionit të huaj për arsim të lartë i cili e ka lëshuar atë.

Aktvendimi për ekuivalencë dhe për njohjen e kualifikimit të huaj për arsim të lartë, do të anulohet në procedurë të veçantë, në rast se konstatohet pavlefshmëria e dokumentit të huaj për arsim të lartë ose në rast se institucioni i huaj për arsim të lartë nuk është akredituar në procedurë përkatëse.

#### Neni 161-gj

Gjatë vendimmarrjes për ekuivalencë dhe për njohjen e kualifikimeve të huaja për arsim të lartë, komisionet për fusha dhe lëmi të caktuara do të kenë parasysh si vijon:

- krahasimin dhe ngjashmërinë e kualifikimit të huaj për arsim të lartë me kualifikimet vendorë për arsim të lartë, gjegjësisht harmonizimin me Kornizën nacionale të kualifikimeve,
- vëllimin, llojin, zgjatjen dhe shkallën e programit studimor në përputhje me Sistemin Evropian për Transferimin e Kredive (SETK),
- sistemin dhe Kornizën nacionale për kualifikime prej të cilit kualifikim vjen,
- statusin e institucionit të huaj për arsim të lartë i cili e ka lëshuar kualifikimin, gjegjësisht nëse i njëjti është i akredituar dhe i autorizuar nga organet kompetente në shtetin amë (ose tjetër), për lëshimin e kualifikimeve gjegjësisht diplomave dhe dëftesave,
- arritjet mësimore,
- kushtet për regjistrimin e programit studimor, respektivisht institucionit për arsim të lartë i cili e ka lëshuar kualifikimin,
- të drejtat të cilat kualifikimi, gjegjësisht diploma ose dëftesa i japin në shtetin amë,

- qëllimet e ekuivalencës respektivisht njohjes në Republikën e Maqedonisë dhe
- praktikën e mëparshme gjegjësisht rastet e ngjashme të zgjidhura paraprakisht.

Gjatë miratimit të aktvendimit për ekuivalencë dhe për njohje, merren parasysh edhe përmbajtje të tjera të cilat janë me rëndësi për ekuivalencën dhe për njohjen e kualifikimit të huaj për arsim të lartë në Republikën e Maqedonisë.

#### Neni 161-e

Në procedurën për ekuivalencë dhe njohje të kualifikimit të huaj për arsim të lartë, komisionet për ekuivalencë dhe njohje, bëjnë krahasimin e lëndëve, të programeve studimore, si dhe të shkalleve të arsimit, të kushteve për regjistrim të programit arsimor, të drejtave të cilat diploma respektivisht certifikata i jep në shtetin ku është lëshuar, të kredive të fituara gjatë studimeve në përputhje me sistemin evropian për transferimin e kredive (SETK), si edhe rezultatin nga procesi arsimor.

Në rast të përfundimit të pjesshëm të arsimit të lartë, vërtetohet pjesa e përfunduar e programit studimor (arsimor).

#### Neni 161-zh

Komisionet për fushat dhe lëmit e caktuara e propozojnë llojin, shkallën dhe titullin e kualifikimit të huaj të arsimit të lartë, respektivisht përdorimin e titullit profesional ose shkencor, gjegjësisht profesionin, titullin në Republikën e Maqedonisë në përputhje me Dekretin për kornizën nacionale për kualifikimet e arsimit të lartë.

Aktvendimi për njohjen, respektivisht mosnjohjen e kualifikimit të huaj për arsim të lartë, lëshohet në tre ekzemplare prej të cilëve një ekzemplar i dorëzohet kërkuarit, ndërsa dy ekzemplare mbeten në ministrinë përkatëse për çështjet e arsimit të lartë.

#### Neni 161-z

Për rrjedhen e mbledhjeve të komisioneve për fushat dhe lëmit e caktuara mbahet procesverbal

Procesverbali nga paragrafi 1 i këtij neni përmban: vendin dhe kohën, emrat e anëtarëve të pranishëm të komisioneve, emrin dhe mbiemrin e parashtruesit të kërkesës, lëndën për të cilën procedohet, profesionet/titujt që i propozojnë komisionet te ministri përgjegjës për çështjet e arsimit të lartë, vërejtjet eventuale në lidhje me kërkesën.

Procesverbali mund të përmbajë edhe të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me punën e komisioneve.

Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e komisionit.

#### Neni 161-x

Kërkesa për njohjen e kualifikimit të huaj për arsim të lartë mund të pranohet tërësisht ose pjesërisht.

Nëse programi studimor (arsimor) i përfunduar jashtë, në krahasim me programin studimor (arsimor) vendor paraqet dallime thelbësore në vëllimin, në përmbajtjen ose në shkallën e arsimit të lartë, ndërsa ato janë të rëndësishme për funksionin e kualifikimit, kërkesa për njohjen e kualifikimit të arsimit të lartë të fituar në vend të huaj, nuk njihet në tërësi, me ç'rast komisioni duhet t'i arsyetojë shkaqet për mosnjohjen si edhe vëllimin, llojin dhe thelbin e dallimeve.

#### Neni 161-i

Nëse në procedurën për ekuivalencën dhe njohjen e kualifikimit të huaj për arsim të lartë, komisionet konstatojnë lëshime dhe dallime në programet arsimore, kërkuesi mund të udhëzohet të japë provime plotësuese, për mënjanimin e dallimeve.

Kur kërkuesi do t'i japë provimet e parashikuara plotësuese, kërkesa për njohje pranohet në tërësi.

#### Neni 161-j

Njohja e kualifikimit të arsimit të lartë për kryerje të veprimtarisë profesionale e cila nuk bën pjesë në grupin e profesioneve të rregulluara, është procedurë në të cilën bartësit të dokumentit të huaj me aktvendim do t'i njihet gjegjësisht do t'i përcaktohet shkalla, lloji dhe titulli i kualifikimit të huaj të arsimit të lartë dhe klasifikohet në sistemin e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë.

Me marrjen e aktvendimit me të cilin njihet kualifikimi i arsimit të lartë i fituar në vend të huaj, bartësi i kualifikimit të huaj për arsim të lartë mund ta kryejë profesionin e fituar jashtë, në rast se ai nuk bën pjesë në grupin e profesioneve të rregulluara në Republikën e Maqedonisë.

#### Neni 161-k

Procedura për njohjen e kualifikimit të arsimit të lartë për kryerje të veprimtarisë profesionale e cila nuk bën pjesë në grupin e profesioneve të rregulluara, i cili është fituar jashtë, fillohet me kërkesë të bartësit të dokumentit të huaj.

Kërkesa duhet t'i përmbajë të dhënat nga neni 161-a, paragrafi 2 i këtij ligji.

#### Neni 161-l

Për procedurën e njohjes për kryerje të veprimtarisë profesionale e cila nuk bën pjesë në grupin e profesioneve të rregulluara, e fituar jashtë, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me ekuivalencën dhe njohjen e kualifikimeve të huaja të arsimit të lartë.

## Kreu i trembëdhjetë

### **MBIKQYRJA E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË**

#### *Mbikëqyrja e ligjshmërisë gjatë punës*

##### Neni 162

Atëherë kur ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë do të verifikojë se institucioni i arsimit të lartë punon në kundërshtim me këtë ligj, me procesverbal do t'i tërheqë vërejtjen institucionit të arsimit të lartë për paligjshmërinë gjatë punës dhe do t'i përcaktojë afat jo më pak se një muaj për mënjanimin e paligjshmërisë.

Nëse institucioni i arsimit të lartë, brenda afatit të caktuar, nuk do të procedojë në bazë të vërejtjeve nga paragrafi 1 i këtij neni, ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë merr vendim për ndërprerjen e përkohshme të punës së institucionit të arsimit të lartë dhe për këtë njofton themeluesin.

Ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë para marrjes së vendimit për ndërprerje të përkohshme të punës së institucionit të arsimit të lartë, do të kërkojë mendim nga Këshilli i akreditimit.

Kundër vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni mund të bëhet ankesë pranë Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë. Ankesa nuk e shtyn zbatimin e vendimit.

Kundër vendimit të Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë, mund të ngrihet padi në Gjykatën administrative.

Pas vendimit fuqiptotë të Gjykatës Administrative, ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë merr vendim për fshirjen e institucionit të arsimit të lartë nga regjistri i institucioneve të arsimit të lartë.

Nëse ministria kompetente për punët e arsimit të lartë përcakton se rregullorja, vendimi, aktvendimi ose ndonjë akt tjetër i Këshillit për Akreditim dhe Evalvim është në kundërshtim me dispozitat e ligjit, ministri kompetent për punët e arsimit të lartë miraton aktvendim për asgjësimin e aktit të Këshillit për Akreditim dhe Evalvim dhe ngre procedure për përgjegjësi të anëtarëve të Këshillit para organeve kompetente në vend.

##### Neni 163

Atëherë kur ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë do të verifikojë se institucioni i arsimit të lartë ka marrë vendim që nuk është në përputhje me këtë ligj, do t'i tërheqë vërejtje institucionit të arsimit të lartë për paligjshmërinë e vendimit dhe do të përcaktojë afat për mënjanimin e paligjshmërisë, afat i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se një muaj.

Nëse brenda afatit të caktuar institucioni i arsimit të lartë nuk e mënjanon paligjshmërinë, ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë me vendim do ta anulojë ose shfuqizojë vendimin e paligjshëm.

Kundër vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni, institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë të ankohet pranë Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë.

Kundër vendimit nga paragrafi 3 i këtij neni, institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë të ngrejë padi pranë Gjykatës administrative.

### ***Mbikëqyrje për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë***

Neni 164

Nëse akti i përgjithshëm i institucionit të arsimit të lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën ose ligjin, ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë ka të drejtë ta ndalojë zbatimin e tij dhe është i detyruar, brenda tetë ditësh nga dita e marrjes së vendimit për ndalim, të nis proces për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të ndaluar para Gjykatës administrative të Republikës së Maqedonisë.

Ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë para se të nisë procesin për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë mund ta informojë institucionin e arsimit të lartë për ndalimin e aktit dhe t'i tërheqë vërejtjen që brenda 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit për ndalim, ta mënjanojë paligjshmërinë. Nëse institucioni i arsimit të lartë brenda këtij afati nuk procedon sipas vërejtjes, ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë, në afatin tjetër prej tetë ditësh nga dita e kalimit të afatit prej 30 ditësh, nis procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të aktit të ndaluar.

### ***Mbikëqyrje për lëshimin e diplomave***

Neni 165

Nëse ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë në ekzekutimin e të drejtës për mbikëqyrje të ligjshmërisë gjatë punës verifikon se institucioni i arsimit të lartë ka lëshuar diplomë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, ai merr vendim për anulimin e diplomës gjë që publikohet në mjetet e informimit publik dhe bën denoncim pranë prokurorit publik për ndjekje penale të personit përgjegjës.

### ***Mbikëqyrja e inspektimit***

Neni 166

Mbikëqyrjen e inspektimit mbi institucionet e arsimit të lartë e bën Inspektorati shtetëror i arsimit, në përputhje me këtë ligj.

## Neni 166-a

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror i arsimit konstaton se për herë të parë është kryer parregullsi nga neni 167 paragrafi (1) i këtij ligji, është i obliguar që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer, me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së përcaktuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzimin njëkohësisht të ftesës për realizimin e edukimit të personit apo institucionit të arsimit të lartë, ku është përcaktuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim si dhe mënyrën e realizimit të edukimit, i përcakton ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

(3) Edukimin e organizon dhe realizon Inspektorati Shtetëror i Arsimit, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të realizohet për më tepër parregullsi të përcaktuara të njëjta apo të njëllojta për një apo më tepër persona, përkatësisht për një apo më tepër institucione të arsimit të lartë.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose institucioni i arsimit të lartë për të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(6) Nëse personi apo institucioni i arsimit të lartë për të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe të njëjtin e kryen, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsinë e përcaktuar.

(7) Nëse inspektori shtetëror i arsimit gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë menjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori shtetëror i arsimit gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë menjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtron kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

(9) Inspektorati Shtetëror i Arsimit mban evidencë për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri kompetent për punët e arsimit të lartë.

## Kreu i katërmbëdhjetë

### DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE PENALE

#### Neni 167

(1) Gjobë në shumë prej 4.000 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- shfrytëzon emra të institucioneve të arsimit të lartë, pa u themeluar si institucion i arsimit të lartë, në pajtim me këtë ligj (neni 5),

- nuk kryen vetevaluim të universitetit, njësisë së universitetit, përkatësisht institucionit të pavarur të arsimit të lartë, në mënyrë dhe sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me statutin e universitetit, përkatësisht të institucionit të pavarur të arsimit të lartë (neni 73 deri në nenin 77) dhe
- nuk mban evidencë të të dhënave personale të studentëve (neni 119).

(2) Gjobë në shumë prej 5.000 euro deri në 7.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- zbaton statut për të cilin nuk është marrë pajtim nga organi kompetent (neni 9),
- kryen ndryshime statusore pa pajtimin e themeluesit (neni 39),
- arkëton nga studentet detyrime tjera në kundërshtim të masave dhe kritereve të përcaktuara në pajtim me këtë ligj (neni 83 paragrafi 1 alineja 8),
- arkëton kofinancim të studimeve, përkatësisht participim të studentëve mbi shumën e përcaktuar me këtë ligj (neni 83 paragrafi 1 alineja 9),
- realizon programe studimore pa akreditim, përkatësisht aktvendim për fillimin e punës, në pajtim këtë ligj (neni 104),
- nuk shpall konkurs për regjistrim të studentëve së paku pesë muaj para fillimit të mësimin dhe nëse i njëjti nuk i përmban komponentet e nevojshëm në pajtim me ligjin për arsimin e lartë, si dhe regjistron në vitin e parë të studimeve studentë që nuk i përmbushin kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe me konkurs (neni 108),
- kryen regjistrim të studentëve më tepër se sa numri i përcaktuar me vendimin për regjistrim të studentëve, apo më tepër nga kapaciteti për të cilin institucioni i arsimit të lartë është akredituar (neni 110),
- nuk e mban librin e amzës të studentëve të regjistruar dhe librin kryesor të studentëve të diplomuar, apo nëse i mban në kundërshtim me formën dhe mënyrën e përcaktuar të mbajtjes dhe përmbajtjes (neni 120),
- angazhon mësimdhënës që të kryejë veprimtari të arsimit të lartë, përkatësisht veprimtari artistike nga ndonjë institucion tjetër i arsimit të lartë, pa pajtim të universitetit dhe në kundërshtim me normativen dhe standardet për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë (neni 139) dhe
- e kryen zgjedhjen e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (prej nenit 121 deri në nenin 148).

(3) Gjobë në shumë prej 100.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- e pengon gjatë punës, refuzon t'ia japë apo nuk ia jep të gjitha të dhënat e nevojshme për rangim, personit juridik që e kryen rangimin (neni 77-a paragrafi 4).

(4) Gjobë në shumë prej 2.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 2.500 deri në 3.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, për kundërvajtjet nga paragrafi (2) i këtij neni.

(6) Gjobë në shumë prej 20.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, për kundërvajtjen nga paragrafi (3) i këtij neni.



## Neni 167-a

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës në institucionin e arsimit të lartë, nëse nuk emëron kryerës detyre dekan, në përputhje me nenin 37 paragrafi 2 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës në institucionin e arsimit të lartë, në rast se nuk i publikon në ueb faqe rezultatet e vetevalvimit, në pajtim me nenin 77 paragrafi 5 të këtij ligji.

Gjobë në shume prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës në institucionin e arsimit të lartë, nëse nuk i dërgon në ministrinë përgjegjëse për çështjet e arsimit të lartë rezultatet e vetevalvimit, në përputhje me nenin 77, paragrafi 8 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet personit përgjegjës i institucionit të arsimit të lartë për kundërvajtje, nëse nuk organizohet realizimi i mësimin për programet studimore në gjuhë angleze nga neni 103 paragrafi 5 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 30.000 deri në 35.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet institucionit të arsimit të lartë, për kundërvajtjen nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet personit përgjegjës të institucionit të arsimit të lartë për kundërvajtje, nëse nuk lëshon legjitimacion të studentit nga neni 116 paragrafi 7 dhe indeks të studentit nga neni 116 paragrafi 8.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet personit përgjegjës në institucionin e arsimit të lartë për kundërvajtje, nëse nuk e vendos evidencën elektronike nga neni 133 paragrafi 9.

Gjobë në shumë prej 30.000 deri në 35.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet institucionit të arsimit të lartë, për kundërvajtjen nga paragrafi 6 i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit nga neni 112 paragrafi 5 nga ky ligj për kundërvajtje nëse në fillimin e secilit vit studimor, studentëve nuk u propozon literaturë themelore për dhënien e provimeve dhe e cila nuk e përmban edhe literaturën të cilën e siguron, shtyp dhe dorëzon te institucionet e arsimit të lartë, ministria kompetente për punët e arsimit të lartë.

Gjobë në shumë prej 3.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të institucionit të arsimit të lartë për kundërvajtje nëse nuk e publikon literaturën themelore në ueb faqe dhe nëse e njëjta nuk e përmban edhe literaturën të cilën e siguron, shtyp dhe dorëzon te institucionet e arsimit të lartë, ministria kompetente për punët e arsimit të lartë (neni 112 paragrafi 7).

Gjobë në shumë prej 500 deri në 700 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet personit të zgjedhur në titull mësimit shkencor ose titull mësimit për kundërvajtje, nëse ligjëron më shumë se katër lëndë mësimore gjatë një semestri të vitit akademik (neni 121 paragrafi 6).

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i kumtohet dekanit, respektivisht drejtorit për kundërvajtjen nga paragrafi 10 i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i kumtohet rektorit për kundërvajtje nga paragrafi 10 i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 30.000 deri në 35.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet institucionit të arsimit të lartë, për kundërvajtje nga paragrafi 10 i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 1.500 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet personit përgjegjës të institucionit të arsimit të lartë për kundërvajtje, nëse nuk formon komision disiplinor në rast të moskryerjes së detyrave pedagogjike (neni 138 paragrafi 4).

Gjobë në shumë prej 1.500 deri 2.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës në institucionin e arsimit të lartë për kundërvajtje, nëse nuk miraton aktvendim për pushimin e marrëdhënies së punës të personit të zgjedhur në titull mësimit-shkencor, titull mësimit, gjegjësisht titullin e bashkëpunëtorit, që nuk i kryen detyrat e veta pedagogjike, e veçanërisht nëse konstatohet se pa arsye nuk e realizon mësimin, respektivisht ushtrimet për studente, në rast se brenda afatit të përcaktuar nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit që nuk është më i gjatë se 15 ditë, nuk ka miratuar aktvendim për pushimin e marrëdhënies së punës (neni 138 paragrafi 6).

Gjobë në shumë prej 30.000 deri në 35.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet institucionit të arsimit të lartë, për kundërvajtje nga paragrafi 15 i këtij neni.

Gjobë në shumë prej 5.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të institucionit të lartë arsimor nëse nuk i dorëzon ose nëse i dorëzon të paplota të dhënat e nevojshme për azhurnim të bazës së të dhënave për veprimtarinë e arsimit të lartë të Ministria kompetente për punët nga sfera e arsimit të lartë, respektivisht nuk vepron në pajtim me Nenin 77-b të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të institucionit të lartë arsimor nëse nuk formon Qendër për karrierë, respektivisht nuk vepron në pajtim me nenin 45 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 5.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të institucionit të lartë arsimor nëse nuk vepron në pajtim me nenin 45 paragrafin 10 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit nga institucioni i lartë arsimor nëse nuk vepron në pajtim me nenin 133, paragrafi 13 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet institucionit të lartë arsimor nëse nuk vepron në pajtim me nenin 99, paragrafin 3 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet institucionit të lartë arsimor nëse nuk vepron në pajtim me nenin 100, paragrafet 5 dhe 6 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet institucionit të lartë arsimor nëse nuk vepron në pajtim me nenin 140, paragrafin 3 dhe 4 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet institucionit të lartë arsimor nëse nuk vepron në pajtim me nenin 123, paragrafin 4 të këtij ligji.

#### Neni 167-b

Gjobë në shumë prej 5.000 deri në 7.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të institucionit të lartë arsimor për kundërvajtje, nëse nuk përfshihet në realizimin e mësimit ekspert i shquar nga praktika nga sfera përkatëse nga neni 99 paragrafi 10 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 5.000 deri në 7.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të institucionit të lartë arsimor për kundërvajtje, nëse nuk organizon mësim praktik për studentët në secilin vit studimor që nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga neni 99 paragrafi 14 i këtij ligji.

#### Neni 168

Procedurën e kundërvajtjes penale për kundërvajtjet e parashikuara me këtë ligj e mban gjykata kompetente.

Para bërjes së kërkesës për ngritje të procedurës së kundërvajtjes penale për kundërvajtje të parashikuara me këtë ligj, ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë nis procedurë për sheshim në përputhje me Ligjin për Kundërvajtje.

#### **Kreu katërmëdhjetë-a**

### **DISPOZITAT NDËSHKIMORE**

#### Neni 168-a

Personi juridik që do ta filloje kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë pa marrjen e aktvendimit për akreditim dhe aktvendimit për fillimin e punës, do të përgjigjet penalisht dhe do të dënohet me dënim me para në shumë prej 50.000 deri në 100.000 euro në kundërvlerë me denarë dhe do t'i shqiptohet masa ndalimi për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë, ndërsa personi përgjegjës do të dënohet me burg prej një deri në tri vite (nenet 32 dhe 35).

## Kreu i pesëmbëdhjetë

### DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### Neni 169

Universitetet ekzistuese, fakultetet dhe shkollat e larta profesionale të regjistruara në Regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë, jo më vonë se 31 dhjetor 2008, do ta akordojnë funksionimin e tyre me këtë ligj, do të miratojnë statutet dhe aktet e tjera të përgjithshme të caktuara me këtë ligj, si dhe do të konstitujnë organet e parashikuara me këtë ligj.

Deri në miratimin e akteve të përgjithshme nga paragrafi 1 i këtij neni do të zbatohen aktet e përgjithshme ekzistuese.

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë, i themeluar sipas dispozitave të deritanishme të arsimit të lartë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, vazhdon me punë në cilësinë e institutit privat-publik jofitimprurës të arsimit të lartë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

#### Neni 170

Këshilli i akreditimit vazhdon të funksionojë me përbërjen ekzistuese deri në emërimin e anëtarëve të rinj, jo më vonë se brenda tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Agjencia për evalvim vazhdon të funksionojë me përbërjen ekzistuese deri në emërimin e anëtarëve të rinj, jo më vonë se brenda tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. [24](#)

Anëtarët e Këshillit të akreditimit dhe Agjencisë për evalvim që janë të zgjedhur për herë të parë, kanë të drejtë të edhe një mandati prej katër vjetësh. Anëtarët që janë zgjedhur për herë të dytë nuk kanë të drejtë të zgjidhen për herë të tretë.

Këshilli i akreditimit dhe Agjencia për evalvim brenda tre muajve nga dita e emërimit të anëtarëve, do të miratojnë aktet e parashikuara me këtë ligj.

#### Neni 171

Këshilli vazhdon të funksionojë me përbërjen ekzistuese deri në emërimin e anëtarëve të rinj, jo më vonë se brenda tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Anëtarët e Këshillit që janë të zgjedhur për herë të parë, kanë të drejtë të edhe një mandati prej katër vjetësh. Anëtarët që janë zgjedhur për herë të dytë, nuk kanë të drejtë të zgjidhen për herë të tretë.

Këshilli brenda tre muajve nga dita e emërimit të anëtarëve, do të miratojë aktet e parashikuara me këtë ligj.

#### Neni 172

Konferenca Ndëruniversitare jo më vonë se brenda tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zgjedhë anëtarë të rinj në Këshillin e akreditimit dhe Agjencinë për evalvim në vend të anëtarëve ekzistues.

Konferenca rektorate e universiteteve publike më së voni në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zgjedh anëtarë të ri në Këshill, në vend të atyre ekzistues.

#### Neni 173

Ministri kompetent për funksionimin e arsimit të lartë, brenda 12 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të miratojë aktet e caktuara me këtë ligj.

#### Neni 174

Procedura për pajisjen me nivel shkencor magjistër i shkencave, e nisur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe procedura e nisur para nisjes së studimeve master, të akorduara sipas këtij ligji, mund të përfundojë sipas dispozitave të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 64/2000, 49/2003, 113/2005 dhe 51/07) dhe statutit të institucionit të arsimit të lartë, përkatësisht universitetit.

Personat që kanë fituar titullin shkencor magjistër, në pajtim me dispozitat e Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 64/2000 dhe 49/2003), mund të parashtrajnë fletëparaqitje për fitimin e shkallës shkencore doktor i shkencave, në pajtim me dispozitat e Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 64/2000 dhe 49/2003) më së voni deri më 31 dhjetor 2011.

#### Neni 175

Zgjedhja në titujt mësimorë-shkencorë, mësimorë dhe pozicione të bashkëpunëtorëve, e nisur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojë sipas kushteve dhe procedurës së caktuar me Ligjin për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 64/2000, 49/2003, 113/2005 dhe 51/07).

#### Neni 176

Rektori, prorektori, dekani, prodekani, përkatësisht drejtori dhe zëvendës drejtori i institucionit publik të arsimit të lartë të zgjedhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë t'i ushtrojnë funksionet e tyre deri në fund të periudhës për të cilën janë zgjedhur.

Personat nga paragrafi 1 i këtij neni që janë të zgjedhur për herë të parë, kanë të drejtë të edhe një mandati prej katër vjetësh. Personat që janë zgjedhur për herë të dytë, nuk kanë të drejtë për një mandat të tretë.

#### Neni 177

Profesorët ordinarë të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë zgjedhur në atë titull për herë të parë sipas Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 64/2000, 49/2003, 113/2005 dhe 51/2007), themelojnë marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar dhe e mbajnë titullin profesor ordinar përjetësisht.

#### Neni 178

Asistentët më të rinj që janë të zgjedhur për herë të parë në atë pozicion në bazë të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 64/2000, 49/2003, 113/2005 dhe 51/2007) mund të zgjidhen edhe një herë në të njëjtin pozicion për një kohëzgjatje prej dy vjetësh.

#### Neni 179

Fakultetet dhe shkollat e larta profesionale ekzistuese në përbërje të në Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup, Universitetit "Shën Klimenti i Ohrit" në Manastir, Universiteti shtetëror në Tetovë dhe Universiteti "Goce Dellçev" në Shtip, me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të punojnë si njësi të universitetit në pajtim me këtë ligj.

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk janë më të vlefshëm aktet e themelimit të fakulteteve, përkatësisht shkollave të larta profesionale në kuadër të Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup dhe në kuadër të Universitetit "Shën Klimenti i Ohrit" në Manastir dhe Kuvendi i Republikës së Maqedonisë mbetet themeluesi i Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup dhe Universitetit "Shën Klimenti i Ohrit" në Manastir, me njësitë në kuadër të tyre.

Organizata themelore e punës së bashkuar Institute - Universitet "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup - OP Fakulteti i mjekësisë (në vijim të tekstit: Institute) fshihet nga regjistri gjyqësor dhe vazhdon të funksionojë në kuadër të Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup si njësi e brendshme organizative e Fakultetit të mjekësisë. Të punësuarit në Institutet i vazhdojnë marrëdhëniet e punës si të punësuar në Fakultetin e mjekësisë në Shkup. Prona që shfrytëzohet nga Institutet është pronë e Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup. Veprimtaria shëndetësore e Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi" - Fakulteti i mjekësisë do të ushtrohet në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e shëndetit dhe me Ligjin për sigurim shëndetësor.

Universiteti "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup - Fakulteti i mjekësisë dhe institutet publike shëndetësore, Klinikat dhe institutet universitare, nënshkruajnë marrëveshje për rregullim të marrëdhënieve ndërmjet tyre në ushtrimin e veprimtarisë së arsimit, veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe asaj shëndetësore, si një tërësi funksionale, në përputhje me nevojat e realizimit të programeve studimore si dhe për rregullimin e marrëdhënieve të punës, jo më vonë se brenda tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Universiteti "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup - Fakulteti i stomatologjisë dhe institutet publike shëndetësore, Qendra Klinike Universitare e stomatologjisë, përkatësisht Klinika Universitare e Kirurgjisë maksilofaciale, nënshkruajnë marrëveshje për rregullim të marrëdhënieve ndërmjet

tyre në ushtrimin e veprimtarisë së arsimit, veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe asaj shëndetësore, si një tërësi funksionale, në përputhje me nevojat e realizimit të programeve studimore si dhe për rregullimin e marrëdhënieve të punës, jo më vonë se brenda tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Universiteti "Shën Klimenti i Ohrit" në Manastir, Universiteti Shtetëror në Tetovë, Universiteti "Goce Dellcevi" në Shtip dhe institucionet shëndetësore publike dhe klinikat universitare, lidhin marrëveshje për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella në kryerjen e veprimtarisë arsimore, shkencore-hulumtuese dhe shëndetësore, si tërësi funksionale, në pajtim me nevojat për zbatimin e programeve studimore, si dhe për rregullimin e marrëdhënieve të punës, më së voni në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 180

Institucionet e arsimit të lartë do t'i fusin programet studimore për arsim të lartë dhe programet studimore të specializimit në bazë të këtij ligji në mënyrë graduale jo më vonë se deri në vitin studimor 2009/10. Me futjen e programeve studimore në bazë të këtij ligji dhe edhe me konkursin nuk mund të regjistrohen në programe studimore që nuk janë të akorduara me këtë ligj.

Studentët e regjistruar sipas programeve studimore deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji mund t'i përfundojnë studimet nën kushtet që kanë qenë të vlefshme gjatë regjistrimit, po jo më vonë se afati i caktuar për realizimin e programit studimor, të zgjatur për dy vjet, ndërsa studimet në shkollat e larta profesionale deri në fund të vitit studimor 2009/10.

Studentët nga paragrafi 2 i këtij neni që kanë të drejtë të përsërisin dhe për shkak të futjes graduale të programeve të reja studimore, nuk kanë mundësi ta përsërisin vitin sipas programeve studimore që janë regjistruar, i vazhdojnë dhe përfundojnë studimet sipas programeve të reja studimore.

Dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohen ciklet e arsimit të lartë dhe programet studimore mund të aplikohen me konkursin për regjistrim në vitin shkollor 2008/09.

#### Neni 181

Studentët që kanë diplomuar sipas programeve studimore deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, gjatë regjistrimit në programet e reja studimore dy vjeçare për studime master me fushë të njëjtë ose të ngjashme profesionale si rregull u njihen detyrimet e studimit në lartësi jo më shumë se 60 kredi.

Studentët që kanë diplomuar sipas programeve studimore deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, gjatë regjistrimit për profesione të rregulluara me direktivat e bashkimit evropian dhe janë vlerësuar me 300 kredi ose më shumë, kanë të drejtë të regjistrohen në programe studimore të doktoratit sipas kushteve të caktuara me këtë ligj dhe me statutin e institucionit të arsimit të lartë.

Studentët që kanë diplomuar sipas programeve studimore deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji sipas programeve studimore me të cilat janë pajisur me specializim, nëse studimi i tyre i përbashkët nuk ka zgjatur të paktën pesë vjet, gjatë regjistrimit në programet studimore të ciklit të tretë përcaktohen detyrime studimore suplementare në vëllim prej 60 kredi.

Studentët që kanë diplomuar sipas programeve studimore deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji sipas programeve studimore për master për programe studimore të doktoratit u njihen detyrimet studimore në lartësi prej 60 kredi.

#### Neni 182

Personave të cilët deri më 31 dhjetor 1996 kanë marrë diplomë ose dokumente të tjera për arsim të lartë, studime pasuniversitare dhe doktoratë të shkencave në rajonin e ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, u njihet përgatitja e lartë profesionale, titulli shkencor specialist, niveli akademik magjistër, përkatësisht niveli shkencor doktor i shkencave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

#### Neni 183

Personat që në bazë të ligjit i kanë përmbushur kushtet për regjistrim të studimeve, dhe kanë ndjekur mësim deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, jashtë institucioneve publike të arsimit të lartë në forma të ndryshme të iniciativave qytetare në Republikën e Maqedonisë, organizuar deri më 15 gusht 2000, kanë mundësi në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe statutit të institucionit përkatës të arsimit të lartë:

- t'i vazhdojnë studimet e tyre të vitit të parë nga ato studime në institucione përkatëse të arsimit të lartë;
- të kërkojnë kontroll të njohurive të tyre dhe në bazë të rezultateve të treguara të regjistrohen në studime në vitin përkatës ose
- në bazë të rezultateve nga kontrolli i njohurive të realizojnë të tjera të drejta të tyre.

Të drejtat nga paragrafi 1 i këtij neni realizohen në institucionet përkatëse të arsimit të lartë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve të tij. Këto të drejta mund të realizohen me kërkesë personale, të bërë institucionit përkatës të arsimit të lartë jo më vonë se data 31 dhjetor e vitit 2008.

#### Neni 184

Mësuesit e zgjedhur në pozicionin lektor me arsim të lartë përkatës, si dhe mësuesit e qendrës sportive universitare, mund të rizgjidhen në bazë të kushteve të caktuara me Ligjin për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 64/2000, 49/2003, 113/2005 dhe 51/2007).



#### Neni 185

Procedura për themelim të institucionit të arsimit të lartë e cila është nisur deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojë sipas dispozitave të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 64/2000, 49/2003, 113/2005 dhe 51/2007).

#### Neni 186

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 64/2000, 49/2003, 113/2005 dhe 51/2007).

#### Neni 187

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".